



# Hëna e Re

Viti XXXVI | Nr.376 | Janar 2023 | Xhumadël Ahir - Rexheb 1444 | Çmimi 50 den

*Të përfitojmë nga  
Tërë Muajt e Bekuar*

**PËR KREDON ISLAME**

**ISLAMI, I AFTË TË NOTOJË  
EDHE NË SFERËN E GLOBALIZMIT BOTËROR**

# HAXHI 2023, PA ASNJË KUFIZIM

Arabia Saudite ka njoftuar, duke vërtetuar dhe zyrtarisht, që Haxhi i vitit 2023 (1444 H) do të jetë i lirë nga të gjitha kushtëzimet që ishin vendosur gjatë kohës së pandemisë me covid-19 dhe kuota kthehet si më parë, thuhet në njoftimin e BFI.

Një delegacion i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, i dërguar nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu prezanton në Konferencën ku diskutohet mbi organizimin e Haxhit 2023, të thirrur nga Ministria e Haxhit dhe e Umres në qytetin e Xhedas nga 9.01.2023 deri më 12.01.2023.

Në delegacion janë h. Ismet ef. Ademi, Përgjegjës për Botën Arabe dhe dr. Abdulkerim ef. Iseni, Shef i Kabinetit të Reis'ul-Ulemasë. Ata zhvilluan disa takime me përgjegjësit e Haxhit, ku u bisedua për shumë çështje, në veçanti për kushtet dhe kuotën - numrin e haxhinjve të sivjetëm nga RMV, thuhet në njoftimin e BFI (10.01.2023).

Të njëjtën ditë, hoxhë Eljasa Mahmudi në profilin e vet në



Facebook kishte shkruar: Ministri i Haxhit dhe Umres, dr. Tawfiq al-Rabiah, shpalli: "Numri i haxhinjve në vitin 1444 H/2023 do të kthehet ashtu siç ka qenë para pandemisë me virusin Korona dhe pa kufizime të moshës." Haxhi zhvillohet në kohën e Kurban-Bajramit, që sivjet bie më 28 qershor (e mërkurë).

## TAKIM ME MINISTRIN E HAXHIT

Më 12 janar, 2023, delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, i përbërë nga h. Ismet ef. Ademi, Përgjegjës për Botën Arabe dhe dr. Abdulkerim ef. Iseni, Shef i Kabinetit të Reis'ul-Ulemasë, u takua në Rijad me Shkëlqesinë e Tij, Ministrin e Haxhit dhe të Umres, dr. Tefvik bin Fevzan er-Rebia, thuhet në njoftimin e BFI.

Në vizitën zyrtare në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe në Konferencën e Haxhit dhe të Umres, që organizohet nga Ministria e Haxhit dhe e Umres, delegacioni përfaqëson Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Në takimin me z. Er-Rebia delegacioni i BFI i përcolli Ministrin të Haxhit dhe të Umres falënderimet e Kryetarit të BFI,



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu për organizimin e Haxhit dhe për lehtësimet e tjera që ua ofrojnë haxhinjve tanë.

Delegacioni i BFI, i cili udhëtoi për në Mbretërinë e Arabisë Saudite me ftesë speciale nga Shkëlqesia e Tij, Ministri i

Haxhit dhe i Umres, dr. Tefvik bin Fevzan er-Rebia, në takim bisedoi edhe për bashkëpunim të mëtejshëm mes Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe Ministrisë së Haxhit dhe të Umres së Mbretërisë së Arabisë Saudite, thuhet në njoftimin e BFI.

|   |   |  |   |  |
|---|---|--|---|--|
|   | <b>DITËT E RËNDËSISHME FETARE 2023</b><br>1444/45 H.      | <b>FILLIMI I TRE MUAJVE</b><br>23 JANAR - 2023<br>(E HËNË) | <b>NATA E REGAIPIT</b><br>26 JANAR - 2023<br>(E ENJTE)          | <b>NATA E MIRAXHIT</b><br>17 SHKURT - 2023<br>(E PREMTE) |
| <b>NATA E BERATIT</b><br>06 MARS - 2023<br>(E HËNË)   | <b>FILLIMI I RAMAZANIT</b><br>23 MARS - 2023<br>(E ENJTE) | <b>NATA E BEDRIT</b><br>07 PRILL - 2023<br>(E PREMTE)      | <b>NATA E ÇLIRIMIT TË MEKES,</b><br>10 PRILL - 2023<br>(E HËNË) | <b>NATA E KADRIT</b><br>17 PRILL - 2023<br>(E HËNË)      |
| <b>FITËR BAJRAMI</b><br>21 PRILL - 2023<br>(E PREMTE) | <b>DITA E ARAFATIT</b><br>27 QËRSHOR - 2023<br>(E MARTE)  | <b>KURBAN BAJRAMI</b><br>28 QËRSHOR - 2023<br>(E MËRKURË)  | <b>VITI I RI HIXHRI</b><br>19 KORRIK - 2023<br>(E MËRKURË)      | <b>NATA E MEVLUDIT</b><br>26 SHTATOR - 2023<br>(E MARTE) |

## EDITORIAL

# TË PËRFITOMJË NGA TRE MUAJT E BEKUAR

Për të mirën e krijesës së Tij më të përsosur - njeriun, Allahu (xh. sh.) i ka dalluar disa pjesë të kohës prej disa të tjerave, duke lëshuar në to mëshirën dhe mirësinë e Tij për krijesën më të përsosur-njeriun. Prej ditëve të javës e ka dalluar të premten-xhumanë; prej netëve të javës: natën e xhuma; prej atyre të vitit: natën e Regaibit, të Miraxhit, të Beratit e të Kadrit; prej muajve hënor: Rexhebin, Sha'banin dhe Ramazanin.

Tanimë gjendemi në Tre Muajt e Bekuar dhe me vlerë të veçantë, respektivisht jemi në muajin Rexheb, i cili konsiderohet muaji i faljes nga Allahu (xh. sh.), ose thënë figurativisht: është muaji i mbjelljes. Ky muaj i paraprur muajit Shaban, i cili është muaji i ndërmjetësimit për falje ose, thënë figurativisht, është muaji i ujitjes apo kultivimit. Pas Shabanit vjen muaji i të mirave të përgjithshme, Ramazani, që është muaji i shtimit të begatave dhe mirësive ose thënë figurativisht është muaj i korrjes, muaj i mbledhjes së bereqetit.

Për fat të mirë, pas tre viteve me radhë, këtë vit Tre Muajt e Bekuar i filluam të "çliruar" nga pandemia covid-19, gjë që do të kemi mundësinë që muajt e lartpërmendur t'i përjetojmë dhe shfrytëzojmë nga begatia e tyre, ashtu siç i ka hije besimtarit mysliman, sepse një besimtar i kujdesshëm gjatë këtyre Tre Muajve të Bekuar, pos ibadeteve të përditshme, e shton vëllimin e punëve të dobishme dhe të mira, siç është nxënia e dijes, dhënia e sadakasë, e zeqatit, namazi nafile, agjërimi etj.

Gjatë këtyre muajve nuk parashihet ndonjë ibadet i veçantë, por është mirë, siç mësojmë nga tradita e Pejgamberit (a. s.), që ibadetet e rëndomta nafile t'i shtojmë akoma më tepër e për farzet as që duhet të bisedohet. Kështu, është mirë që së paku të agjërojmë nga tri ditë në fillim, në mes dhe në fund të këtyre dy muajve, si përgatitje për Ramazanin që pason; pastaj të shtohen namazet nafile, leximi më i tepërt i Kuranit e të shpeshtohen duatë e lutjet si dhe dhikri - përmendja e Allahut (xh. sh.).

Vlerën e këtyre muajve gjithësi e madhështojnë Netët e Mëdha, apo Netët e Mira që gjenden në këta muaj, siç janë:

- **Nata e Regaibit**, që bie gjithnjë në natën e xhumasë së parë të muajit Rexheb. Kjo natë, ndërkaq, njihet për nga ajo që thuhet se Emineja, nëna e Muhamedit (a. s.), e ka hetuar veten se është shtatzënë, që i vjen si **nata e zanafilës fizike** të të dërguarit të Allahut (xh. sh.).

- **Nata e Miraxhit**, që bie në natën e 27-të të muajit Rexheb, natë të cilën e përmend edhe Kurani fisnik: **"Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës nga Mesxhidi Haram (Qabeja) deri në Mesxhidi Aksa (Bejtü Mukaddes), rrethinën e të cilit Ne e kemi bekuar; (ia bëmë këtë udhëtim) për t'i treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhamedit), shikuesi (i punëve të Muhamedit)."**

- **Nata e Beratit**, që bie në natën e 15-të të muajit Shaban. Është nata e cila na e paralajmëron ardhjen e shpejtë të muajit Ramazan, të muajit tonë më të dashur, kështu që sa më mirë duhet të përgatitemi shpirtërisht dhe fizikisht për agjërim dhe për ibadete të tjera.

- **Nata e Kadrit**, që bie në dhjetë netët e muajit Ramazan. Ajo është nata më e vlefshme dhe më e bekuar. Në të fillit të shpallet Kurani fisnik. Një kaptinë e Kuranit mban emrin e kësaj nate. Vlerën e kësaj nate më së miri na e tregon Kurani: **"Ne e shpallëm atë (Kuranin) në Natën e Kadrit; e ç'të bëri ty të dish se çka është Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj..."**

Organizimi i aktiviteteve të jetës fetare në këta Tre Muajt, si gjithmonë, është nën përkujdesjen institucionale të Bashkësisë Fetare Islame të vendit tonë, respektivisht të organeve dhe institucioneve edukativo-arsimore të saj, si dhe të asociacioneve të themeluara nga BFI. BFI, duke pasur parasysh zhvillimet e përgjithshme shoqërore, përpiqet që të krijojë kushte sa më të mira për shtrirjen e aktiviteteve fetare në gjithë territorin e vendit.

Në faqet e revistës "Hëna e Re", gjatë këtyre Tre Muajve, lexuesit e saj do të hasin punime të ndryshme lidhur me vlerat e këtyre Tre Muajve, respektivisht me vlerat e gjithë asaj që ka ndodhur brendapërbrenda këtyre Muajve të Bekuar.

Q. Osmani



NË TRE MUAJT E BEKUAR

# ISRAJA DHE MIRAXHI I MUHAMEDIT (A. S.)

**“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e shëtiti në një pjesë të natës nga Mesxhidi Haram (nga Qabeja) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilit Ne e kemi bekuar; (ia bëmë këtë udhëtim) për t’ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Ai me të vërtetë dëgjon dhe sheh shumë.” (El-Isra: 1)**

**Shkruan:**  
**prof. dr. Abdylxhemil Nesimi**  
**(Enkas për HeR)**

Israja dhe Miraxhi është ngjarje më madhështore e historisë islame, që ndodhi natën e vitit 621, mes vitit të njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë të misionit të Pejgamberit (a. s.), të cilin udhëtim myslimanët e konsiderojnë një nga mrekullitë e pejgamberit Muhamed.

Israja dhe Miraxhi nuk ishte një ngjarje e zakonshme. Përkundrazi, ishte një mrekulli e integruar hyjnore, me të cilën Zoti e mbështeti pejgamberin e Tij Muhamedin (a. s.), e ndihmoi thirrjen e tij me të, popullit të tij i zbuloi dëshmi të reja, mrekulli të madhe, të cilën njerëzit nuk janë në gjendje ta bëjnë një gjë sikur kjo. Brenda një pjese të natës e barti robin e Tij nga Xhamia e Shenjtë në Mekë, në Xhaminë Al-Aksa në qytetin e Jerusalemit, për ta ngushëlluar për atë që kishte përjetuar nga njerëzit e Taifit, për ta ngritur në qiejt më të lartë, për t’i treguar nga shenjat e tij madhështore.

Është një udhëtim për të cilin fisi kurejsh u dëshpërua, deri në atë masë sa disa prej tyre filluan të duartrokasnin dhe të fishkëllenin në mënyrë tallëse, por pejgamberi Muhamed (a. s.) këmbënguli që ta vërtetonte dhe që më pas u zhvendos nga Jerusalemi në një udhëtim qiellor, i shoqëruar nga Xhibrili, mbi një kafshë të quajtur el-Burak, ose sipas shprehjes islame: ai u ngjiti me të në kuvendin më të lartë, në Sidrat el-Muntaha, d.m.th. në skajin e largët, në pedestalin më të lartë në qiell dhe të kthehet pas kësaj në të njëjtën natë, ku një sure e Kuranit u emërua sipas kësaj ngjarje.

Me El-Isra nënkuptohet udhëtimi tokësor dhe tranzicioni i mrekullueshëm në krahasim me atë që është e njohur për

njerëzit, që ndodhi me fuqinë e Zotit nga Xhamia e Shenjtë në Xhaminë Al-Aksa dhe arritja në të me një shpejtësi të atillë që e tejkalon imagjinatën. Thotë i Plotfuqishmi në suren El-Isra: **“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e shëtiti në një pjesë të natës nga Mesxhidi Haram (nga Qabeja) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilit Ne e kemi bekuar; (ia bëmë këtë udhëtim) për t’ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Ai me të vërtetë dëgjon dhe sheh shumë.”** (El-Isra: 1)

Sa i përket Miraxhit: është udhëtim qiellor, ascension (ngritje) fizike e Muhamedit (a. s.) prej toke (Mesxhidi Aksas) deri në pikën më të lartë qiellore, Sidra al-Munteha, dhe kthimi përsëri në Xhaminë e Shenjtë.

Zoti i Madhërishtëm në suren En-Nexhm thotë: **“Ai e ka parë (Xhibrilin) edhe herën tjetër. Te Sidretul Munteha. Pranë së cilës është Xhennetul Me’va. Atëherë kur Sidrën e mbuloi ajo që e mbuloi. Shikimi i tij nuk lakoi e as nuk tejkaloi. Ai vërtet pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet.”** (En Nexhm: 13-18)

Edhe pse *“El-Isra”* dhe *“El-Miraxh”* u zhvilluan në të njëjtën natë, vendet ku përmenden në Kurandin famëlartë nuk janë të njëjta. Përkundrazi, Israja u përmend së pari në suren El-Isra, kurse diskutimi i Miraxhit u pozicionua në suren El-Nexhm.

Urtësia në këtë mund të jetë që Israja (që është udhëtimi tokësor) të bëhet prelud i lajmit të Miraxhit, i cili është udhëtimi i sipërm, prej të cilit njerëzit mbetën të shtangur kur u informuan për të, kështu që në atë kohë u larguan nga Islami besimtarët e dobët, ndërsa besimtarët e fortë mbetën të paluhatshtëm.

Qëllimi i këtij udhëtimi ishte që t’i bëhet e mundur Muhamedit (a. s.) të

përjetojë disa nga argumentet e Krijuesit, të shikojë gjëra të çuditshme, përmes të cilave manifestohet fuqia e Allahut Fuqplotë.

## NGJARJET QË I PARAPRINË ISRASË

Kjo ngjarje e rëndësishme ndodhi aty kah gjysma e periudhës së shpalljes së Kuranit famëlartë, kur myslimanët përpos torturave më çnjerëzore që i përjetonin nga idhujtarët e Mekës, ishin të izoluar politikisht, ekonomikisht tre vjet me radhë.

Pas bojkotit, Muhamedin (a. s.) e përcollën vështirësi të njëpasnjëshme: i vdes xhaxhai Ebi Talibi, të cilin Muhamedin (a. s.) e kishte mbrojtje të fortë kundër sulmeve të idhujtarëve; po ashtu i vdes edhe bashkëshortja, Hatixhja (r. a.), shoku më besnik dhe ideologjik. Dhe, me plot të drejtë këtë vit do ta quajmë vit të dëshpërimit.

I dëshpëruar vendosi që ta lëshojë Mekën dhe të shkojë në Taif, që atje të predikojë Islamin dhe të gjejë mbështetje. Për fat të keq, atje nuk ishte i mirëseardhur dhe nuk gjeti përkrahje. U detyrua të kthehej nga Taifi, duke mos arritur ndonjë sukses. Megjithatë, mekasit i gjeti edhe më të egërsuar. Në anën tjetër, rezistenca kundër përhapjes së Islamit gjithnjë bëhej më e paevitueshme.

Në këto momente të vështira që kalonte Muhamedi (a. s.), Allahu Fuqplotë në shenjë ngushëllimi e gradon të dërguarin e Tij me mrekullinë e Israsë dhe të Miraxhit, e cila për Muhamedin (a. s.) ishte “zgjatja e dorës së mëshirës dhe e dashurisë së Allahut ndaj tij në momentin kur ai kishte më tepër nevojë”.

## KOMENTI I AJETIT TË PARË TË SURES EL-ISRA

Pejgamberi Muhamed udhëtoi me trup dhe me shpirt nga Xhamia e Shenjtë për në Jerusalemin, hipur mbi Burak, i shoqëruar nga Xhibrili (a. s.). Kështu që ai zbriti atje, i udhëhoqi profetët në namaz dhe e lidhi Burakun në unazën e derës së Xhamisë.

Ajeti fillon me fjalën *“Subhane”*, që ka kuptim të lartmadhërisë, largësisë, pastërtisë etj. Këtë epitet të Madhërisë së Zotit e kuptojmë nga shprehja *“Subhane”* - është infinitiv, që lë të kuptosh se Lartmadhëria e Tij është nga vetvetiu. Që nënkupton se Zoti është i lartësuar në thënien e Tij, është i lartësuar në veprat e Tij, është unik në cilësitë e Tij.

Kur shprehja *“Subhane”* përcillet me përemrin lidhor, sikur në këtë rast, tregon



se bëhet fjalë për një çështje të jashtëzakonshme, për një ngjarje të rëndësishme e cila ka të bëjë me thyerjen e ligjeve të natyrës.

Andaj, ideja se ngjarja e Israsë dhe Miraxhit nuk përputhen me ligjet dhe rregullat e natyrës, siç janë: gravitacioni i tokës, shtypja dhe shtresat atmosferike, natyra dhe struktura e planetëve etj. nuk vijnë në konsiderim për ndonjë vepër të Zotit siç është kjo (*eledhi esra bi abdihi*). Pra, Ai që e nderoi të dërguarin e Tij duke ecur dhe duke lëvizur natën. *“Bi abdihi”*, me krijesën e Tij, me qenien njerëzore të cilën Ai e zgjodhi për këtë mision të madh, që është misioni i udhëzimit të mbarë njerëzimit.

Zoti i Madhërishtëm nuk ka thënë: me mikun e Tij, apo me të dashurin e Tij, apo me profetin e Tij. Përkundrazi, i lartësuar tha: *“bi abdihi-me robin e Tij”*. Ky është një shënim i rëndësishëm, se i dërguari i Zotit ka arritur pozitën e robërisë së pastër ndaj Zotit dhe se vërtet është

*“njeri i përsosur”*, sepse kërkesa e parë e Islamit është arritja e robërisë së pastër ndaj Zotit të Madhërishtëm. *“Lejlen-Natën”*, kjo tregon se Israja ishte një pjesë të natës dhe nuk zgjati tërë natën.

Nata ishte koha e dy udhëtimeve, sepse është koha e vetmisë dhe ishte koha e preferuar e namazit për të dërguarin e Zotit - paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të. Përkundrazi, ishte koha e namazit para se të obligohej namazi në mënyrën dhe në kohën e njohur. Udhëtimi natën gjithashtu është informues për besimtarin në të padukshmen. Sa i përket thënies së Zotit të Madhërishtëm: *“min el mesxhid el-haram il el mesxhid el-aksa”* - “nga Xhamia e Shenjtë në Xhaminë Al-Aksa”, interpretimi i saj është se kalimi i të Dërguarit në udhëtimin e tij tokësor ka ndodhur ndërmjet dy xhamive, e para: Xhamia e Haremit-Qabeja, dhe e dyta: Al-Aksa, Xhamia në tokën e Palestinës, djepi i profetëve dhe të dërguarve, e cila ishte kibleja e parë për myslimanët para

se t'u vinte urdhri për t'u kthyer në drejtim të Qabesë, e cila është kibleja e tyre që nga ajo kohë e derisa të ekzistojë jeta.

Xhamia Al-Aksa është një nga xhamitë më të mira në tokë dhe namazi në të është i barabartë me pesëqind namaze në xhamitë tjera. (Eledhi barekna haulehu) – "Ai rrethinën e të cilit Ne e kemi bekuar", domethënë ai që i kemi derdhur atij dhe rreth tij me bekime, të dynjasë dhe shpirtërore. (Linurijehu min ajatia), domethënë, disa nga argumentet që tregojnë fuqinë dhe madhësinë e Zotit, jo të gjitha argumentet.

I Plotfuqishmi ajetin kuranor e vulos me atë që tregon gjerësinë e diturisë së Tij dhe bujarinë e Tij, andaj ka thënë: *Inehu huve es semi el alim*, domethënë: Ai është Dëgjuesi i fjalëve të robërve të Tij, besimtarëve dhe jobesimtarëve, i vërtetuesve dhe gënjeshtarëve. Ai sheh atë që fshehin dhe atë që publikojnë, dhe çdo njeri do të shpërblehet me shpërblimin ose me dënimin që meriton, pa padrejtësi dhe favorizime.

Nga ky ajet fisnik qartësohet se ngjarja e Israsë dhe Miraxhit nuk është vepër njerëzore, për këtë arsye është mrekulli e madhe hyjnore me të cilën i Lartësuari e veçoi Muhamedin (a. s.) me udhëtim të shkëlqyeshëm. Ai e palosi kohën dhe vendin për vulën e profetëve dhe arriti nivelin më të lartë të afërsisë: imami dhe prezantuesi i tyre kryesor.

Ka shumë individë që thonë se Kurani në fillim të kësaj kaptine starton me ndodhin e Israsë e pastaj flet për çifutët. Vallë, ku qëndron urtësia? - Është e vërtetë se Kurani në fillim të kësaj kaptine paraqet dy lloje të lidhshmërive dhe atë: lidhshmërinë e Muhamedit (a. s.) me Zotin, si dhe të Musait (a. s.) me Zotin.

Muhamedi (a. s.) e bëri Isranë natën nga Mesxhidi Harem deri në Mesxhidi Al-Aksa, ndërkaq Musait (a. s.), për të folur me Zotin, Allahu i premtoi katërdhjetë net. Për këtë Kurani thotë: **"Dhe Ne i caktuam Musait tridhjetë net (afatin për shpallje), e ato i plotësuam edhe me dhjetë dhe kështu u mbush afati për takim me Zotin e tij në katërdhjetë net."** (El-A'raf: 142)

Nisur nga kjo që potencuam, mund të konstatojmë se Kurani famëlartë flet për dy Israja - njërin që ndodhi me një shpejtësi të madhe si rezultat i **"bëhu dhe bëhet"**, ndërsa Israja e Musait (a. s.) ndodhi brenda katërdhjetë netëve.

Ajeti i parë i sures El-Isra, që është sure mekase, ishte paralajmërim se myslimanët do ta çlirojnë Bejtul Mekdisin, sepse *"el-mesxhid"* është term islam, që d.t.th. xhami.

Në nivel të brendshëm, të ummetit islam, kjo ndodhi dëshmoi obligimin e namazit, që pati një ndikim të thellë në jetën e individit dhe të shoqërisë, si një "rezervuar" në thellësinë e të cilit kultivohen rrënjët e sakrificës, flijimit, pastërtisë, devotshmërisë, çlirimit nga materializmi dhe pastrimit të shpirtit për hir të Zotit të Plotfuqishëm. Të gjitha këto janë bazë prej së cilës fillon fryma e përpjekjes (xhihadit). Fillimisht, përpjekja me veten, pastaj përpjekja në mbrojtje të së vërtetës, të atdheut, të nderit, të dinjitetit e kështu me radhë.

Në nivel të jashtëm, Israja dhe Miraxhi është pikënisja e përhapjes së Islamit në mbarë botën dhe kthesë e ndryshimeve rrënjësore në jetën e njerëzimit në nivele të ndryshme. Më e rëndësishmja është se Islami do ta drejtojë njerëzimin drejt një rendi të ri botëror.

Prirja e Muhamedit (a. s.) si imam ndaj profetëve të Zotit në xhaminë e bekuar Al-Aksa, nënkupton se është përgjegjës i Islamit dhe mban flamurin e udhëheqjes së tërë njerëzimit dhe nxjerrjen e tyre nga errësira në dritë. Kjo përgjegjësi nuk është e kufizuar në të tashmen dhe të ardhmen e asaj kohe, por përgjegjësi në mënyrë retroaktive, në kuptimin e luftimit të fesatit e të fesatçinjve dhe shtypjes së shtypësve që pretendojnë se janë pasardhës të Zotit në tokë, që bëjnë çregullime dhe prishin rendin në tokë. Është thënë në tekstin e librit të Tij: **"Dhe, ne kemi shkruar në Zabur pas përkujtimit, se toka do të trashëgohet nga shërbëtorët e mi të drejtë."** (El-Enbija: 12)

#### MIRAXHI NË PRESPEKTIVËN MODERNE

Jemi dëshmitarë të kohës kur një numër i madh satelitësh lansohen në hapësirën qiellore. Nëse njeriu, si qenie e dobët ka arritur atë çka ka qenë e paimagjineshme para disa dekadave, atëherë, a ka dyshim në ngritjen që ia bëri Allahu Fuqiptotë robit të Tij, Muhamedit (a. s.), me trup dhe me shpirt, brenda një nate, nga Xhamia e Shenjët e Mekës, në Xhaminë Al-Aksa dhe pastaj në qiellin më të lartë, për t'i treguar nga shenjat e tij.

Nëse para XV shekujsh disa skeptikë nuk kanë mundur ta imagjinojnë se ngritja ka qenë fizike dhe me plot vetëdije, nga shkaku i njohurive të tyre të kufizuara, sot një gjë e tillë veç është prezente dhe shumë e qartë.

Në kohën kur Muhamedi (a. s.) e publikoi këtë ngjarje, shumë njerëz shpre-

hën rezervë dhe mohim, por kishte të tillë që e besoi sa e ndëgjoi, siç është rasti i Ebu Bekrit - Zoti qoftë i kënaqur me të.

Një dyshim i tillë ndonjëse manifestohet edhe në ditët e sotme te disa njerëz, por duhet të kemi parasysh se nuk do të ishte e pavend hutia sikur Muhamedi (a. s.) të thoshte: *"Shkova brenda natës nga Qabeja në Kudus, e pastaj në pikën më të lartë qiellore."* Por ai tha: *"U bë udhëtimi me Mua"* - që jep të kuptosh se atë e ka bartur Zoti i Madhërishtëm.

#### MESAZHI E ISRASË DHE MIRAXHIT

Zoti i Madhërishtëm deshi të përcjellë shumë mësim nga udhëtimi i Israsë dhe Miraxhit të Muhamedit (a. s.). Në vijim do të theksojmë disa prej tyre:

Israja nga Meka deri në Jerusalem dhe Miraxhi në qiej dhe kthimi në të njëjtën natë, flet për fuqinë absolute të Zotit të Plotfuqishëm, rreth të cilit rrugëtim u zhvilluan shumë polemika dhe pati shumë dilema, ndërkaq myslimani i bindur në madhësinë hyjnore dhe në Plotfuqinë e Tij është i patundur në besimin e rrugëtimin të Israsë dhe Miraxhit, sepse, kur Zoti dëshiron diç, mjafton të thotë **bëhu dhe ajo bëhet.**

Xhamia Al-Aksa ose Mesxhidi Aksa (Xhamia më e Largët), është vendi i tretë më i shenjtë në Islam dhe gjendet në Qytetin e Vjetër të Jerusalemit. Statusi i saj u dokumentua natën e Israsë dhe Miraxhit, meqë Pejgamberi (a. s.) u parapriu në namaz profetëve në Xhaminë Al-Aksa, e cila ishte kible e profetëve para dërgatës së tij. Tradita islame tregon se Muhamedi (a. s.) është falur drejt këtij vendi deri në muajin e shtatëmbëdhjetë pas Hixhrit (emigrimit), kur Allahu e urdhëroi atë që të drejtohet kah Qabeja.

Ascensionin (ngritja) fizike e Muhamedit (a. s.) prej tokës (Mesxhidi Aksasë) deri në pikën më të lartë qiellore, Sidre el-Munteha, është nder dhe respekt për Pejgamberin (a. s.). Gjatë këtij rrugëtimi qiellor pa mrekulli, bisedoi direkt me Krijuesin. Megjithatë, shohim modestinë e pashembullt, të cilën nuk e has dot tek individë të cilët kur ngrihen materialisht, apo me ndonjë çmim apo post, tek ta sheh një person krejtësisht tjetër.

Kjo ndodhi do të mbetet kujtim i përherëshëm në mendjen dhe zemrën e besimtarëve, kur kemi parasysh se faqet e Kuranit famëlartë jo vetëm që e përmendin, por një kaptinë të tij nominohet me emrin *"El-Isra"*.

Ajo çka ia shton edhe më tepër vlerën kësaj ngjarje, kulmin e ndikimit për një kujtim të përherëshëm e zë namazi, i cili

u obligua mu në këtë natë dhe atë direkt nga Allahu Fuqiptotë që është Miraxh për besimtarin, ngase falja e Namazit është mjeti më efikas në ngritjen shpirtërore të besimtarit.

Nga urtësitë e Miraxhit është se Zoti i Madhërishtëm ka dashur t'i nderojë qiejt me dritën e Muhamedit (a. s.), ashtu siç nderoi dy tokat - Mekën dhe Jerusalem me begatitë e Tij, kështu që u ngjit në lartësi.

Ebu al-Abbas el-Dinuri u pyet: Pse Pejgamberi - paqja e Zotit qoftë mbi të, udhëtoi në Jerusalem para se të ngjitej në qiell? Ai tha: Për shkak se Zoti i Madhërishtëm e dinte se jobesimtarët kurejshit e përgënjeshtrojnë atë në atë që u tregonte për lajmet e qiejve, kështu që ai deshi t'u tregojë atyre nga toka, në të cilën ata kishin arritur dhe ekzaminuar. Ata e dinin se Pejgamberi - paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, nuk kishte qenë kurrë në Jerusalem. Kur u tregoi atyre lajmet e Aksasë, siç janë, ata nuk mund t'i mohonin lajmet e qiellit, pasi i besuan lajmet e tokës.

Meqenëse Israja dhe Miraxhi kanë ndodhur që moti, ky rrugëtim duhet të jetojë në zemrat e besimtarëve. Të jetë gjithnjë e më i pranishëm në shpirtin tonë, duke i motivuar besimtarët që të ngrihen shpirtërisht, moralisht, ekonomikisht dhe të hapin shtigje të reja që të përparojnë në të gjitha sferat e jetës.

Përjetimet dhe kënaqësitë shpirtërore që i përjetoi Pejgamberi (a. s.), mënyra e shikimit në dritën hyjnore, si dhe biseda me Zotin, kanë mbetur sekrete në shpirtin e Muhamedit (a. s.), për arsye se përjetimi i këtyre momenteve ka pasur karakter shpirtëror dhe ka qenë delikat, saqë as vetë Pejgamberi (a. s.) nuk ka qenë në gjendje t'i përshkruajë në detaje, ngase njerëzimi nuk është në gjendje t'i kuptojë këto mrekulli nga shkaku i njohurive të pakta që ka mbi kozmosin.

**(Autori është Hoxhë në Xhaminë e Kadrit në Gostivar. Po ashtu, është Profesor në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup)**

# ISRAJA DHE MIRAXHI, POROSITË DHE AKTUALITETI



#### Shkruan: Dr. Islam Islami

Israja dhe Miraxhi bëjnë pjesë në muxhizat më të mëdha të Muhamedit (s.a.v.s.). Isra do të thotë: udhëtim i Muhamedit (a. s.) brenda një pjese të natës nga Mesxhidi Haram (Meka) deri në Mesxhidul Aksa (Kudus, Jerusalem) dhe anasjelltas. Miraxh do të thotë: udhëtim i Muhamedit (a. s.) të njëjtën natë, nga Mesxhidul Aksa deri në botën e lartë transcendentale, në mbretërinë e gjerë dhe të rehatshme të Zotit, deri atje ku nuk ka arritur askush, përpos Muhamedit (s.a.v.s.).

Takimi i Muhamedit (a. s.) me Zotin Fuqiptotë është Ihsan. Kuptimi tjetër me rëndësi që mund të theksojmë është se: Isra është namaz, Miraxhi është ruku, takimi i Muhamedit (a. s.) me Zotin e Lartmadhëruar është sexhde.

Edhe hadithet e Muhamedit (a. s.) vërtetojnë: *"Njeriu më afër Zotit është duke qenë në sexhde."* Duke qenë në sexhde, Muhamedi (a. s.) u obligua me pesë kohë të namazit, të cilat vlerën e kanë sa pesëdhjetë kohë namaz, që ishte një dhuratë për gjithë ne si ummet i Muhamedit (s.a.v.s.).

E gjithë kjo vërtetohet me ajetin kuranor, ku Allahu i Lartmadhëruar thotë: **"Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin**

**e vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidul Haramit (prej Qabesë) deri në Mesxhidul Aksa (Bejtul Mukaddes), rrethinën e së cilës e kemi bekuar; (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet tona. Vërtet, Ai është dëgjues (i fjalëve të Muhamedit), pamës (i punëve të Muhamedit a. s.)."** (Isra: 1)

Këtë udhëtim dhe ngritje Muhamedi (a. s.) nuk thotë që 'unë e bëra'. Zoti (xh. sh.) thotë 'e bëra të udhëtojë robi im në një pjesë të natës prej Mekës në Kudus'. Me fjalën *"robi im"* ka për qëllim Muhamedin (a. s.). Ky udhëtim ishte me trup dhe me shpirt, zgjuar e jo fjetur; pse, sikur të ishte vetëm me shpirt, nuk do të mund të thuhej *"robi im"*, sepse me këtë shprehje nënkuptohet njeriu me trup dhe me shpirt; pra, *rob* apo *njeri* nuk mund të quhet ai që ka shpirt pa trup dhe anasjelltas.

Miraxhi përmendet edhe në suren En-Nexhm. Përveç kësaj, për Isranë dhe Miraxhin bëjnë fjalë edhe shumë hadithe të Muhamedit (s.a.v.s.), të cilat jo vetëm që janë të sigurta dhe autentike, por pa dyshim e arrijnë edhe *gradën e tevaturit*.

Rreth 45 as'habë (shokë) të Muhamedit (a. s.) përcjellin hadithe për Isranë dhe Miraxhin. Në Sahihun e Buhariut dhe të Mu-

slimit janë regjistruar rivajetet e Ebu Dherrit, Malik bin Sa'sait, Enes bin Malikut, Abdullah ibni Abasit, Ebu Hurejres, Xhabir ibni Abdullahut dhe Abdullah ibni Mesudit. Rivajeti që e përcjell Enesi (r. a.) është më i gjerë. Prej Enesit (r. a.) lajmin për Isranë dhe Miraxhin e përcjellin edhe tabiinët.

Koha kur ka ndodhur Israja dhe Miraxhi nuk mund të caktohet saktësisht. Dijetarët janë me opinione të ndryshme për kohën kur ka ndodhur nata e Israsë. Sudiji thotë që ka ndodhur në muajin Dhulkade. Zuhriji thotë që ka ndodhur në muajin Rebiul-evel. Ibn Abdulberri thotë që ka ndodhur në muajin Rexheb. Vaki-diji thotë që ka ndodhur në muajin She-val.

Thuhet që Israja ka ndodhur gjashtë muaj para Hixhretit, ka ndodhur nëntë muaj para Hixhretit, një vit para Hixhretit, një vit e gjashtë muaj para Hixhretit, tre vjet para Hixhretit etj. Atëherë, muaji dhe viti nuk dihen saktësisht dhe ne nuk kemi për qëllim që të dimë saktësisht datën kur i ka ndodhur ky nderim Muhamedit (s.a.v.s.), por duhet të dimë ta jetësojmë dhe t'ua mësojmë fëmijëve tanë ndodhinë e kësaj mrekullie.

Duke u ngjitur në qiell, Muhamedi (a. s.) në të parin (qiell) takon Ademin (a. s.), në të dytin Jahjanë dhe Isain (a. s.), në të tretin Jusufin (a. s.), në të katërtin Idrisin (a. s.), në të pestin Harunin (a. s.), në të gjashtin Musain (a. s.) dhe në të shtatin Ibrahimin (a. s.).

Nëse pyesim se çfarë filozofie qëndron tek shikimi i këtyre pejgamberëve, përgjigjja është se këto janë paralajmërimet se çka do t'i ndodhë Muhamedit (a. s.) me popullin e vet:

Ademi (a. s.) përkujton daljen nga Xheneti në tokë. Për Muhamedin (a. s.) ky ishte si paralajmërim për Hixhretin që do t'i ndodhë për në Medinë, duke përmbledhur të gjitha peripecitë dhe mundimet që ka largimi nga vendlindja, si dhe malli që njeriu ka të kthehet përsëri në vendin ku ka qenë. Isai dhe Jahjai (a. s.) - për hixhretin e dhunshëm që i bënë jahuditë dhe këmbëgjulja e tyre kundër pejgamberëve, që si e si të bëjnë të keqen. Të keqen që i bënë vëllezërit Jusufit (a. s.), kurejshitet ia bënë Muhamedit (a. s.), duke e luftuar deri në zhdukje.

Këtë ua tha kurejshitetë në ditën e çlirimit të Mekës: "Po jua them atë që ua tha Jusufi: 'Mos u mashtroni'." Idrisin - për gradën që ia dha Allahu (xh. sh.) Harunin (a. s.) - sepse populli e deshi, pasi që e mundi pa masë. Musain (a. s.) - për durimin që bëri ndaj popullit të vet.

Këtë Muhamedi (a. s.) e thotë në këtë hadith: "Musain e dhunuan edhe më shumë se kaq, por ai duroi." Ibrahimin (a. s.) - sepse u mbështet në Bejtul Mamur, ku përfundoi edhe Pejgamberi (a. s.) jetën, kur bëri haxhin, kur madhëroi Qabenë.

Këto janë disa nga urtësitë që përmenden në vija të shkurtra në librin *Fet'hul-bari*.

Nga Israja dhe Miraxhi përfitojmë shumë: besimin edhe te gjërat e pakapshme, fizike dhe mendore, besimin tek e mbinatyrshmja, ngase Allahu nuk u nënshtrohet ligjeve të natyrës; vetëdijësimin e myslimanëve, pastrimin e ndërgjegjes së tyre dhe forcimin e identitetit të tyre; faljen e 5 kohëve të namazit, që janë me baraspeshën e 50 namazeve.

Muhamedi (a. s.) do të triumfonte,

edhe pse do të përjetonte mundime dhe lodhje ashtu siç kanë përjetuar edhe pejgamberët e mëhershëm, të cilët i ka takuar njërin pas tjetrit gjatë ngritjes, duke filluar prej Ademit (a. s.), pastaj Jahjain (a. s.), Jusufin (a. s.), Idrisin (a. s.), Musën (a. s.).

Rezultat tjetër është që Muhamedi (a. s.) është ngritur mbi të gjitha krijesat, mbi të gjitha hapësirat dhe horizontet qiellore dhe ka arritur në *Sidretul Munteha*. Israja dhe Miraxhi na bënë të kuptojmë se për krijesat e Allahut nuk di askush, përpos Tij. Israja dhe Miraxhi tregojnë se Islami është fe parlamentare e të gjithë shekujve. Kjo vërtetohet me atë se Muhamedi (a. s.) pasi që e ka kryer Isranë, është bërë Imam i të gjithë pejgamberëve, pastaj e ka kryer Miraxhin.

Rezultati kulmor i Miraxhit është që Muhamedi (a. s.) t'i shohë ajetet e Allahut dhe të takohet drejtpërsëdrejti me Allahun, ndërsa sa u përket besimtarëve, ata do ta përjetojnë shikimin në Allahun në botën tjetër.

Është e preferueshme që të takohesh me njerëzit e dalluar, t'i lëvdosh ata dhe të lutesh për ta. Lejohet që njeriun e besueshëm ta lëvdosh.

Udhëtimi natën është më i preferueshëm nga udhëtimi ditën – kjo, duke u mbështetur në Isranë, ndaj shumicën e ibadeteve Pejgamberi (a. s.) e bënte natën. Përvoja është më e dobishme sesa mësimi që ke. Këtë e marrim nga Musa (a. s.).

Krahas këtyre, Muhamedi (a. s.) pa Xhenetin dhe Xhehenemin që përmend dhe për to thotë se janë krijuar...

**(Autori është Profesor në Medresenë Isa Beu, Shkup)**



# NATA E MADHE E REGAIBIT

Nata e shënuar Regaib kuptimin e ka marrë nga shumësi i fjalës "ragibe" në gjuhën arabe, që do të thotë dëshirë, prirje, interesim. Besohet se në këtë natë mëshira, ndihma dhe bujaria e Allahut shpërndahen me tepërsi.

Nata e shënuar Regaib, sipas kalendarit hënor, është nata duke u gdhirë xhumaja e parë (nata që lidh ditën e enjte me të premte) e muajit Rexheb, që është dhe muaji i parë i Tre Muajve të begatë.

Çdo natë e xhuma është e bekuar. Kur këto dy net puqen bashkë, nata bëhet akoma më e bekuar dhe më e dobishme.

Me vlerat e mëdha që përmban kjo natë, është njëkohësisht sihariqi dhe lajmëtari i parë i muajit Ramazan. Në aspektin psikologjik, kjo është shumë e rëndësishme, sepse besimtari hyn në një parapërgatitje shpirtërore dhe e drejton veten e tij kah adhurimet, kah përgjegjësitë individuale dhe familjare, duke urdhëruar të mirën e duke ndaluar të keqen.

Sipas mendimeve të dijetarëve islamë, në këtë natë Allahu i madhërishtëm e ka begatuar pejgamberin Muhamedit (a. s.) me dhunti dhe me dhurata shpirtërore shumë të çmuara.

Allahu Natën e Regaibit u jep myslimanëve mirësi dhe begati të panumërta. Kjo është nata kur pranohen lutjet, pendesat dhe kur shpërblimet e adhurimeve janë të mëdha e të shumta.

Pejgamberi ynë i nderuar, në një hadith të transmetuar nga Enesi (r. a.), ka thënë: "Kujdes, përpiku të rrish zgjuar natën e xhumasë së parë të muajit Rexheb, të mos e kalosh atë në shkujdesje, sepse engjëjt asaj nate ia kanë vënë emrin Regaib!"

Ndërkaq, në disa thënie të tjera për rëndësinë e kësaj nate pejgamberi Muhamed (a. s.) është shprehur: "Atë që e vlerëson natën e xhumasë së parë të muajit Rexheb (Nata e Regaibit) Allahu i madhërishtëm nuk e dënon në varr." (Saadet-i Ebedije); "Lutja që bëhet në



këto pesë net nuk kthehet mbrapsht: në Natën e Regaibit, në natën e 15-të të Shabanit, në natën e xhumasë, në natën e Baranit të Ramazanit dhe të Kurbanit." (Ibn-i Asakir)

Për besimtarët myslimanë, në veçanti, si çdo festë fetare e çdo besimi në përgjithësi, ka domethënie më të gjerë se vetë emri. Ato manifestojnë bindshëm, me anë të mesazhit që sjellin, qëllimet dhe ndikimet në dobi të shndërrimeve pozitive të figurës njerëzore, në dobi të vetes, të familjes, të shoqërisë e të kombit. Ato shpallin para shoqërisë njerëzore nevojën për dashurinë ndaj njëri-tjetrit, për unitetin, harmoninë, mirëkuptimin dhe vëllazërimin nëpërmjet ndjenjës humane që buron nga Krijuesi i vetëm, nga një Zot i vetëm, ndjenjë të cilën vetë Zoti e bëri pjesë integrale të personalitetit të njeriut, duke mos e përkufizuar atë te ndonjë racë, ngjyrë apo klasë shoqërore, por duke e barazuar shoqërinë njerëzore nëpërmjet angazhimeve morale-qytetare, ku çdo njeriu i kërkohet të jetë shembull i dalluar i ndershmërisë dhe i përzemërsisë, ku çdo njeriu i kërkohet të plotësojë detyrat e tij në mënyrë korrekte, të kërkohet dituri e virtyt dhe të zhvillojë një kuptim më të mirë të vetëdijes sociale, duke ushqyer ndjenjë përgjegjësie për fatet e tij, të familjes e të shoqërisë.

Çdo festë fetare është njëkohësisht

edhe angazhim për mbrojtjen e nderit, të dinjitetit, të kombit e të atdheut. Fetarizimi i njerëzve asnjëherë nuk do të thotë dhe nuk duhet të kuptohet si rrugë që mënjanon cakun dhe qëllimin e përkatësisë kombëtare. Përkundrazi, fetarizimi i tyre do të thotë përmbushje e koncepteve me përmbajtje kombëtare në favor të paqes, të lirisë e demokracisë, të punës e të progresit, të mbrojtjes së gjuhës, të kulturës dhe të vlerave që e karakterizojnë dhe e dallojnë një komb.

Për besimtarët myslimanë çdo festë fetare, ashtu si edhe kjo që po përkujtojmë tani, duhet të jetë shkas për reagime të sinqerta në drejtim të asaj që është bërë, të asaj që po bëhet dhe të asaj që duhet të bëhet në favor të formimit të personalitetit si besimtar e qytetar dhe si adhurues, gjithnjë me qëllim të palëkundshëm për të çuar përpara afirmimin e figurës njerëzore drejt qëllimeve më fisnike, duke pasur gjithnjë parasysh porosinë e Krijuesit tonë në fjalën e tij në Kuran, ku thotë: "O ju që besoni, kijeni parasysh frikën ndaj Allahut dhe le të shikojë njeriu se çfarë ka bërë për nesër dhe kijeni frikë Allahun, se nuk ka dyshim se Allahu është në dijeni për çdo detaj të asaj që punoni." (Hashr: 18)

Burimi/në bashkëpunim: <http://islam.i.al/nata-e-madhe-e-regaib-it-shenon-fillimin-e-tre-muajve/>

# RËNDËSIA E MUAJIT REXHEB

Nga Imer ef. Jusufi

Thotë në një hadith Muhamedi (a. s.) për hyrjen në muajin Rexheb: “O Allah, Na beko në Rexheb dhe në Sha’ban, dhe na mundëso ta presim Ramazanin.”

Fjala **Rexheb** (Rexhep) rrjedh nga **Ruxhub** në arabisht, që ka kuptimin e madhështisë dhe të shenjtërisë.

Muaji Rexheb është një prej muajve të shenjtë. Në këtë muaj ka ngjarë mrekullia e Israsë dhe Miraxhit. Ai na kujton rëndësinë e vendeve tona të shenjta dhe na bën thirrje që të mos i harrojmë dhe neglizhojmë.

Muaji Rexheb është një nga dymbëdhjetë muajt hënorë arabë dhe islamë. Fjala **Rexheb** vjen nga **Terxhib**, që do të thotë madhështi dhe shenjtërim. Ndoshta ky muaj e ka marrë këtë emër për shkak se arabët e specifikonin për gjëra të shenjta.

Rexhebi shpeshherë etiketohet si “Rexheb haram”, sepse është një nga katër muajt e shenjtë në të cilët ndalohet rreptësisht lufta, gjë kjo e njohur që në kohë të lashta. Kurani fisnik i përmend katër muajt e shenjtë në ajetin: “**Vërtet, numri i muajve tek Allahu është dymbëdhjetë, sipas Librit të Allahut, që prej ditës kur krijoi qiejt dhe Tokën. Katër prej tyre janë të shenjtë, sipas besimit të drejtë. Prandaj, mos i bëni vetes dëm, duke i shkelur këta muajt!**”

(Teube: 36)

Katër muajt e shenjtë janë: Dhul Kide, Dhul Hixhe, Muharrem dhe Rexheb.

Thotë pejgamberi Muhamed (a. s.): “**Koha është rrotulluar në pozicionin e parë kur Zoti i lartësuar krijoi qiejt dhe Tokën. Viti është dymbëdhjetë muaj, ku katër prej tyre janë të shenjtë, tre të njëpasnjëshëm: Dhul Kide, Dhul Hixhe, Muharrem dhe Rexheb, që është mes Xhumada dhe Shaban.**”

Muaji Rexheb njihet ndryshe si muaji tek, pasi ai nuk vjen pas tre muajve të tjerë. Muajt Dhul- Ka’de, Dhul-Hixhe dhe Muharrem vijnë njëri pas tjetrit, kurse Rexheb vjen pas pesë muajsh, pas Safer, Rebiul Evvel, Rebiul Ahar, Xhumadal Ula dhe Xhumadal Ahar.

Muaji Rexheb njihet ndryshe si **Rexheb Mudar**, pasi fisi mudar e shenjtëronte këtë muaj dhe ia respektonte vlerat.

Gjatë muajit Rexheb ndodhi dhe mrekullia e Israsë dhe Miraxhit, një nga mrekullitë më të mëdha me të cilat u nderua i dërguari i Zotit, pejgamberi Muhamed (a. s.). Këtë ngjarje e ka përmendur Zoti në Kuran: “**I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhamedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jerusalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t’i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.**” (Isra: 1)

Ashtu siç ceket dhe në suren Nexhm, ajetet 7-18: “**Pastaj iu afrua e iu lëshua, sa largësia midis dy harqeve ose edhe më afër, e i shpalli robit të Allahut atë që i shpalli. Zemra (e Muhamedit) nuk gënjen për atë që ka parë. Vallë, a do ta kundërshtonit atë për çfarë ka parë, ndërkohë që ai e ka parë atë edhe një herë tjetër, te Sidretul Munteha-ja, ku ndodhet Xheneti i Strehimit. Kur Sidrën, çfarë nuk e mbulonte?! Shikimi i tij nuk u shmang dhe as nuk e kaloi masën, por ai pa disa nga mrekullitë më madhështore të Zotit të tij!**”

Mrekullia e Israsë ishte një nder dhe vlerësim i madh për të dërguarin e Zotit, Muhamedin (a. s.), që i dha zemër. Gjatë këtij udhëtimi ai u prezantua me mbretërinë e qiejve dhe të Tokës. Udhëtimi ishte një formë shplohjeje dhe qetësimi, pas vdekjes së xhaxhait të tij Ebu Talib dhe gruas Hatixhe, si dhe pas kthimit pa ndonjë rezultat nga Taifi.

Mrekullia e Israsë na kujton detyrimin tonë për ta pastruar tokën dhe për t’i çliruar njerëzit nga dhuna dhe ligësia.

Është obligim i çdo besimtarë që gjatë muajit Rexheb të reflektojë dhe të bëjë çmos për të mirën e vet dhe të popullit. Zoti e di më mirë.

(Autori është Imam i Xhamisë Sulltan Pajazit në Kërçovë. Është nga Radusha, Shkup) 23.03.2017

# MASAKRA E REÇAKUT, TRISHTIM DHE MOS’HARRIM

**Islami i ka të gjitha prerrogativat për të qenë pjesë integruese në shoqëritë multikulturore në Evropë, sepse ai është besim, dije e shkencë, paqe e tolerancë, art e kulturë, koncept i barazisë njerëzore, frymë e pastër e kultivimit të diversitetit të vlerave, debat dhe dialog që bazohet në argumente dhe i aftë të notojë edhe në sferën e globalizmit botëror, duke evituar fuqishëm radikalizmin, ekstremizmin dhe terrorizmin.**



Nga Shaqir ef. Fetahu

1.

Para 24 vitesh, më 15 janar 1999, ndodhi masakra e paparë në Reçak të Kosovës nga forcat dhe paramilitarët serbë, me ç’rast 45 shqiptarë humbën jetën. Ajo tronditi botën, trishti vetëdijen njerëzore, nënçmoi vlerën njerëzore, dëshmoi edhe një herë se politika makabre serbo-sllave nuk ka shpirt dhe se jeta e njeriut për ta është diçka më e lira që mund të ekzistojë, në veçanti ajo shqiptare. Të gjitha viktimat ishin civilë dhe këtë e konstatoi Ambasadori i OSBE-së, William Walker. Lufta për liri dhe demokraci e UÇK-së kishte kohë që kishte filluar.

Martirët e Reçakut ngelin të gjallë në zemrat, në shpirtin, në mendjen dhe në vetëdijen tonë, për të qenë të përgatitur në çdo moment dhe inspirim për të punuar për liri dhe respekt ndaj njeriut, në veçanti për fe e atdhe.

2.

Intelektuali duhet të reflektojë urtësi dhe maturi, sepse kjo është rruga e vetme drejt shpirtit dhe zemrës së njerëzve. Zemra është e ngurtë dhe e mbyllur ndaj agresives, ndaj aversionit, ndaj alogjikës. Andaj, me rëndësi është të depërtosh te zemrat e njerëzve, te vetëdija dhe bindja e tyre. Sa i lartë është koncepti islam mbi parimin se besimi nuk është çështje e dhunës, por çështje e të vërtetës, e realitetit, e të drejtës, e shpirtit dhe e zemrës!

Atëherë, të reflektojme te njerëzit të bukurën, urtësinë, mençurinë, që nuk shqetëson njeriun dhe shoqërinë dhe jep

afërsinë mes njerëzve, që jep shpresën për të vepruar për të mirë, me besim tek e ardhmja, kurdoherë në mbështetje të vlerave. Kështu na do Zoti.

3.

Koha kërkon që pjesëtarët e Islamit të jenë të gatshëm dhe dinjitoz të prezantojnë vlerat e Islamit në kohë dhe në vend, duke iu qasur nga të gjitha aspektet ideve të tij hyjnore.

Me këtë, vazhdojmë të ndjekim rrugën e zhvillimeve të arta në historinë e pjesëtarëve të Islamit, që kulminoi me nivelin e lartë të shkencës, të ekonomisë, të kulturës, të moralit, të artit, të paqes, të barazisë, të lirisë, të humanizmit etj. në Andaluzi – në Spanjën e sotme, që nxori në skenën botërore kolosët e historisë shkencore: Ibn Haldunin, Farabiun, Ibn Rushdinë, Ibn Sina-Avicenën, El-Kindiun, Gazalin, Ibn Tufejlin etj. dhe inspiroi zhvillimet e gjithanshme në Evropë e më gjerë.

Andaj, kjo është domosdoshmëri e kohës dhe e hapësirës për të konkurruar me vlera për të notuar në ambientin bashkëkohor dhe për t’ia prezantuar skenës së zhvillimeve botërore vlerat madhore, universale dhe humane të Islamit.

4.

Islami në Evropë sot është çështje e debateve dhe e konferencave ndërkombëtare. Vetë fakti i analizave rreth tij, dëshmon në prezencën e tij në këto hapësirë të civilizimeve dhe të kulturave të ndryshme.

Prezenca e Islamit kryekëput varet nga vetë pjesëtarët e Islamit, se si do t’i qasen këtij prezantimi. Islami i ka të gjitha prerrogativat për të qenë pjesë integruese në shoqëritë multikulturore në Evropë, sepse ai është besim, dije e shkencë, paqe e tolerancë, art e kulturë, koncept i barazisë njerëzore, frymë e pastër e kultivimit të diversitetit të vlerave, debat dhe dialog që bazohet në argumente

dhe i aftë të notojë edhe në sferën e globalizmit botëror, duke evituar fuqishëm radikalizmin, ekstremizmin dhe terrorizmin.

Fryma njerëzore dhe paqësore e mesimit Islam është sot një vlerë e hapur dhe në qendër të vëmendjes së zhvillimeve të reja botërore dhe, si i tillë (Islami), kuptohet nga të gjithë.

5.

Viti në të cilin kemi hyrë jep shenjë për një relaksim të situatës dhe krijimit të një ambienti edhe më të mirë, për suksese në jetën fetare-islame. Kur arriam në kohëra të vështira të pandemisë dhe të krizës ekonomike të lëvizim në mënyrë stabile, jemi të bindur se në këtë vit (2023), me ndihmën e Zotit dhe me mobilizimin tonë të përgjithshëm, të të gjitha strukturave, do të kemi ngritje edhe më të mëdha - si në sferën morale, po ashtu edhe në segmentet tjera të përgjithshme.

Të mendojmë racionalisht për të ardhmen tonë morale-shpirtërore, e cila i sjell pastaj të gjitha të mirat dhe begatitë.

Ky vit do të jetë vit i projekteve, i dinamizmit, i racionalizmit, i zhvillimit në sfera të ndryshme; i ndërtimit dhe i shumë punëve të tjera të mbara. Këtë e tregon vërshimi i regjistrimit të haxhinjve gjashtë muaj para shkuarjes në vendet e shenjta: tashmë janë afër 2000 kandidatë të regjistruar për të kryer Haxhin lirshëm, pa pandemi e kufizime të ndryshme.

Faleminderit të gjithëve për angazhimin maksimal për t’i tejkaluar dhe përballuar me sukses këto vite të rënda, nga të gjitha aspektet. Ne ia dolëm, ato vështirësi tash janë prapa nesh, mirëpo ne duhet planifikuar dhe vepruar, ndërsa është i Madhi Zot që vendos.

Na priftë ndihma e të Madhit Zot. Kështu na do i Madhi Zot.

(Autori është Kryetar/Reis’ul-Ulema i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut)

# TAKOHU PAK ME SUREN KASAS

“**A**ta thanë: ‘Ne nëse ndjekim rrugën e drejtë së bashku me ty, ne me të shpejtë do të jemi të dëbuar prej vendit tonë!’” (El-Kasas: 57)

Feja nuk është vetëm bindje, por edhe udhëzim. Sot na flasin disa nga përfaqësuesit (shpirtërorë, politikë etj.) për atë që do që të dëgjojë populli, por e bëjnë atë që thellë e urren, që e gjykon populli.

Nuk mjafton vetëm njohja e problemeve, por duhet edhe guxim për të prirë në zgjidhjen e tyre, ose për të përkrahur ndryshimin; vajtimi i të sotmes nuk e sjell të nesërmen e dëshiruar pa përpjekje.

Një shoqëri e varfëruar dhe e frikësuar për të ardhmen e vet, vështirë e ka që të

jetë pjesë e ndryshimit, veçanërisht kur institucionet vitale janë jo mjaft të besueshme; besa, në të vërtetë, të pabesueshme.

Kur pushtetin e ka zhurmuesi, i korruptuari - ai që të “qetëson” me një telefon në ndjekje është i sinqerti, i besueshmi, i drejti.

Atdhedashuria thellë është e mbjellë në shpirtin e njeriut; aty gjen prehjen dhe qetësinë. Largimi prej aty është vështirësi e madhe, prandaj duhet mendjeprehtësi për përfaqësim.

Ajeti i lartpërmendur na e qartëson se ka shoqëri që e dinë, që e njohin fenë, gjendjen e tyre politike, edukativo-arsimore, shpirtërore, institucionale, mirëpo

nuk dëshirojnë të prishin rehatinë, sigurinë, të ardhurat ekonomike të tyre, edhe pse me sy e shohin se nesër pranë vetes mund të mos jenë bashkë me fëmijët e tyre.

Parandalo me edukim, me arsimim, me bindjen që ke - në këtë rast: me meditim rreth ajeteve kuranore - se si të mos e lejosh veten që të mbash një mal të korruptuarish mbi shpinën dhe ndërgegjen tënde.

Ajeti i lartpërmendur është një perlë që i shkon secilit që nuk ka inat. O Zot, nëse nuk i prijmë ndryshimit, le të jenë të sigurt të tjerët nga e keqja e punëve tona. Amin.

(Burimi: Myftinia e BFI-Dibër, F. 19.01.2023)



# PËR KREDON ISLAME



*Nga Taxhudin Hamidi*

Çdoherë kur kërkojmë definimin e religjionit, ne në kontinuitet tërheqim vijnë dalluese mes besimit dhe mosbesimit. Pra, në çdo kohë dhe në çdo situatë paraqitja e normave juridike religjioze, të asaj islame, konsiston në parimet themelore apo të kredos islame.

Lutja e Muhamedit (alejhis-selam) që i drejton Krijuesit të Gjithësisë na inkurajojnë dhe na thotë:

**“Allahume ja mufetihul ebvabi iftah lena hajrel ebvabi ja hajrel fatihijne”** (O Zot i Gjithësisë, që hap dyert /e suksesit/, të lutemi, hapi për ne dyert e hairit; o hapës i të gjitha dyerve të hairit).

Sipas mesimit islam, Kurani është fjalë e Zotit, fjalë hyjnore e përjetshme, jo e krijuar, fjalë e ardhur me urdhër të Allahut, në një tabelë të ruajtur mirë në qiell - al lawh al mahfuz.

Lajmëtar i revelatës hyjnore, Xhebraili, kohë pas kohe vinte sipas nevojës dhe sipas urdhrat të Zotit për të kënduar një pjesë të caktuar të Kuranit - kësaj formule të përjetshme shembullore.

Pa diskutim, Kurani është burimi themelor dhe kryesor i predikimit dhe interpretimit islam.

Ai i përmban parimet kryesore të kredos islame, të bontonit moral dhe juridik. Është përmbledhje e rregullave në bazë, që të ndërtohen kredoja islame dhe parimet themelore të Islamit, mbi të cilat ngrihet dhe zhvillohet jeta materiale dhe shpirtërore e myslimanëve.

Periodha e kaluar në anketat, analizat dhe studimet e mirëfillta, sa ishte prezente në jetën shoqërore dhe në jetën e politikave të shëndosha, për një bashkëpunim të shëndoshë, me hartime dhe projekte për perspektivën e kredos islame?

Sa është punuar që kredoja islame të gjejë ririnë dhe iniciativat e duhura dhe vendin në arsim dhe në sistemin pedagogjik publik? Sa janë siguruar punimet shkencore që garantojnë perspektivën e saj, jo vetëm në rrafshin individual, por edhe në dimensionin kolektiv dhe shoqëror?



Të gjitha këto pyetje e rëndojnë perspektivën e mendimit progresiv përbrenda platformës fundamentale të ibret-names në trojet shqiptare me nota folklorike dhe me manifestime të inventarizimit tautologjik dhe të ekzagjerimit demagogjik, me madhësi të një dioptrie të lartë daltonike.

Jeta duhet të shikohet në mënyrë shumë praktike dhe jo nga sfera e notave folklorike dhe përmes prizmit demagogjik, me afat të skaduar apo të bankrotit dhe të falimentimit, pa mundësi rehabilitimi.

Sepse, çdo tentim se do të zbulojmë dhe do të kapërcejmë krizat kulturore, shkencore, ekonomike dhe politike duke trajnuar seanca nga manifestimet më të sofistikuar demagogjike, si ato të periudhës moniste, qoftë edhe të natyrës së leximit të Kuranit, paraqet një pengesë drejt botës reale dhe të zhvillimit akademik shkencor.

Kurani, si libër hyjnor, nuk mund të shndërrohet në mjet estrade dhe euforizmi, por nga ai pritet studimi dhe prej tij (prej studimit) të nxjerrim parime, rregulla dhe ligje duke trasuar një sistem jete të stabilitetit dhe një sistem demokratik të jetës.

Proceset e promovimit dhe të manifestimeve për të arritur një synim të caktuar, kanë një normë dhe një limit ‘kur’ dhe ‘sa’ dhe jo (ato procese të jenë) me karakter të

vazhdueshëm, me dekada, sepse kjo kalon më pas në utopi dhe në inaugurim të figurave përçarëse dhe devijante.

Kjo filozofi e të menduarit nuk mund të rikthejë politikën e mosbesimit të figurat të cilat asnjëherë nuk kanë pasur për synim bashkimin dhe asnjëherë nuk kanë deklaruar edhe një fjalë bindëse para popullit në lidhje me sistemin islam dhe demokratik.

Njeriu nga natyra e tij të kaluarën e shikon si një periudhë të rëndë dhe delikate. Ndërsa të tashmen, si periudhë të re. Por, pa diskutim, të ardhmen e kanë shikuar me shumë fobi dhe me shumë frikë.

Të jesh në kuptimin e plotë njeri, do të thotë të jesh me kuptimin e plotë në shërbim të kredos islame. Të gjitha veprat dhe aktivitetet që kanë pezulluar kontinuitetin e duhur dhe nuk e kanë përfunduar kapitullin e suksesit dhe të kredos islame dhe kombëtare, vështirë se mund ta fitojnë besimin e qytetarëve.

Kredoja islame dhe parimet themelore të saj dëshirojnë largimin nga legjendat dhe mitet greke. Kështu, shpresojmë që viti kalendarik 2023 të funksionojë me një orientim programor shkencor dhe besimor për të ardhmen e të rinjve shqiptarë.

Ajo rini: të luftojë të gjitha kategoritë dhe projektet e mbushura me gabime dhe falsifikime; të evitojë shovinizmin dhe urrejten ndaj kredos islame; të përpiqet që të hartojë projekte dhe informata të sakta; të organizojë sistemin administrativ dhe gjyqësor.

Besimi i humbur mund të fitohet vetëm nëse konkludojmë se përparimi njerëzor varet nga Krijuesi i Gjithësisë dhe nga ligji i Atij që ka krijuar Gjithësinë.

Çka duhet të bëjmë ne? Të flakim rolin nënçmues dhe orientimin e gabuar politik me përmbajtje të notave folklorike, sepse kështu do të bëjmë përparim në progresin mendor, me angazhim praktik dhe bashkëveprues.

Në Kuran thuhet: *“Ndihamoni në të mirë dhe devotshmëri dhe mos ndihamoni në mëkat dhe në urrejtje...”*

**(Autori është Referent i Vakëfit në Myftininë e BFI-Tetovë)**

# REÇAKU, ME GRADAT MË TË LARTA TË XHENETIT



Duka Erjon: Falja e namazit të xhenazes për 45 viktimat e masakruara në Reçak (Kosovë) nga terroristët serbosllavë më 15 janar 1999. Rahmet u pastë shpirti. EL-FATIHA

Eljasa Mahmudi: Allahu i mëshiroftë dhe i shpërbleftë me gradat më të larta të

Xhenetit 45 dëshmorët e Reçakut dhe të gjithë dëshmorët e Kombit, që u flijuan për Çlirimin dhe Pavarësinë e Kosovës! Amin! - 24 vjet nga masakra e tmerrshme e Reçakut (15.01.1999).

Historia: Një ditë pas masakrës, William Walker, ambasadori i OSBE-së në



Kosovë, vizitoi vendin e ngjarjes dhe u tmerrua nga kufomat e masakruara. Ai deklaroi: "Nga ajo që pashë, nuk nguroj të përshkruaj ndodhinë si masakër dhe krim kundër njerëzimit. Kjo është ngjarja më trishtuese në jetën time." Lajmi i masakrës senzibilizoi opinionin ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë dhe u hap rrugën bombardimeve të NATO-s në Serbi.

# MIRËSEARDHJE PËR BASHKATDHETARËT

Mirë se na vini, bashkatdhetarë të nderuar, ka shkruar Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në faqen e vet në Facebook më 26 dhjetor, 2022.

Vendi ynë, ka thënë ai, është gjallë-

ruar dhe është gëzuar me ardhjen masive të bashkatdhetarëve tanë nga vendet e largëta të Evropës. Ata vijnë me mall dhe ne i presim me mall. Gëzohemi që e duan vendlindjen e tyre. Andaj, ju shprehim mirëseardhje në shtëpitë e tyre. Meritojnë t'i presim me të gjitha respektet, sepse ata

edhe larg vendit kontribuojnë me të madhe në gjithçka që i duhet vatanit. Të jemi në shërbim të tyre.

Mirë se vini, bashkatdhetarë të nderuar, dhe paçit bekimin e Zotit të Madhërishtëm, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

# “HËNA E RE” EDHE NË DY GJUHË

Në fund të vitit 2022 dhe në fillim të vitit 2023 doli nga shtypi edhe një edicion i revistës “Hëna e Re”, tash në gjuhën turke (“Hilal”) dhe në gjuhën maqedonase (“Млада месечина”), thuhet në njoftimin e BFI.

Është ky numri 134 i tyre. Revista është periodike dhe e vazhdon traditën e botimit, të filluar këtu e 35 vjet më parë. Kryeredaktor i pjesës turqisht është Nizam Reshit (Nizam Rešit), ndërsa i pjesës maqedonisht Hasan Xhillo (Хасан Џило).

BFI e RMV gjithnjë ka bërë përpjekje që të kënaqen nevojat e të gjithë besimtarëve islamë, varësisht prej gjuhëve të tyre, qoftë përmes këtyre revistave, si komuni-



katave të publikuara shqip, turqisht, maqedonisht, anglisht, boshnjakisht dhe në gjuhën rome në faqet e saj elektronike.

BFI e RMV dhe Kryetari i saj, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, gjithnjë



janë pranë besimtarëve, jo vetëm në fushën e informimit, dhe kështu do të jetë edhe në të ardhmen.

Zoti na ndihmoftë, thuhet në njoftimin e BFI. (8.01.2023)

# MEDRESEJA ISA BEU ME PAMJE TË REJA

Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir Fetahu, më 5 janar, 2023, mori pjesë në mbledhjen e rregullt të SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup dhe u bëri një shikim rasti hapësirave të saj, thuhet në njoftimin e BFI.

Mbledhja u udhëhoq nga Drejtori i Përgjithshëm, prof. Ibrahim ef. Idrizi, dhe në të morën pjesë Administratorët e Paraleleve të Shtrira, bashkë me mësimdhënësit dhe mësimdhënëset.

Mbledhjen e shpalli të hapur Drejtori i Përgjithshëm, i cili, pasi i përshëndeti të pranishmit dhe prezencën e Reis'ul-Ulemasë, menjëherë i dha fjalën Kryetarit të BFI të RMV, i cili falënderoi Drejtorin dhe Drejtorinë, Administratorët dhe mësimdhënësit dhe, mes tjerash, konstatoi me sa vijon:

1. Me gjithë vështirësitë me të cilat po ballafaqohet vendi ynë, Medreseja me përpjekjet e saj maksimale në mënyrë stabile dhe normale e ka realizuar procesin edukativo-arsimor;

2. Njoftova rreth akreditimit të Medresesë, duke shpjeguar përpjekjet që bëhen drejt realizimit të këtij synimi;

3. Përpjekje nga të gjithë faktorët e BFI që në këtë kohë të migrimit të hovshëm, të sigurojmë kandidatë për nxënës të rregullt;

4. Uroj përfundimin e gjysmëvjetorit



të parë dhe pushim të këndshëm.

5. BFI e RMV gjithmonë do të jetë në shërbim të institucioneve fetare-arsimore, si bazë për ngritjen e kuadrove fetare.

Reis'ul-Ulemaja përcolli edhe punët e renovimit të pjesërishëm të Medresesë Isa Beu, thuhet në njoftimin e BFI: Ambulanca e Medresesë me pamje të re dhe nisja e idesë për ndërtimin e sallës sportive për nxënësit.

Me këtë rast, i prirë nga Drejtori Ibrahim ef. Idrizi, Reis'ul-Ulemaja vizitoi disa mësojtore dhe Ambulancën, të cilat tashmë po renovohen. Në veçanti i la përshlytje renovimi dhe rregullimi i Ambulancës, e cila tani i ngjan një ambulance

moderne, me të gjitha kushtet - nga ordinanca e mjekut, ordinanca e kontrollit mjekësor dhe dhomat e shtrirjes për pacientë.

Reis'ul-Ulemaja përshëndeti krijimin e kushteve sa më të mira dhe premtoi se aty ku e do nevoja, BFI e RMV do të ndërtojë me mjete materiale.

Në bisedë me Drejtorin e Përgjithshëm, me Drejtorinë dhe mësimdhënësit, sot u vendos dhe u bisedua për idenë e ndërtimit të sallës sportive dhe të fizikulturës. Tashmë plani ideor është kryer dhe u bisedua për plotësimin e dokumentacionit për ndërtim, thuhet në njoftimin e BFI.

# "MEDRESEJA ËSHTË AJKA E BFI-së"



Këshilli Edukativo-Arsimor i Medresesë Isa Beu në Shkup, në mbledhjen e mbajtur më 5 janar, 2023, e vlerësoi punën e Shkollës në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2022/2023 dhe konstatoi se është e suksesshme, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Kjo mbledhje u mbajt në lokalet e Medresesë-Qendër, ku kanë marrë pjesë të gjithë këshillat e klasave të Paraleleve të Shtrira, me të gjithë mësimdhënësit e Medresesë.

Në mbledhje mori pjesë dhe Reis'ul-

Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahhu, i cili shprehu falënderime për kontributin e mësimdhënëseve në sferën e edukimit e të arsimimit dhe e vlerësoi lart punën e mësimdhënëseve të Medresesë, duke potencuar se Medreseja është ajka e Bashkësisë Fetare Islame.



Këshilli Edukativo-Arsimor, i udhëhequr nga Drejtori i Përgjithshëm, prof. Ibrahim Idrizi, diskutoi për Raportin me shkrim nga kujdestarët e klasave për suksesin, sjelljen e nxënësve dhe mungesat në gjysmëvjetorin e parë, pastaj për Ra-

portin nga profesorët e lëndëve për realizimin e planprogrameve, Raportin me shkrim nga Këshilli i Edukatorëve për realizimin e rendit shtëpiak, Verifikimin e rezultateve të provimit nga sesioni i janarit 2023 për nxënësit me korrespondencë dhe ata të diplomës, fillimin e gjysmëvjetorit të dytë etj.

Anëtarët e Këshillit Edukativo-Arsimor të Medresesë Isa Beu u shprehën të kënaqur me suksesin, me shpresë që në të ardhmen të punohet edhe më mirë, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

# MEREMETOHET SELIA E BFI-së

Fotografi nga Rijaseti: Selia e BFI-së me pamje të re - ka nisur ideja e Selisë së re, thuhet në njoftimin e BFI të RMV të datës 9 janar, 2023.



# BISEDOHET PËR AKREDITIMIN E MEDRESESË



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti z. Ahmed Qazimin, Përgjegjës për Arsim në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Takimi u mbajt më 17 janar, 2023, në Kabinetin e Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame në Rijaset.

U bisedua rreth çështjes së akreditimit të Medresesë Isa Beu, që është në

proces e sipër, duke u njoftuar me kërkesat në vazhdim të kësaj çështjeje.

U bisedua edhe për shumë çështje të tjera me rëndësi, thuhet në njoftimin e BFI.

# NDIQET FJALIMI VJETOR I PRESIDENTIT PENDAROVSKI



Më 22 dhjetor, 2022, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu ishte në Kuvend dhe ndoqi fjalimin vjetor të Presidentit Pendarovski para deputetëve, thuhet në njoftimin e BFI.

Pjesëmarrja ishte me ftesë të Kryetarit të Kuvendit të RMV, z. Talat Xhaferi. Në Mbledhjen e Nëntëdhjetegjastë Presidenti i shtetit, z. Stevo Pendarovski, mbajti

fjalimin e fundvitit.

Ishin të pranishëm Kryeministri z. Dimitar Kovačevski dhe anëtarët e Qeverisë, Kryetari i Kuvendit z. Talat Xhaferi, deputetët, kori diplomatik, krerët e Bashkësive Fetare, si dhe figura eminente të jetës politike dhe publikë në RMV.

Presidenti Pendarovski bëri një rezymë për të gjitha aktivitetet e Presiden-

cës për vitin që lamë pas. Ai mes tjerash theksoi shqetësimin për eskalimin e luftës në Ukrainë dhe ndikimin që ka kjo luftë në tërë Evropën dhe botën, e veçanërisht në sferën ekonomike në vendin tonë. Gjithashtu, ai foli edhe për sukseset e arritura në vend, por dhe për marrëdhëniet në punët e jashtme me fqinjët e RMV dhe me vendet tjera, thuhet në njoftimin e BFI.

## REISI NË FSHI

Në mbledhjen e Fakultetit të Shkencave Islame (FSHI) në Shkup: Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu mori pjesë në mbledhjen e rregullt të FSHI-së, të udhëhequr nga Dekani, prof. dr. Shaban Sulejmani, thuhet në njoftimin e BFI.

Me këtë rast, theksohet, Kryetari i BFI të RMV përcolli me kujdes të gjitha angazhimet e FSHI dhe, njëherësh, njoftoi të pranishmit me rrjedhat në BFI të RMV.

Në mbrojtje të diplomës në FSHI: "Me ftesë të familjes Emini dhe Neziri,

mora pjesë në mbrojtje të diplomës së zonjës Juleda Neziri Emini me temë 'Devotshmëria sipas Kuranit dhe Sunnetit'. Komisioni përbëhet nga prof. dr. Shinasi Mehmedi (kryetar), prof. dr. Abdylxhemil Nesimi (mentor) dhe prof. dr. Naser Ramadani (anëtar). Ishte një mbrojtje e shkëlqyer, në një procedurë të nivelit të lartë", ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

Pas mbrojtjes së suksesshme, thuhet më tej në njoftim, fjalë përshëndetëse mbajtën Reis'ul-Ulema h. hfz.

Shaqir ef. Fetahu, Dekani i FSHI prof. dr. Shaban Sulejmani, Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli. Ata e vlerësuan lart temën dhe dijen e treguar nga kandidatja Juleda Neziri Emini.

Në emër të familjes përshëndeti dhe fjalënderoi Reis'ul-Ulemaja i mëparshëm, h. hfz. Arif ef. Emini.

Prezencë masive nga të gjitha shtresat dhe profesionet. Një ambient madhështor. Edhe kësaj radhe u dëshmuara puna shkencore e FSHI në Shkup, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (23.12.2022)



# DEKOROHET PROF. DR. HASAN XHILLO



Më 21 dhjetor, 2022, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu mori pjesë në manifestimin e dekorimit të personaliteteve të vitit nga Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare i RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Nga Bashkësia Fetare Islame u dekorua prof. dr. Hasan Xhillo, mësimit në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup.

Hasan Xhillo tërë jetë ia ka kushtuar studimeve, hulumtimeve shkencore islame në sferën e filozofisë islame e më gjerë. Kontributi i tij ka lënë gjurmë të pashlyshme në njohjen e mendimit filozofik islam në vend dhe jashtë ven-

dit, me çka radhitet ndër figurat më eminente të kësaj sfere. Është përkthyesi i parë i Kuranit famëlartë në gjuhën maqedonase dhe autor i shumë veprave.

Në këtë akt solem morën pjesë Kryetari shtetit, z. Stevo Pendarovski, Kryetarët e Bashkësive Fetare, myftinjët e Myftinive të BFI të RMV, përfaqësues të jetës politike e shkencore dhe shumë figura eminente të nivelit republikan dhe lokal.

Prof. dr. Hasan Xhillos i urojmë këtë sukses të madh dhe i dëshirojmë jetë të gjatë dhe suksese të reja. Zoti e bekoftë – thuhet në njoftimin e BFI.



Satellite Imaging Technology Proves Hazrat Muhammad SAW's 1400 Year Old Information Right

## SATELITI VËRTETON THËNIEN E MUHAMEDIT (A. S.)

I dërguari i Zotit, Muhamedi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), para 1400 vitesh ka thënë: "Distanca mes dy portave të Xhenetit është sa distanca mes Mekës dhe El-Haxharit (Katar), ose mes Mekës dhe Busrës (Siri)."

Sot teknologjia e fotografimit satelitor e konfirmon se distanca midis këtyre dy vendndodhjeve është e njëjtë: 1.200 km.

"Allahumme Sali ala Muhammed..."

(E huazuar; nga Q.O. 27.12.2022)



Më 29 dhjetor, 2022, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti në Rijaset prof. dr. Hasan Xhillon, mësimit në FSHI, për t'i uruar dekorimin nga Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare të RMV. Për punën e tij të palodhshme, në shenjë respekti dhe urimi Kryetari i BFI të RMV i ndau mirënjohje prof. dr. Hasan Xhillos, thuhet në njoftimin e BFI.

# KRYETARI I LIKOVËS VIZITOI BFI-në



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti në Kabinetin e tij, në Rijaset, Kryetarin e Komunës së Likovës z. Erkan Arifi, i shoqëruar nga h. Enver efendiu, Imam i fshatit Mateç, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i BFI të RMV u falënderua për vizitën dhe e njoftoi mysafirin me rrjedhat fetare islame në BFI të RMV. Njëherësh, i shprehu mirënjohje për kontributin e dhënë në ndërtimin e xha-

mive dhe bashkëpunimin me Myftininë e Kumanovës.

Po ashtu, z. Erkan Arifi e njoftoi Reis'ul-Ulemanë me mirëvajtjen e punëve në Komunën e Likovës, si dhe me projektet e realizuara dhe sfidat me të cilat ballafaqohet.

Ata biseduan edhe për ndonjë bashkëpunim në sfera të ndryshme për të mirën e qytetarëve në këtë komunë.

Kryetari Arifi njihet si një udhëheqës

i aftë, i cili është dëshmuar në realizimin e shumë projekteve, si dhe në solidarizimin e tij me qytetarët e komunës që udhëheq.

Reis'ul-Ulemaja, i shoqëruar nga Myftiu i Kumanovës h. Abedin ef. Imeri, h. Ismet ef. Ademi dhe Xhelal Mehmeti, i uruan punë të mbarë, duke i premtuar bashkëpunim në sfera të ndryshme, thuhet në njoftimin e BFI. (26.12.2022)

# TAKIM ME KRYETARIN MENSUR EF. HALILI



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Drejtori i Sektorit të Mërgatës dr. Selver ef. Xhemaili, Drejtori i Sektorit Fetar-Arsimor prof. Jusuf ef. Zimeri dhe Drejtori për Shkencë dhe Kulturë Islame z. Musanif ef. Rufati, priti në një takim h. Mensur ef. Halilin, Kryetar i Unionit të Qendrave Islame Shqiptare të Gjermanisë (UQISH), i cili shoqërohej nga z. Kamber Ajruli, përgjegjës i Sektorit të Financave, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulemaja fillimisht u dëshiroi mirëseardhje mysafirëve dhe falënderoi për kontributin e madh që jep në udhëheqjen UQISH në Gjermani, në ngritjen e nivelit organizativ të jetës fetare dhe kombëtare të besimtarëve tanë me punë në Gjermani dhe shprehu gatishmërinë e tij për bashkëpunim të ngushtë dhe të përbashkët në zhvillimet e jetës fetare në Gjermani e më gjerë.

Z. Mensur ef. Halili u shpreh tejet falënderues për mikpritjen dhe për kontributin e BFI të RMV në organizimin e

jetës fetare dhe për përkrahjen që u jep bashkatdhetarëve tanë në Evropë, në veçanti në Gjermani.

Në fund, Reis'ul-Ulemaja i ndau mirënjohje për kontributin e tij të pasqor dhe për punën e madhe që bën në menaxhimin e jetës fetare në nivele të ndryshme.

Ata po ashtu biseduan për shumë çështje që kanë të bëjnë me prezantimin e Islamit në kohën moderne, si dhe për bashkëpunimin e ngushtë të të dyja palëve, si një kërkesë e domosdoshme, thuhet në njoftimin e BFI.

# VIZITË NGA KRYESIA E XHAMISË SË GRENHENIT

Më 4 janar, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Shefi i Kabinetit dr. Abdulkerim Iseni, priti Nënkryetarin e Xhamisë Ebu Hanife në Grenhen (Grenchen), Zvicër, z. Regaib Emmini, i shoqëruar nga z. Emin Emmini, që të dy nga Lugina e Preshevës, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulemaja u falënderua për këtë vizitë, si dhe për pritjen vëllazërore me rastin e vizitës së tij në Xhaminë e bukur të Grenhenit në krye me ish-nxënësin e tij, z. Synaj Osmani nga Manastiri. Njëherësh, ai shprehu përshtypjet e tij mahnitëse rreth Xhamisë në Grenchen.

Kryetari i BFI të RMV shprehu falënderimet dhe mirënjohjet e tij për kon-



tributin e dhënë në sfera të organizimit të jetës fetare dhe kombëtare në Zvicër dhe në vendlindje.

Ai premtoi se BFI e RMV do të jetë

prezente në çdo kohë dhe në çdo vend nëse e do nevoja.

Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e

BFI.

# BISEDË NDËRFETARE NË ZVICËR



Sonte në qytezën Weinfelden mora pjesë në serinë e bisedave ndërfaqetare që organizohen në nivel kantonial nga organizata Interreligiöser Arbeitskreis im Kanton Thurgau ([www.thurgau-interreligioes.ch](http://www.thurgau-interreligioes.ch)). Tema që u trajtua në këtë takim ishte: „Ademi dhe Hava në tekstet fetare hebraike, krishtere dhe islame“. Biseda e radhës do të jetë me 28 qershor 2023, në xhaminë tonë, ka shkruar në faqen e vet në Facebook Imami i Xhamisë Hëna e Re, Kreuzlingen, Zvicër, Rejhan ef. Neziri. (18.01.2023)



Më 14 janar, 2023, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në Rijaset anëtarin e Gjykatës Supreme të RMV, z. Faik Arslani (djathtas), thuhet në njoftimin e BFI.

# TAKOHEN BIZNESMENËT SHABANI

Më 4 janar, 2023, Reis'ul-Ulema i BFI të RMV h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Shefi i Kabinetit dr. Abdulkerim Iseni dhe Kryetari i OH "Hilal", z. Fadil Ramadani, priti në Kabinetin e tij vëllezërit Bekim dhe Bashkim Shabanin nga Straçinca e Shkupit, thuhet në njoftimin e BFI.

Ata uruan Reis'ul-Ulemanë dhe bashkëpunorët e tij për organizimin e jetës fetare islame në RMV e më gjerë.

Dy vëllezërit janë afaristë të mirënjohur në Zvicër, por edhe kontribues të mëdhenj në sferën kombëtare dhe fetare. Bekim dhe Bashkim Shabani janë xhamatë i Xhamisë së Bardhë në Aarburg të Zvicrës.

Reis'ul-Ulema i falënderoi për kon-



tributin e tyre dhe u shpjegoi për aktivitetet e realizuara dhe synimet e BFI-së në të ardhmen.

Bashkim Shabani shprehu kënaqësinë që në SHMI "Medreseja Isa Beu" Reis'ul-Ulemaja ka qenë profesor i tij.

Organizatës humanitare "Hilal", që vepron në kuadër të BFI-së, z. Bekim Shabani i dhuroi mjete ndihmëse (mbështetëse) për personat me nevoja të veçanta. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

# NË HAPJEN E KOMPANISË "EKO-TERM"



Më 29 dhjetor, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me ftesë të afaristit të mirënjohur

Abas Avziu me punë në Zvicër, mori pjesë në hapjen solemne të kompanisë "Eko-Term" në Çegran të Gostivarit, thu-

het në njoftimin e BFI.

Z. Abas Avziu tashmë është një afarist i mirënjohur në këtë sferë dhe, në të njëjtën kohë, është një personalitet kontribues në shërbim të fesë dhe të kombit në vend dhe tek mërgata.

Andaj, Reis'ul-Ulemaja, së bashku me Reisin paraprak h. hfz. Arif ef. Eminin, të prirë nga Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli me bashkëpunëtorë, me imamët e fshatit, uruan hapjen e kompanisë, duke i dëshiruar drejtuesit të saj shëndet dhe suksese në jetë në këtë nismë të re, thuhet në njoftimin e BFI.



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në manifestimin fetar: gëzim familjar i familjes Zendeli nga Gostivari - h. Zufer dhe Nexhbi Zendeli, thuhet në njoftimin e BFI. (1.01.2023)

# SEMINAR PËR IDENTITETIN BOSHNIJAK NË SHKUP



Më 25 dhjetor, 2022, në hotel "Bushi" në Shkup u mbajt seminari "Promovimi i identitetit dhe i gjuhës" për imamët dhe mësime boshnjakë, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, nga Shefi i Kabinetit dr. Abdulkerim Iseni dhe ish-profesori i Medresës Isa Beu Jusuf Çoloviç, krahas shumë të tjerëve, morën pjesë në të.

Seminari u organizua nga Rijaseti i Bosnjës dhe Hercegovinës, në kuadër të projektit Për personalitete fetare dhe arsimore boshnjake nga të gjitha vendet, duke filluar nga Bosnja dhe Hercegovina,

Kosova, Shqipëria, Mali i Zi etj.

Seminarin e shpalli të hapur Drejtori i Sektorit për Diasporë, z. Rasim ef. Çoliç, i cili falënderoi Kryetarin e BFI të RMV për mikpritjen dhe për pjesëmarrjen në këtë ngjarje.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në fjalën e tij të rastit foli mbi rëndësinë e bashkëpunimit të Bashkësive Islame në Ballkan, si dhe për rolin e madh që mund të kryejnë ato në zhvillimin e Islamit dhe të myslimanëve në përgjithësi. Ai po ashtu konstatoi se myslimanët boshnjakë janë element konstituiv dhe konstruktiv i BFI të RMV, ku janë të barabartë me të gjitha komunitetet

tjera.

Reisi i Bashkësisë Islame të Malit të Zi, dr. Rifat Fejzić, e përshëndeti tubimin dhe foli për rëndësinë e tij në afrimin dhe afirmimin e myslimanëve. Ai në veçanti foli për unitetin e myslimanëve në RMV, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre kombëtare.

Në seminar u trajtuan disa tema mbi identitetin kombëtar dhe gjuhësor, edhe atë nga personalitetet eminente nga Bosnja si: akademik Enes Kariç dhe Hadzhem Hajdareviç e të tjerë.

Ky takim hapi rrugë edhe për takime të tjera të Bashkësive Islame e të tjera në Ballkan, thuhet në njoftimin e BFI.

# MBAHET MANIFESTIMI "SOFRA E KURANIT"

Më 30 dhjetor, 2022, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga mr. Salim ef. Sulejmani, h. Irsal ef. Jakupi dhe dr. Abdulkerim ef. Iseni, mori pjesë në manifestimin "Sofra e Kuranit" në fshatin Labunisht të Strugës, thuhet në njoftimin e BFI.

"Sofra e Kuranit" u organizua nga OH "Diaspora", në koordinim me Myftininë e Strugës, me protagonistë të mirënjohur të leximit të bukur të Kuranit famëlartë: h. hfz. Aziz ef. Halili, z. Egzon ef. Ibrahim nga Kosova dhe hafëz Fatih efendiu nga Turqia.

Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori



pjesë në këtë manifestim të jashtëzakonshëm në shenjë respekti ndaj mërgimtarëve labunishtas, organizuar nga OH

"Diaspora" nga Zvicra, në koordinim me Myftininë e Strugës, thuhet në njoftimin e BFI.

# LIGJËRATA NË XHAMINË QENDRORE TË KËRÇOVËS



Më 29 dhjetor, 2022, në organizim të Myftinisë së Kërçovës, me ciklin e ligjëratave kishim nderin të mirëpresim kreun më të lartë të jetës fetare në vendin tonë, Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h.fz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulemaja shoqërohej nga Drejtori i Çështjeve të Mërgatës, dr. Selver ef. Xhemali, Myftiu i Manastirit Amit ef. Rasimi, prof. Sherif ef. Dehari dhe Nënkyetari i Kuvendit të BFI-së, Nurten ef. Zekiroski.

Delegacioni u mirëprit nga nikoqiri, Myftiu i Kërçovës Qamil ef. Rushiti, tok

me bashkëpunëtorët dhe imamët.

Në namazin e jacisë, në xhaminë qendrore "Sultan Pajazit", namazit i priu vetë Reis'ul-Ulemaja, ndërsa pas përfundimit u lexua pjesë nga Kurani famëlartë dhe ilahi nga Kori i Myftinisë.

Myftiu Qamil ef. Rushiti përshëndeti të pranishmit, duke falënderuar Reis'ul-Ulemanë me bashkëpunëtorët për prezencën, imamët e Xhamisë, Këshillin dhe xhematin në përgjithësi.

Fjalën kryesore e kishte vetë Kryetari i BFI-së, i cili foli rreth rëndësisë së këtyre takimeve, duke dhënë edhe këshilla rreth të qenit optimist dhe mendimit të

mirë për jetën në përgjithësi dhe për jetën fetare islame në veçanti.

Allahu i shpërbleftë për mundin, sakrificën dhe respektin ndaj xhematit kërçovar në përgjithësi dhe mërgatës kërçovare në veçanti, thuhet në njoftimin e BFI (përkatësisht, të Myftinisë së BFI-Kërçovë).

Reis'ul-Ulemaja përcolli punët e renoimit dhe të ndërtimit të selisë së Myftinisë së Kërçovës. Një punë e madhe afër përfundimit – thuhet në një njoftim tjetër të BFI nga qëndrimi i Kryetarit të BFI të RMV në Kërçovë më 29 dhjetor.

# AKTIVITETE NË SETA PETKË DHE PAGARUSHË

Më 30 dhjetor, 2022, Myftiu i Myftinisë së BFI-Shkup, dr. Qenan ef. Ismaili, i shoqëruar nga referentët Fejsal ef. Kadriu, h.fz. Irfan ef. Sulejmani dhe Armend Halimi, ndanë së bashku gëzimin e nxënësve të mejtepit të xhamisë "Reshadije" në fshatin Seta Petkë, me rastin e mbarimit të kursit të mësimbesimit të ndjekur te mualimi h.fz. Shaip ef. Jusufi, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Ky solemnitet u hap me një ashere të kënduar nga h.fz. Irfan ef. Sulejmani.

Në fjalën e tij mirëseardhëse, mualimi h.fz. Shaip ef. Jusufi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë solemnitet, falënderoi prezencën e Myftiut dhe të stafit të Myftinisë. Ai shprehu kënaqësinë e tij që sot, para xhematlinjve, prezanton nxënësit që me sukses mbaruan kursin e mësimbesimit.

Nxënësit shpallorën njohuritë e tyre të mësimbesimit, ndërsa më pas u bë dorëzimi i certifikatave të hatmes së mbaruar.

Duanë e rastit e bëri Fejsal ef. Kadriu.

Mesazhin e xhumasë nga minberi e përcolli Myftiu dr. Qenan ef. Ismaili. Ai përkujtoi vlerën e përcjelles së fjalës së Allahut dhe foli mbi përkushtimin e besimtarëve në ndjekjen e Sunnetit të Muhamedit (a. s.), thuhet në njoftimin e



Myftinisë së Shkupit.

Vizitë xhamisë së fshatit Pagarushë: Më 30 dhjetor, 2022, Sekretari i Myftinisë së BFI-Shkup, mr. Nexhmi ef. Ferati, i shoqëruar nga Referenti Fati Azizi, vizitoi xhematin e fshatit Pagarushë me rastin e dorëzimit të autorizimit për emërimin e Osman ef. Murtezanit në detyrën imam, hatib dhe mualim në këtë xhami, thuhet në një njoftim tjetër të Myftinisë së Shkupit.

Sekretari mr. Nexhmi Ferati në fjalën

e tij i bëri një prezantim Osman ef. Murtezanit para xhematit dhe në emër të Myftiut uroi Imamin e ri, duke i dëshiruar suksese e mbarësi në detyrën e tij dhe përmendi obligimet dhe të drejtat e nëpunësit fetar të autorizuar, bazuar në Rregulloren e Punës së Myftinisë së BFI-Shkup.

Me këtë rast, Nexhmi efendi realizoi hytben e xhumasë dhe udhëhoqi xhematin në faljen e namazit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

# HOXHË AHMED KALAJA NË KËRÇOVË

Më 13 janar, 2023, ishim të nderuar me ardhjen e imanit të mirënjohur nga Shqipëria, dr. Ahmed Kalaja, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kërçovës.

Imami u mirëprit nga nikoqiri, Myftiu i BFI-Kërçovë Qamil ef. Rushiti, bashkë me administratën e Myftinisë dhe një grup të rinjsh - aktivistë dhe dashamirë të fesë.

Në xhaminë qendrore të qytetit "Sultan Pajazit" hoxhë Ahmed Kalaja përcolli mesazhe rreth meditimeve kuranore, sjelljen e mirë që urdhëron Islami, edukatën që nxit dhe motivon, respektimin e ndër-sjellë - duke filluar nga ai familjar, farefisnor dhe në përgjithësi. U dëgjuan, po ashtu, meditime dhe porosi të pejgamberrit tonë të dashur, Muhamedit (a. s.).

Allahu fuqiplotë e shpërbleftë për pjesëmarrjen dhe ia shtoftë diturinë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kërçovës,



Zyra për Informim.

Në profilin e tij në Facebook, Myftiu i Kërçovës Qamil ef. Rushiti ka shkruar: "Takimet që realizohen në emër të Allahut, me qëllim që të arrijmë kënaqësinë e Tij, nuk kanë se si të jenë ndryshe, për-

veçse të mbushura plot respekt, dashuri, afërsi, mëshirë, vëllazërim, emocion, të cilat i solli për ne imami i njohur Ahmed Kalaja nga Tirana. Allahu e shpërbleftë dhe ia kompensoftë ashtu siç di dhe siç mundet."



Më 29 dhjetor, 2022, realizuam mbledhjen e rregullt me anëtarët e Myftinisë së Shkupit, ku raportuam për të gjitha aktivitetet e vitit 2022 dhe paraqitëm Planin e aktiviteteve për vitin 2023. Raporti dhe Plani njëzërit u miratuan. Allahu na i pranoftë veprat tona të bëra dhe na i lehtësoftë ato që duhet t'i bëjmë në të ardhmen, ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, në faqen e vet në Facebook.

# NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Më 20 dhjetor, 2022, Myftiu i Myftinisë së Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, i shoqëruar nga Referenti për kulturë pranë Myftinisë, dr. Husein ef. Rizai, qëndroi në vizitë në Universitetin e Tetovës, te Rektori i ri prof. dr. Kushtrim Ahmeti, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

Myftiu i Tetovës, në emër të Myftinisë së BFI-Tetovë, pas zgjedhjes së prof. dr. Kushtrim Ahmetit ushtrues detyre Rektor i Universitetit të Tetovës, i uroi detyrën dhe, duke e lutur Allahun fuqplotë, i dëshiroi shëndet, fuqi, energji dhe suksese në punët që e presin, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.



# PRITJE PËR KORIN E MYFTINISË

Më 10 janar, 2023, në hapësirat e Myftinisë, Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi priti Korin e Myftinisë, thuhet në njoftimin e MT.

Kori përbëhet nga disa nxënës të Mëdresës Isa Beu dhe nga disa studentë të Fakultetit të Shkencave Islame.

Në takim Myftiu falënderoi Korin për realizimin e gjertanishëm të programeve fetare-kulturore të kësaj myftinie, ndërkohë foli edhe për seriozitetin dhe rëndësinë e mësimin, të punës dhe të përfaqësimit të tyre në xhamatë dhe në xhami.

Ai potencoi se terbija, ruajtja, afirmimi dhe kultivimi i vlerave fetare janë shumë të rëndësishme dhe pasqyrë e ardhmërisë së një shërbestari të fesë.

Gjithashtu, Myftiu falënderoi Korin



për angazhimin e tij, duke e lutur Allahun fuqplotë që anëtarëve të tij t'u japë fuqinë, energjinë, vizionin dhe shëndetin për va-

zhdimin e këtij udhëtimi shumë të rëndësishëm për ta dhe për Institucionin, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.



*Një delegacion nga Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik (International Balkan University, IBU), Shkup, i kryesuar nga Prorektori prof. dr. Serdar Serdaroğlu qëndroi më 14 janar, 2023, në selinë e Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe u prit nga Kryetari i saj, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.*

# MANIFESTIM NË KAMJAN

Manifestim me rastin e pensionimit të h. Hamdi ef. Izairi dhe inaugurimit të h. Xhemil ef. Shabani në detyrën e imamit, të mualimit dhe të ligjëruesit në xhaminë e fshatit Kamjan të Tetovës, thuhet në njoftimin e BFI.

Manifestimi u organizua më 6 janar, 2023, dhe në të, me ftesë të Myftinisë së Tetovës, mori pjesë dhe Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Kryetari i BFI u shoqërua nga h. Idriz ef. Idrizi, Referent dhe h. Namik ef. Xhaferi, Sekretar i Myftinisë së Tetovës.

Në manifestim ishte i pranishëm h. Reshat ef. Mexhiti në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të Kryetarit të saj, Myftiut Naim Tërnavë.

Në emër të Myftiut të Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, fjalë përshëndetëse në manifestim paraqiti Referenti h. Idriz ef. Idrizi, i cili para të pranishmëve foli për h. Hamdi ef. Izairin dhe biografinë e tij. Ai e vlerësoi lart personalitetin e tij si imam në këtë xhami.

Imami i pensionuar shprehu falënde-



rimet ndaj besimtarëve për përkrahjen e madhe që ia kanë dhënë plot katër dekada, që me sukses ta kryejë detyrën e dhënë.

Reis'ul-Ulemaja në fjalën e tij shprehu falënderimin e sinqertë për punën e madhe të h. Hamdi Izairit si imam, mualim, vaiz etj., ndërsa imamit të ri, h. Xhemil ef. Shabanit, i uroi suk-

ses në punën e tij në Xhaminë e Kamjanit.

Në këtë manifestim morën pjesë prof. Rushdi ef. Shabani, Shefi i Kabinetit të Reis'ul-Ulemasë dr. Abdulkerim Iseni, Drejtori i Sektorit për Shkencë dhe Kulturë z. Musanif Rufati, h. Arif Nesimi dhe një numër i madh besimtarësh, thuhet në njoftimin e BFI.

# CEREMONI PËRCJELLËSE NË ÇELLOPEK

Më 30 dhjetor, 2022, para namazit të xhumasë, në xhaminë e fshatit Çellopek i Ri, me rastin e aktit solemn të pensionimit të Myftiut të mëparshëm të Tetovës dhe të imamit të fshatit Çellopek, mr. hfz. Nexhadi ef. Limani, u mbajt ceremonia falënderuese dhe përcjellëse, e organizuar nga Këshilli i kësaj xhamie në koordinim me Myftininë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë ceremoni morën pjesë: Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu me shoqëruesit e tij Myftiun e Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi me kolegët e tij, hoxhallarë dhe një numër shumë i madh i xhamatit.

Këtë ceremoni e moderoi Jonuz ef. Huseini, ku edhe mbajti fjalë përshëndetëse në emër të Këshillit të xhamisë, ndërsa leximin e biografisë e bëri mr. Xhemil ef. Sadiki.

Pas leximit të biografisë, fjalë përshëndetëse mbajti Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, ndërsa fjalë rasti mbajti Reisi.

Myftiu mes tjerash përkujtoi rolin dhe punën e Myftiut të mëparshëm, sakrificën, përkushtimin dhe kontributin e tij dhënë në ngritjen e vetëdijes fetare dhe



punën e palodhshme gjatë shërbimit në rrugë të fesë Islame, duke lutur Allahun fuqplotë që ta shpërblejë me shpërblimet e Tij të panumërta.

Ndërkaq, Reisi duke përmendur fazat e jetës së Myftiut të mëparshëm, iu lut Allahut (xh. sh.) që t'i japë shëndet dhe jetë të gjatë. Në shenjë falënderimi, Reisi, në emër të BFI-së, Nexhadi efendiut i ndau mirënjohje me logon e BFI-së, ndërsa Myftiu në emër të Myftinisë së Tetovës i dhuroi një pikturë, ndërsa Këshilli i xhamisë i ndau mirënjohje.

Pas ndarjes së mirënjohjeve dhe dhu-

ratave, u bë dorëzim-pranimi i detyrës, kështu që imam i ri i kësaj xhamie do të jetë hfz. Besir ef. Limani.

Hytben e xhumasë e mbajti Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili i priu edhe xhamatit në namazin e xhumasë.

Allahu i plotfuqishëm e bekoftë mr. Nexhati Limanin, duke i dhënë shëndet dhe jetë të gjatë në shpjegimin e Islamit në sfera të ndryshme.

Në fund, familja kishte përgatitur një drekë për mysafirët, thuhet në njoftimin e BFI.

# ECIN PUNËT NË XHAMINË E ZLLAKUQANIT

Është hedhur soleta e parë në xhaminë e Zllakuqanit (Kumanovë) – besimtarët ndihmojnë, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 27 dhjetor, 2022, priti në Rijaset Këshillin iniciativ për ndërtimin e xhamisë së re në fshatin Zllakuqan - Myftinia e Kumanovës, në përbërje: z. Adem Limani, z. Ismail Xheladini, z. Shaban Imeri dhe z. Sefedin Murseli. Ky fshat e lidh Maqedoninë e Veriut me Kosovën.

Vizitës i priu Myftiu i Kumanovës, h. Abedin ef. Imeri. Në takim u bisedua rreth ndërtimit të Xhamisë, pas së cilës të gjithë mbetën të kënaqur me strategjinë e punëve dhe u tha se, tashmë, niveli i parë prej betoni (soleta) ka përfunduar dhe punët ecin mirë. Vendi



ku ndërtohet është shumë i bukur dhe aty paramendohet të ngrihet një bukuroshe e rrallë - një xhami, me pjesën tjetër, që do të jetë një qendër fetare, kombëtare dhe turistike.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja u shprehu përkrahjen institucionale të

BFI-së dhe tha se Bashkësia Fetare Islame në çdo moment do të jetë në ndihmë të tyre, bashkë me Myftininë.

Po ashtu, u shprehën mirënjohje për mysafirët, për punën e deritanishme dhe u uruan për sukseset e shënuara. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

# VLERËSOHET MËSIMI NË XHAMINË E LUBOTENIT

Komisioni për Vlerësim të nxënësve të mejtepeve në përbërje: hfz. Irfan ef. Sulejmani, kryetar dhe Shefket ef. Baftjari, anëtar, vizitoi nxënësit e mejtepit të xhamisë "Haxhi Imer" në Luboten, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Gjatë kësaj vizite, Komisioni bëri kontrollimin dhe vlerë-

simin e njohurive të nxënësve në bazë të planprogramit mësimor të Myftinisë së Shkupit.

Bazat e mësimbesimit nxënësit i mësojnë nga mualimi Nimet ef. Aliu, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit. (16.01.2023)



**Më 18 janar, 2023, në Banjicë, komuna e Çashkës, filluan punimet për ndërtimin e xhamisë së re në këtë fshat. Na qoftë për hair dhe ishallah përfundon sa më shpejt ndërtimi i saj, ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Velesit, Nejaz ef. Murati, në faqen e vet në Facebook.**

# GOSTIVARIT I SHTOHET NJË HAFËZ



Më 20 janar, 2023, besimtarët e Xhamisë Qendrore të Sahatit në Gostivar patën fatin që të përjetojnë gëzimin e manifestimit të duasë së hifzit të hafëzit të ri Ammar Rahim Purde, të kryer pranë mualimit të Xhamisë së Sahatit dhe muhafidh hfz. Jakup ef. Jakupi, thuhet në njoftimin e BFI.

Hafëzi është i lindur më 5.04.2008 në Gostivar, hifzin e ka filluar më 1.06.2017 te Nurullah ef. Baki, më pas te merhum hfz. Galip ef. Sulejmani dhe më pas te hfz. Jakup ef. Jakupi, ku e përfundoi më 15.12.2022.

Ndërkaq, provimin e hifzit e ka mbrojtur më 9.01.2023 para Komisionit profesional të Myftinisë së Gostivarit, në përbërje: hfz. Jusuf ef. Xheladini, kryetar; hfz. Tahir ef. Halimi, anëtar; hfz. Mahmut ef. Boleci, anëtar dhe mr. Elyesa ef. Asani - mbikëqyrës profesional dhe drejtor i Institutit të Hifzit dhe të Bukurleximit të Kuranit Famëllartë "Hfz. Hasan ef. Zendeli" në Gostivar.

Në këtë manifestim, të cilin e moderoi mr. Elyesa ef. Asani, morën pjesë: Reis'ul-Ulema i BFI të RMV h. hfz. Shaqir ef. Fetahu me bashkëpunëtorët e tij, Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli me referentët e tij, Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myftiu i Kërçovës mr. Qamil ef. Rushiti, Myftiu i Ohrit h. Samet ef. Ajdari, Myftiu i Manastirit h. Amit ef. Rasimi, Sekretari i Përgjithshëm

i BFI-së h. Irsal ef. Jakupi, drejtorët e Rijasetit të BFI të udhëhequr nga prof. Jusuf ef. Zimeri, Dekani i FSHI prof. dr. Shaban ef. Sulejmani, bashkë me Prodekanin dr. Muaz ef. Agushi dhe Drejtorin e Financave prof. Sulejman ef. Idrizi, përfaqësues të Myftinive, myderrizi i Xhamisë dr. Musa Musai, imamët hfz. Jakup ef. Jakupi-muhafidh i hafëzit, hfz. Mahmut ef. Boleci, h. Eran ef. Selimi-myezini, hafëzi i ri Ammar Rahim Purde, hoxhallarë të Gostivarit me rrethinë, si dhe një numër shumë i madh i xhematit.

Programi u hap me ashere nga Kurani famëllartë nga hfz. Irfan ef. Sulejmani, Referent fetar-arsimor pranë Myftinisë së Shkupit.

Të dhënat për hafëzin e ri i prezantoi Kryetari i Komisionit të Hifzit, Referenti për arsim fetar pranë Myftinisë së Gostivarit, hfz. Jusuf ef. Xheladini.

Myftiu i Gostivarit në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë manifestim, duke e lutur Allahun (xh. sh.) që t'i shpërblejë me të mirat e Tij, si dhe falënderoi hafëzin dhe muhafizin që u bënë sebeb për këtë tubim madhor.

Fjalën e rastit e mbajti Kryetari i BFI-së, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Ai hafëzit të ri, muhafidhit, si dhe familjes së tij u shprehu urime për hifzin e bërë, duke iu dëshiruar shëndet, lumturi dhe suksese në jetë. Reisi potencoi se familja e mirënjohur Purde nga Gostivari

sot na bën krenarë të gjithëve se fëmijën e vet e ka bërë mbrojtës të Fjalës së Përherëshme të të Madhit Zot, duke u bërë shembull për të gjithë. Sot Gostivari po rikthehet pas një "heshtjeje" disavjeçare me hafëz të ri, dhe për një periudhë të shkurtër edhe me një tjetër, nga muhafizi i kohërave të ndryshme, hfz. Jakup ef. Jakupi - potencoi Reis'ul-Ulemaja.

Ky manifestim përfundoi me duanë e bërë nga Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili dhe dhënien e Certifikatës së Hifzit dhe të dhuratave nga ana e Kryetarit të BFI dhe Myftiu i Gostivarit.

Në hytben e xhumasë priu Myftiu i Kërçovës mr. Qamil ef. Rushiti, kurse në namazin e xhumasë priu Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi.

Në të njëjtën kohë, u bë edhe përrurimi i hapësirës për gjininë femërore në Xhaminë e Sahatit, me ç'rast nga ana e Bashkësisë Fetare Islame dhe Myftinia e Gostivarit u dekorua Këshilli i Xhamisë së Sahatit me mirënjohje, të cilën e pranoi h. Ebib Shabani-arkëtar i kësaj xhamie.

Këndim Kurani pati mr. Xhemil ef. Sadiku, Shef Kabineti i Myftiut të Tetovës, kurse duanë e bëri prof. Jusuf ef. Zimeri, Drejtor i Sektorit fetar-arsimor pranë Rijasetit të BFI.

Familjarët me rastin e këtij manifestimi kishin përgatitur edhe drekë enkas për mysafirët, thuhet në njoftimin e BFI.

# VICA ME HAFËZE: AZRA SALIHU



Më 14 janar, 2023, në fshatin Vicë të Tetovës u mbajt solemniteti i promovimit të hafëzes së re Azra Salihu, e cila me sukses përfundoi hifzin e Kuranit famëlartë, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në fjalën e rastit uroi për zëmbërsisht hafëzen e re, familjen e saj dhe Myftininë e Tetovës.

Pasi i përshëndeti të pranishmit, Myftiu i Myftinisë së Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, e vlerësoi lart punën e hafëzes së re, duke i dëshiruar suksese në jetë.

Më pas u bë dorëzimi i Certifikatës së Hifzit.

Në këtë ceremoni morën pjesë Myftiu i Strugës h. Salim ef. Sulejmani, Dekani FSHI prof. dr. Shaban Sulejmani, myftilerë të mëparshëm, drejtorë të sek-

torëve të BFI të RMV, imamë dhe shumë besimtarë. Hfz. Azra Salihu hifzin e kreu te hafëz Zylqyfli Asllani, muhafiz dhe mualim i mirënjohur, thuhet në njoftimin e BFI.

Jemi krenarë me arritjen e hafëzes Azra Salihu nga fshati malor Vicë, mbi Tetovë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

# KMSH SIVJET SHËNON 100-VJETORIN

Më 24 shkurt - 12 mars 1923 i zhvilloi punimet Kongresi i parë Mysliman Shqiptar. Ky kongres përfaqëson një ngjarje të rëndësishme për jetën fetare e shoqërore të vendit tonë, thuhet në njoftimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH).

Në Kongres morën pjesë 36 delegatë nga i gjithë vendi. Ky kongres hyri në histori për vendimet e rëndësishme teologjike me kahe kombëtare. Ndër to mund të përmendim edhe themelimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, i cili do të interpretonte dhe menaxhonte në të ardhmen gjithçka që kishte lidhje me fenë islame në vendin tonë.

Kanë kaluar plot 100 vjet nga ky kongres, 100 vjet në të cilat Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka realizuar interpretimin teologjik dhe realizimin praktik të parimeve të fesë islame në territorin e vendit tonë nëpërmjet myftinive dhe institucioneve të tjera në varësi.

Në kuadër të kremtimit të 100-vjetorit të pavarësisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, institucioni do të dalë me një logo zyrtare, e cila do të përdoret përgjatë gjithë vitit 2023 në të gjitha shkresat zyrtare dhe korrespondencat me institucione brenda dhe jashtë vendit, si dhe në aktivitetet fetare, sociale e kultu-



rore që do të organizohen përgjatë gjithë vitit.

Logoja është derivat i simboleve zyrtare të Komunitetit Mysliman, por që natyrisht përmban edhe simbolikën e këtij 100-vjetori, thuhet në njoftimin e KMSH. (1.01.2023)

# HATME NË XHAMINË E KADRIT

Më 1 janar, 2023, në Xhaminë e Kadrit në Gostivar u realizua solemniteti i përfundimit të hatmeve të Kuranit famëlartë nga nxënësit e mejtepit me mualim h. Daut ef. Alili, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

Në këtë manifestim, përpos xhematit, familjarëve dhe mysafirëve të shumtë, pjesëmarrës ishte një delegacion nga Myftinia e BFI-Gostivar, në krye me Myftiun h. Sabahudin ef. Zendeli, i shoqëruar nga Referentët e Myftinisë dhe nga hoxhallarë të rrethit të Gostivarit.

Këtë solemnitet me prezencën e tij e bëri më madhështor prezenca e Kryetarit të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu me bashkëpunëtorë, pastaj Reis'ul-Ulemaja i mëparshëm h. hfz. Arif ef. Emini, si dhe shumë hoxhallarë të tjerë.

Në fillim, për mirëseardhje fjalim paraqiti prof. dr. Abdulxhemil ef. Nesimi, ligjërues në Xhami dhe profesor në Fakultetin e Shkencave Islame.

Më tej, Myftiu h. Sabahudin ef. Zendeli, në fjalën e tij përshëndetëse, pas falënderimeve për mualimin, vaizin, Këshillin e Xhamisë, prindërit dhe nxënësit/et e mejtepit, theksoi rëndësinë e mësimbesimit islam nëpër mejtepe.

Më pas, fjalën e rastit e pati Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili potencoi peshën dhe vlerën që ka mësimbesimi islam, si bazë e fuqishme në edukimin e gjeneratave të reja. Njëherësh, shprehu urime të përzemërta për këtë program përmbajtësor.

Duke potencuar ecurinë e vet ndërtimit të kësaj xhamie, Reisi u shpreh se ka pasur vullnet nga ata burra që nuk janë më në jetë dhe nga ata që jetojnë dhe kontribuojnë në vazhdimësi për këtë xhami kaq të bukur, së cilës ia kanë lakminë të gjithë. Ai tha se ky xhemat ka ditur që në çdo periudhë ta zhvillojë realizimin e jetës fetare në qytet, me theks të veçantë në këtë lagje, me të gjitha Këshillat e xhamisë, edhe në të kaluarën, por edhe sot. E, për mualimin, tha ai, flet vetë xhemati: ai tregon se është shumë preciz në punë dhe aktiv me nxënësit, si dhe në shumë aktivitete të tjera.

Duanë e hatmeve e bëri hfz. Arif ef. Emini.

Në fund të programit, nën udhëheqjen e Referentit h. Mallzim ef. Zendeli, u bë edhe ndarja e diplomave dhe mirënjohjeve, me të cilat u dekoruan: nxënësit, myderrizi, mualimi/imami, zv.imami dhe



myezini i kësaj xhamie dhe Këshilli i Xhamisë. Numri i nxënësve/eve ishte 16.

Programi u ndoq nga një numër masiv besimtarësh dhe u përcoll nga mediat lokale në vend, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

Manifestimi përfundoi me hapjen e objekteve ndihmëse të Xhamisë së Kadrit, thuhet në njoftimin e BFI.

Një raport i veçantë në mbrëmje u dha nga TV Globi, Gostivar.

## DEBAT

Emisioni debativ "Politica", me kreun e Bashkësisë Fetare Islame të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI (26.12.2022). Në njoftim jepet dhe lidhja në vazhdim: <https://youtu.be/kmi5NUk3TFw>



*Kanë përfunduar punët e përgjithshme në Xhaminë Haxhi Mahmud Bej në Manastir. Ato janë zhvilluar gjatë tre viteve të fundit, nga muaji nëntor 2019 deri në muajin dhjetor 2022. "Pas përfundimit të punimeve, patëm një bisedë vëllazërore me pronarin e firmës 'Onur Atar' dhe me disa nga mjeshtërit, tok me bashkëpunëtorët, të cilët i falënderuam për punën e mrekullueshme që kanë bërë", ka shkruar Myftiu i Myftinisë së BFI-Manastir, Amit ef. Rasimi, në faqen e vet në Facebook. (28.12.2022)*

# HATME PËR 17 NXËNËS NË BANJICË



Më 8 janar, 2023, në xhaminë e fshatit Banjicë e Epërme u bë hatme pas përfundimit të Kuranit famëlartë nga nxënësit e mejtepit që kanë mësuar me mualimin Ali ef. Selimi, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

Në këtë manifestim, përpos xhematit, familjarëve dhe mysafirëve të shumtë, pjesëmarrës ishte një delegacion nga Bashkësia Fetare Islame e RMV në krye me Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Kryetari i BFI-së u shoqërua nga Referentët e Myftinisë së Gostivarit dhe hoqullarë të rrethinave të Gostivarit.

Reis'ul-Ulemaja në fjalën e tij të rastit, pas falënderimeve për mualimin, vazin, imamin tjetër, këshillin e xhamisë, prindërit dhe nxënësit/et e mejtepit, theksoi rëndësinë e mësimbesimit islam nëpër mejtepe. Ai i lidhi në gërshet tri shtyllat kyç të mësimbesimit: nxënës-mualim-prind dhe potencoi faktin se në këtë xhami gati se për çdo vit po përjetojmë dua-hatme të kryera nga mualimi dhe imami i nderuar Ali ef. Selimi.

Duke e vlerësuar punën e mualimit, Reis'ul-Ulemaja tha se ai i cili më së miri e ka lavdëruar dhe e ka ngritur peshën e

tij, është vetë Muhamedi (alejhis-selam), i cili ka thënë: "Më i miri prej jush është ai i cili e mëson Kuranin dhe ua mëson atë të tjerëve."

Duanë e hatmeve e bëri prof. Sherif ef. Dehari.

Në fund të programit, nën udhëheqjen e Referentit mr. Eljesa ef. Asani dhe referentëve të tjerë, u bë edhe ndarja e diplomave dhe e mirënjohjeve, me të cilat u dekoruan: nxënësit, mualimi/imamët, Këshilli i Xhamisë.

Numri i nxënësve/eve ishte 17, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

# XHAMI DHE SHTËPI TË REJA NË THUMANË



Kush ndërton një xhami, Zoti i ndërton një shtëpi në Xhenet, ka shkruar hoxhë Usam Alimi (ALKIG, Austri) në faqen e vet në Facebook.

Thumana, rrethina e Durrësit (Shqipëri), në vitin 2019 u dëmtua shumë nga tërmeti. Gjithashtu, edhe xhamia e këtij qyteti u prek tepër nga tërmeti.

E vizituam zonën në atë kohë, u takuam me vëllezërit tanë, ndërsa njëri prej banorëve na tha: 'Hoxhë, xhaminë dërtojeni! Shtëpinë time nuk duhet ta dërtoni; unë qëndroj edhe në tendë! Ju lutem, xhaminë ndërtojeni; aty është vendtakimi ynë!'

Sot u realizua premtimi: Xhamia u ndërtua! Me xhaminë u ndërtuan edhe 10 shtëpi nga themeli dhe 8 të tjera u meremetuan. Të gjitha këto, me mjetet e tubuara nga Austria, Zvicra dhe Italia.

Elhamdulillah, që me mirësitë e Tij përfundohen punët e mira! Zoti i shpërbleftë të gjithë donatorët! - ka shkruar hoxhë Usam Alimi më 15 janar, 2023.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (KMSH), ndërkaq, një ditë më vonë ka dalë me një njoftim, në të cilin thuhet:

"Pas inaugurimit të shtëpive të banimit, Krerët e Komuniteteve Shqiptare Islame të Diasporës, të shoqëruar nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar Spahiu, dhe përfaqësues të tjerë të lartë të institucionit, inauguruan gjithashtu edhe objektin e xhamisë së 'Thumanës'.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, përpos të lartëpërmendurve, ishin të pranishëm gjithashtu edhe dhjetëra banorë të zonës, Nënkrjetari i Bashkisë së Krujës z. Ilir Loci, Myftiu i Krujës z. Ermir Gjani, Myftiu i Durrësit z. Redin Quku etj.

Kjo ceremoni filloi me leximin e disa ajeteve kuranore nga imami i kësaj xhamie, Ermir Kurti, për të vazhduar më tej me një video të shkurtër të projektit të rindërtimit.

Më pas fjalën e mori Drejtori i Vakëf-Investimeve në KMSH, z. Edison Hoti, i cili u uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe bëri një prezantim të shkurtër të projektit 'Diaspora'.

Për të vijuar më tej me Kryetarin e KMSH-së, z. Spahiu, i cili falënderoi për bashkëpunimin e frytshëm në projektin e rindërtimit krerët dhe kontribuesit e komuniteteve shqiptare islame të diasporës.

'Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka dhënë më të mirën që çdo kontribut i juaj të shkojë atje për ku ishte njeri i atyre që e dhanë. Shpresoj t'ia kemi dalë në këtë drejtim dhe falënderojmë Allahun (xh. sh.) që nxori të gjithë së bashku faqebardhë' - tha ai.

Pas tij, fjalën e morën Krerët e Komuniteteve Shqiptare Islame të Diasporës, si: z. Mehas Alija, Kryetar i Bashkësisë Islame Shqiptare në Zvicër, z. Vahedin Beluli, Kryetar i Bashkësisë Islame Shqiptare në Austri; z. Reshat Ibi-

shi, Kryetar i Bashkësisë Islame Shqiptare në Itali; dhe z. Jasmin Demić, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Boshnjakëve në Zvicër.

Në fjalët e tyre, ata shprehën fillimisht mirënjohjen ndaj Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, i cili çoi në vend amanetin e të gjithë kontribuesve që jetojnë e punojnë në diasporë, e më pas u ndalën në frymën e bashkëpunimit mbarrëshqiptar që na karakterizoi në rastin e tërmetit 2019.

Këtë ceremoni e përshëndeti gjithashtu edhe Nënkrjetari i Bashkisë së Krujës, z. Ilir Loci, i cili shprehu mirënjohjen e institucionit që ai përfaqëson në kontributin e të gjitha palëve për të kapërcyer pasojat që shkaktoi tërmeti i nëntorit të 2019-tës.

Simbolikisht u shpërndanë edhe çelësat e shtëpive të rindërtuara, të cilët iu dorëzuan kryefamiljarëve të pranishëm nga të lartëpërmendurit.

Më tej, Krerët e Komuniteteve Shqiptare Islame të Diasporës, së bashku me Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, pre në shiritin e inaugurimit të Xhamisë së Thumanës, tashmë nën emrin 'Xhamia e Unitetit', për të simbolizuar frymën vëllazërore të shqiptarëve të kudondodhur që u bënë bashkë në kapërcimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019.

Allahu (xh. sh.) i shpërbleftë bamirësit!", përfundon njoftimi i KMSH.

# GJELBËROHET MEKA

Këto ditë, pas reshjeve të fundit të shiut, malet e Mekës së Bekuar janë mbuluar me gjelbërim, njoftojnë disa hoxhallarë nga Shkupi.

Përveç fotografive, një pjesë e tyre kanë shpërndarë edhe video-incizime, ku duket që natyra ka marrë pamje tjetër, e tëra e mbuluar me ngjyrë të gjelbër.

Pejgamberi Muhamed (a. s.) ka thënë: "Nuk do të ndodhë Kiameti (shkatërrimi i madh) derisa të kthehet toka arabe në livadhe të gjelbër dhe të rrjedhin lumenj në të."

Pamjet tregojnë gjelbërimin e rrethinave të Mekës nga shirat e vazhdueshëm që po bien kohëve të fundit. (8.01.2023)



# NIJETI, ÇËSHTJE E ZEMRËS

*Nijeti për hir të Allahut të lumturon dhe të begaton në të dy botët.*



**Shkruan: Aziz Memishi**

**M**e emrin e Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit të posaçëm: “Bëni veprat tuaja me sinqeritet, vetëm për Allah, pasi që Allahu i pranon vetëm veprat e sinqerta, që bëhen për hir të Tij.” (Muhamedi a. s.)

Për gjërat që Allahu ka kërkuar që t'i bëjmë (si veprime) dhe t'i zbatojmë, si kusht të kryerjes ka kërkuar prej nesh që të kemi **nijetin, qëllimin, vendosmërinë** dhe **synimin** për të zbatuar ato vepra, sidomos prej atyre që janë praktika fetare si: farze, vaxhibe, sunnete apo vepra të pëlqyeshme - vetëm e vetëm për ta përmbushur qëllimin e krijimit tonë, që është - adhurimi i Allahut (xh.sh.).

Në Kuranin famëlartë Allahu fuqplotë thotë:

**“Dhe, nuk kam krijuar xhindet dhe njerëzit, përveç se të më adhurojnë.”** (Edh-Dharijat: 56)

Ky do të duhej të ishte synimi, parulla dhe qëllimi ynë jetësor, që të adhurojmë Allahun, Zotin e botëve, pasi kjo është

detyra jonë ndaj Madhërisë së Tij, kështu që, krahas punëve dhe angazhimeve të kësaj bote, ne gjithmonë duhet të jemi të kujdesshëm ndaj kësaj detyre.

Synimi dhe vetëdija e këtyre pa dyshim do të ishin niveli i duhur i robërisë (nënshtrimit) ndaj Zotit tonë. Pasi që njerëzit mund të adhurojnë dhe të bëjnë ibadet për shumë arsye e qëllime.

Si më kryesoret janë:

1. Adhurimi i Allahut vetëm për shkak se Ai është i vetmi që meriton të adhurohet. Në të njëjtën kohë, kjo është ajka e besimit dhe niveli më i lartë i të qenit besimtar me plot kuptimin e fjalës.

2. Adhurimi nga frika e dënimit të Allahut.

3. Adhurimi për t'u dukur, pa ndonjërin nga dy qëllimet e mëparshme. Thënë më mirë, për interesa dhe favore të kësaj bote. Ndërkohë që ibadet, ky adhurim dhe veprat e këtyra që dalin prej tij, pa diskutim, nuk pranohen dhe nuk kanë shpërblim; përkundrazi, meritojnë dënim të Allahut (xh. sh.).

Kur nijeti i besimtarit është i sinqertë, ai shfaq bindjen ndaj Krijuesit të Tij, ndaj

urdhrave të Tij, shfaq nënshtrim dhe frikërespekt. Në të njëjtën kohë, shfaq bindje dhe dashuri ndaj Pejgamberit (alejhis-selam) dhe ai nuk ka për qëllim arsye të tjera, që nuk përkojnë me këto që u përmendën. Atëherë ai njeri-besimtar konsiderohet që po kryen obligimet e tij dhe qëllimin parësor të ekzistencës së vet.

Sado që nuk mund ta adhurojmë e ta madhërojmë Allahun ashtu siç e meriton Ai, ajo që na takon dhe që është në mundësitë tona, ajo duhet realizuar ose, së paku, të kemi nijetin, saqë edhe për këtë shpërblim nuk mungon.

Brenda këtij synimi nuk përjashtohet fakti se mund të bëjë pjesë edhe dëshira e besimtarit për devotshmëri, për çiltërsi, pastërti e që me të gjitha këto arrihet kënaqësia e Allahut të Lartmadhëruar.

Ndërsa efektet e këtyre qëllimeve shoqëruese pasqyrohen dhe japin frytet e tyre edhe në këtë botë si p. sh. në përmirësimin e raporteve dhe të komunikimit, në shtimin e diturisë, në përmirësimin e sjelljeve, në urdhërimin për të mirë, në ndalimin nga e keqja etj.

Dobia dhe rezultati i urdhrave apo ndalesave nga ana e Allahut për njerëzit, thënë më mirë: për besimtarët, nuk parashihen vetëm në botën e amshuar (Ahiret), por dobia, efekti, urtësia dhe rezultatet janë nga më të ndryshmet edhe në këtë botë dhe kanë fushëprim shumë më të gjerë.

Të gjitha këto arrihen kur nijeti është i pastër, i sinqertë dhe kryerja e detyrave, praktikave fetare bëhet me përkushtim dhe në formën e duhur.

Do të ishim shërbyer me një rast nga jeta e pejgamberit tonë, mësuesit të njerëzimit - Muhamedit (alejhis-selam), tek i cili kishte ardhur Omeri (r. a.) pasi kishte migruar në Medinë dhe i kishte thënë se një i ri që ka emigruar (ka bërë hixhret) bashkë me myslimanët, nuk ka pasur për qëllim urdhrin e Allahut, kënaqësinë e Tij dhe ndjekjen e pejgamberit të Tij, por ka emigruar që të martohet, pasi atje ku ishte (në Mekë) nuk e lejuan.

Atëherë Pejgamberi (alejhis-selam) thotë një thënie që sot e kësaj dite mbetet nga më të njohurat dhe më thelbësoret për ta dalluar adhurimin, kënaqësinë e Allahut dhe përfitimet apo kënaqësitë e kësaj bote: Transmeton Omeri (r. a.), prijësi i besimtarëve dhe thotë: E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut duke thënë: “Me të vërtetë, veprat vlerësohen sipas qëllimit dhe se çdokujt do t'i plotësohet ajo që ka pasur për qëllim. Prandaj, kushdo që ka bërë shpërngulje (hixhret) për hir të Allahut dhe të të dërguarit të Tij, shpërngulja e tij është për Allahun dhe të dërguarin e Tij, dhe kushdo që ka bërë shpërngulje për këtë botë, që të fitojë disa përfitime të saj, ose që të martohet me ndonjë grua, shpërngulja e tij është për atë që e ka kryer, për atë që ka pasur për qëllim.” (Buhariu dhe Muslimi)

Si përmbyllje, themi që le të na shërbejë nijeti që ta ndajmë traditën nga adhurimi dhe të vetëdijesohemi mbi gjërat që kryejmë dhe të vëmë në vepër se çka na ofrojnë ato neve: adhurim dhe punë - për shkak se Allahu meriton, për afrim me Lartmadhërinë e Tij dhe arritjen e kënaqësisë së Tij, apo për shkak se ato i kryejnë të tjerët ose për ndonjë interes tjetër.

I lutemi Allahut fuqplotë që të na pastrojë zemrat dhe shpirtat tonë e të na dhurojë sinqeritet e begati në këtë botë e në botën tjetër.

Falënderimi i takon vetëm Allahut fuqplotë.

**(Autori është student në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup)**

## REFLEKTIME NGA STAMBOLLI I MADH



Në momentet kur gjendesh në xhami të mëdha, si ato në Stamboll, dhe kur kryen adhurimin para të Madhit Allah, nuk është e mundur që të mos inspirohesh.

Qëndrimi para të Madhit Zot në shtëpitë e mëdha të Tij (në Xhaminë Sulejmanie, për shembull), në kryeqytetin e civilizimit pesëshkullor, të rikujton faktin se je trashëgimtar i një misioni të madh dhe se mbi supet bart një amanet të madh.

Njëherësh, radhitja në safet e gjata të kësaj xhamie të madhe, për të qëndruar para Krijuesit më të Madh, me gjithë dallimet që kanë ata që falen (gjendja sociale, ekonomike dhe jetësore), të flet qartë për barazinë reale e jo artificiale që

mbjell kjo fe madhështore mes njerëzve, e cila me ftesën Allahu Ekber dhe Ejani në namaz insiston të eliminojë të gjitha llojet e ndjenjave të madhështisë që mund t'i ndjejë njeriu - ndjenja këto që mund ta bëjnë të shprehë mendjemadhësi dhe diskriminim ndaj të tjerëve.

Qëndrimi para të Madhit Allah për disa minuta me koncentrim, e bën njeriun që ta kuptojë peshën e vet dhe që kur ta mbarojë këtë komunikim me shprehjen Esselamu Alejkum ve Rahmetullahi ve Berekatuhu me Krijuesin, të ndërrojë qasjen dhe bontonin ndaj krijesave, duke i trajtuar ato me paqe e dashuri.

Përgatiti: Rufat Sherifi (në bashkëpunim)

## BIBLIOTEKA GJIGANTE

Në Stamboll (Republika e Turqisë) së fundmi është ndërtuar një bibliotekë gjigante, thuajse më e madhe se një fushë e madhe sporti.

Biblioteka është hapur këto ditë dhe ka një hapësirë prej 110.000 m<sup>2</sup>, është e pajisur me mbi 2 milionë libra, ka kapa-

citet të pranojë njëkohësisht mbi 4.200 lexues dhe, më e veçanta e saj është - do të jetë e hapur 24 orë për çdo ditë.

Me të vërtetë, kjo është një paradaj për çdo studiues e hulumtues.

(Dr. Rijad Imeri/në bashkëpunim: F. 14.01.2023)



# SHËNIME NGA BRESANA

*Urojmë që rinia jonë të pajiset me dituri cilësore, të dëshmojë vlera të larta etiko-morale, të pasurojë kulturën tonë me krijimtari të reja artistike të bazuara në datat e reja historike, të respektojë punën e ndershme, që të ndërtojë shtetin ashtu siç e kemi ëndërruar dhe siç i kemi kënduar, thonë në këtë fshat të Kosovës.*



**Nga Daim Hiseni**

Bresana është fshati më i madh i rajonit të Opajës, që i përket komunës së Dragashit në Kosovë.

Bresana numëron mbi 3.000 banorë dhe të gjithë i përkasin besimit islam.

Në këtë fshat mësuam për një traditë të re, të krijuar pas luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: aty asnjë shitore, asnjë kafene apo restorant nuk mban raki, si dhe rrugët e fshatit nuk dekorohen për Krishtlindje, duke përfshirë edhe Vitin e Ri.

Banorët e fshatit merren me blegtori, duke qenë të njohur për djathin cilësor dhe për prodhimet tjera nga qumështi.

Ata tregojnë se në kohën e sistemit monist dyqanet kanë qenë të detyruara nga serbët që të mbajnë raki. Policia e përzier dhe inspektorët të Sekretariatit të Punëve të Brendshme vinin në fshat, na detyronin t'u thernim dhe t'u pjekim disa qengja, ta servirnim atë me raki dhe pasi pinin e deheshin, na ofendonin rëndë, duke përgojuar gratë dhe bijat tona, në mënyrën se qenkan faqekuqe dhe ndër gratë më të shëndosha në Kosovë, ngase rriten me qumësht dhensh, se janë gra të plleshme, që lindin "bellokapci", djem me plisa të bardhë etj.

Më 7 janar 2023 bëhen plot 78 vjet

nga masakra në xhaminë e Pozheranit, ku komunistët serbë, të mbështetur edhe nga bashkëpunëtorët e tyre si çifti i Sinan Hasanit, pasi pinë raki, bënë qejfin e tyre, filluan me ushtrimin e dhunës, të torturës, të nënçmimit dhe të ofendimeve të tipit "kemi Bozhiç (Krishtlindje), duhet të therim ndonjë thi".

Me këto fjalë grumbulluan në xhaminë e Pozheranit mbi 250 fshatarë të moshave 15 - 65 vjeç, ku nga dajaku dhe torturat aty vdiqën 4 burra, ndërsa 17 prej tyre u morën dhe më asnjëherë nuk u kthyen dhe sot e kësaj dite nuk u dihet varri. Dy të tjerë, që ua dimë emrat, i kanë pjekur për së gjalli në një rënë nga furrat e Gjilanit dhe shumica prej tyre vdiqën më vonë si pasojë e torturave të ushtruara.

Njësoj e kemi edhe masakrën në xhaminë e Preshevës, masakër kjo e cila këtë vit mbush plot 80 vjet, ku dihen me emër dhe mbiemër komunistët serbo-maqedonas të cilët, pasi shtruan rakinë në kafenenë e Tozo Popoviçit, në Natën e Kadrit e rrethojnë xhaminë dhe ua hudhin bombat brenda, ku mbetën të vdekur disa të rinj shqiptarë. Të mos flasim për përdhunimet, masakrimet dhe gjenocidin e ushtruar në luftën e fundit.

Si besimtarë, thonë në Bresanë, jemi të obliguar ta nderojmë dhe ta besojmë

hazreti Isën si gjithë profetët tjerë. Pastaj, jemi njerëz që i kuptojmë të tjerët dhe i nderojmë besimet tjera. Zakonisht, ua urojmë festat shqiptarëve katolikë si në Kosovë, ashtu dhe në Shqipëri. Por, nuk festojmë Krishtlindje, nuk i stolisim shtëpitë dhe rrugët tona në ditën dhe festën e "Bozhiçit", shkak se duam të solidarizohemi me familjet shqiptare, të cilëve serbi mu në këtë datë ua ka djegur shpirtin. Historia që harrohet, vlen të përsëritet. Nuk mund t'i harrojmë këto përjetime të hidhura.

Edhe ne, si çdo fshat tjetër në Kosovë, e kemi ndihmuar Luftën dhe krenohemi me dëshmorët tanë, të cilët kanë rënë për lirinë e Kosovës. Shumë marshe organizohen për nder të dëshmorëve të rënë.

Bresana ka xhami, e cila është e pasur me libra dhe ajo shërben për bibliotekë, edhe pse puna dhe angazhimet në këtë jetë dinamike nuk na lënë shumë hapësirë për aktivitete të lira. Megjithatë,

urojmë që rinia jonë të pajiset me dituri cilësore, të dëshmojë vlera të larta etiko-morale, të pasurojë kulturën tonë me krijimtari të reja artistike të bazuara në datat e reja historike, të respektojë punën e ndershme, që të ndërtojë shtetin ashtu siç e kemi ëndërruar dhe siç i kemi kënduar, thonë në Bresanë. (F.4.01.2023)

# QAFËZEZI SHËNOI HAPIN E PARË NË PËRKTHIMIN E KURANIT

**Zoti në Kuranin fisnik na urdhëron, duke na thënë: Punoni, se vërtet punën tuaj do ta shohë Allahu, Pejgamberi dhe besimtarët.**

**Nga Naim ef. Tërnavë**

Siç dihet, këtu e një shekull më parë, falë punës e angazhimit të bashkëdhetarit tonë në mërgim, Ilo Mitkë Qafëzezi, më konkretisht në Ploeshti të Rumanisë, më 1921, e pa dritën e botimit edhe një pjesë e Kuranit e përkthyer në gjuhën shqipe, duke shënuar kështu hapin e parë për përkthimin e Kuranit në gjuhën tonë dhe kështu u dëshmuua konkretisht se populli ynë, gjuha jonë dhe qarqet tona intelektuale janë të zotët e të gatshëm që edhe vepra siç janë libri hyjnor Kurani t'i bëjnë pronë të kulturës sonë dhe t'ua mundësojnë njerëzve tanë që t'i kuptojnë ata dhe të iluminohen me kuptimin dhe mësimet e tyre.

Përkthimi i Kuranit në cilindo gjuhë, në çdo kohë e në çdo rrethanë, paraqet një akt të rëndësishëm së veçantë; aq më tepër kur kjo bëhet për herë të parë dhe aq më shumë kur dihet se Kurani është libër i shenjtë i myslimanëve, është themeli i fesë së tyre dhe burim i dinit islam e me ndikim të pakontestueshëm në jetën e tyre.

Populli ynë ka shekuj të tërë që bashkëjeton me Kuranin, që jeton e vepron me mësimet e mirësitë e tij, që edukohet, ndërgjegjësohet e fisnikërohet me porositë e këshillat e Kuranit të madhërishtëm. Dhe, jo vetëm kaq, por shqiptarët që herët u përfshinë në dinamikën kuranore, duke dalë nga radhët e shqiptarëve personalitete të shquara që e kanë njohur, e kanë komentuar, e kanë studiuar dhe interpretuar Kuranin ndër shekuj.

Mirëpo, për shumë arsye, shqipërimi i Kuranit, krahasuar me popujt tjerë, është relativisht i vonë. Është i vonë edhe për shkaqet dhe rrethanat e njohura, të cilat e vonuan edhe botimin e literaturës së përgjithshme në gjuhën shqipe.

Botimi i përkthimit të Kuranit nga Ilo Mitkë Qafëzezi, sikurse e theksuam, vjen



në duart e shqiptarëve në vitet '20 të shekullit të kaluar, pothuajse një dekadë pas pavarësisë së shtetit shqiptar dhe në kohën kur konsolidohen, themelohen dhe fillojnë veprimtarinë e tyre institucionet kryesore shtetërore, arsimore, kulturore e fetare.

Vepra e Qafëzezit, megjithëse një vepër e rëndësishme e botuar dhe e realizuar në një kohë delikate e plot kthesa për popullin tonë, një vepër e realizuar nga një bashkëkombës i ynë ortodoks për vëllezërit e tij myslimanë, për çudi, as dje e as sot, nuk ka marrë vëmendjen e duhur të studiuesve dhe as vendin meritues në historinë e literaturës shqipe.

Edhe kur është përmendur, ç'është e drejta, është përmendur fare kalimthi, sa kohë që një vepër e tillë - pavarësisht se në fushën e përkthimeve të Kuranit në gjuhën shqipe tashmë është tejkaluar - ajo pa diskutim mbetet një ndër veprat më të rëndësishme për kohën kur është botuar dhe për qëllimin që ka mbartur si vazhdimësi e frymës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Prandaj, është detyrë e studiuesve tanë që këtë vepër ta trajtojnë shkencërisht dhe me kompetencë. Duke (ri)sjellë në vëmendje të studiuesve dhe të interesuarve veprën e Qafëzezit, do të shënohet një hap i parë, por domethënë, për trajtime të mëtejshme të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe nga Ilo Mitkë Qafëzezi.

Vepra e Ilo Mitkë Qafëzezit ka edhe

një dimension tjetër: ajo në kohën kur u botua provokoi debate, por mbi të gjitha përshpejtoi përkthimin e Kuranit në gjuhën shqipe nga teologët kompetentë myslimanë të kohës, siç ishin dijetarët dhe prijësit e shquar h.fz. Ali ef. Korça, h.fz. Ibrahim ef. Dalliu, h.fz. Vehbi ef. Dibra etj.

Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame dhe Bashkësia Islame e Kosovës në përgjithësi do të mbështesin dhe do të përkrahin çdo iniciativë, çdo projekt dhe aktivitet, jo vetëm në kuadër të institucioneve të saj, por edhe në bashkëpunim me bashkësitë tona simotra - në Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe në Mal të Zi, sepse njohja e të kaluarës sonë të begatë është obligim yni, ngase na garanton një të ardhme më të sigurt. Kjo, për të qenë paluhatshtëm në shërbim të Kuranit dhe të vlerave të tij, sepse ajo punon me Kuran dhe aty mbështetet.

Zoti në Kuranin fisnik na urdhëron duke na thënë:

Punoni, se vërtet punën tuaj do ta shohë Allahu, Pejgamberi dhe besimtarët.

**(Nga konferenca shkencore "Një shekull nga botimi i përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe nga Ilo Mitkë Qafëzezi", mbajtur në Prishtinë më 21 shtator 2021 nga Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, Prishtinë. Autori është Myfti i Bashkësisë Islame të Kosovës)**

# GUXO DHE PËRKRAH TË DREJTËN

*Që të mbrohet e vërteta, duhet dikush të marrë guximin dhe ta thotë. Pastaj, atij që e thotë nuk duhet t'i mungojë sinqeriteti, argumenti dhe forma e duhur e shprehjes së të vërtetës. Në anën tjetër, këtë të vërtetë duhet dikush ta dëgjojë...*

**Nga Reshat Kaçallniku**

Sa më lart që mendon se është ngritur njeriu, aq më e pavarur i duket vetja nga udhëzimi hyjnor.

Ky lloj perceptimi për vetveten shkatërron, pa e ndjerë brendësinë shpirtërore, por dhe logjikën e tij në konceptimin e veprimtarive dhe vendimeve që merr. Dita nuk i ngjan ditës e as viti vitit e njeriu është çuar kundër njeriut - i arsimuari është pa devotshmëri, "besimtari" duket vetëm në formë dhe jo në moral cilësor, i fuqishmi vetëm përhap shkatërrime në tokë, i pasuri është fascinuar me ndërtimet e tij, që nuk kanë as bukuri për syrin, as qetësi për shpirtin e as kujdes ndaj shfrytëzimit të tokës që vetë e quan atdhe. E gjithë kjo në sy të një administrimi të pafuqishëm, ose si rezultat i zhytjes në shfrytëzim, nga para.

Dëshiroj të përkujtoj veten dhe të gjithë juve me një margaritar nga oqeani i thellë dhe i gjerë pa brigje i Kuranit të lartmadhëruar. Kur ta kuptoni, menjëherë do të gjunjëzohemi bashkërisht, me çka ju mbetet ose të ndryshoni, ose do të bartni barrën historike ndër breza, por edhe llogarinë para të madhit Zot.

Thotë Allahu (xh. sh.) në suren Jasin, ajetet 20 dhe 21: **"Dhe prej skajit të largët të qytetit erdhi me nguti një njeri dhe tha: 'O populli im, dëgjoni të dërguarit! Dëgjoni ata që nuk kërkojnë prej jush ndonjë shpërblim dhe që janë udhërrëfyes!'"**

Duke shkëputur fragmentin: "...prej skajit të largët të qytetit erdhi me nguti një njeri...", kuptojmë se ka momente kur njeriu vetë duhet të nisë një vetiniciativë të caktuar. Nëse ai ka kapacitetet dhe njohuritë e duhura për ta shpalosur një të vërtetë, ngjyrimi në bindje nuk duhet të jetë pengesë për t'u hapur sytë dhe zemrat njerëzve për atë që as nuk e shohin e as zemrat nuk ua ndejnë.

Kjo vlen sidomos për institucionet vitale, prej të cilave varet ardhmëria popullit, përkatësisht: arsimit, familja, përfaqësimi i drejtë, puna e dinjitetshme dhe beteja me të keqen, që nuk i kap vetëm keqbërësit, por edhe gjithë të tjerët që sillen sikur



s'kuptojnë. Fatkeqësisht, kjo që u theksua është shndërruar edhe në sëmundje karakteri.

Që të mbrohet e vërteta, duhet dikush të marrë guximin dhe ta thotë. Pastaj, atij që e thotë nuk duhet t'i mungojë sinqeriteti, argumenti dhe forma e duhur e shprehjes së të vërtetës.

Në anën tjetër, këtë të vërtetë duhet dikush ta dëgjojë. Nëse i kthehem ajetit të sures Jasin, largësia nuk e pengoi thirrësin që ai të dalë me ngut për të proklamuar të vërtetën. Kjo jep të kuptosh se 'nëse jam ndryshe prej teje', ose 'nuk jam në funksion ose pozitë si ti', ose 'nëse bindjet e mia nuk janë si tuat' etj., mes nesh duhet të flet argumenti, ndërsa të gjitha të tjerat janë dytësore apo sekondare.

Puna që bëhet për të mirën kolektive është jetike. Prej saj varet fati ynë dhe çështja se a do të jemi këta që jemi, apo do të tjetërsohemi; a do ta dashurojmë e respektojmë njeri-tjetrin sinqerisht, apo do të xhelozojmë dhe do të mburremi me pozitën tona sikur Iblisi kur tha se 'është më i mirë se Ademi (a. s.) vetëm e vetëm sepse ishte krijuar nga zjarri', me ç' rast u bënë dëmtues i vetvetes.

Kur shikojmë se e vërteta rrezikohet duke u kanosur njerëzit që proklamojnë të vërtetën; kur shohim se në çdo institucion të mundshëm, por edhe brenda familjes, rrezikohet drejtësia, duhet domosdoshmërisht të flasim e të punojmë me të gjitha mjetet e kohës, vetëm e vetëm që të shpëtohet e vërteta dhe të fitojë drejtësia. Kjo

do të bëjë që në tokat tona shekullore dhe në institucionet tona edukativo-arsimore cilësore të ketë përfaqësim njerëzish të aftë dhe të drejtë dhe jo me piskëllima – pra, fe në thelbin e kuptimeve të saj dhe jo njerëz të britmave etj.

Njeriu në ajetin e lartshënuar nuk përmendet me emër, me ngjyrë, me përkatësi etj., por përmendet me punën që bën, me veprimtarinë e vet, e cila u përjetësua deri në kiamet në Kuranin famëlartë.

Ai me veprimtarinë e vet tregon dashurinë ndaj fesë, përkrahjen në mision të njerëzve të zgjedhur, besnikë, fisnikë, larg interesave të ulëta të njerëzve të korruptuar, dëshira që në mjedisin e njerëzve të dominojë e vërteta, dashuria ndaj interesit të përgjithshëm, liria e prezantimit të idesë me urtësi dhe këshilla cilësore dhe ku triumfi do të jetë përfundimisht në anën e të sinqertëve.

Për këtë ajet ka shumë të thuhet, mirëpo ne u munduam të themi aq sa na nevojitet për të kuptuar thelbin e temës që po trajtojmë. Pra, për të kuptuar se Kurani vërtet të bën krenar, të zgjon logjikën e fjetur, të bën të jesh vetëkorrigjues për të mirën e vetes dhe të gjithkujt rreth teje. Për të mirën e atij që përfaqëson dhe për krenarinë e të përfaqësuarit.

**Burimi:**  
<https://myftinadiber.com/guxo-dhe-perkrah-te->

(Autori është Myfti i Myftinisë së BFI-Dibër)

# LARGIMI NGA GJYNAHET

*Gjynahet e dobësojnë zemrën dhe trupin, sepse fuqia e besimtarit qëndron në fuqinë e zemrës së tij dhe, sa më shumë të forcohet zemra, aq më shumë forcohet trupi i tij. Gjynahet e nxjerrin nga zemra dritën e shikimit të realitetit, duke e parë të shëmtuarën si të bukur dhe duke u mësuar me të shëmtuarën. Gjynahet e pengojnë kryerjen e veprave të mira dhe obligimeve ndaj Allahut (xh. sh.).*

**Shkruan: Mr. Nexhati Spahiu (Enkas për HeR)**

Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut të madhërshtëm, i Cili është i vetmi që meriton të adhurohet, ndërsa përshëndetjet tona qofshin mbi zotëriun tonë, dritën e syve tanë, kandilin e zemrave tona, mësuesin dhe udhërrëfyesin tonë, pishtarin ndriçues, pionierin e paqes dhe të diturisë - Muhamedin (a. s.), të cilin Zoti e dërgoi mëshirë për mbarë njerëzimin.

A thua ku ta kërkojmë përgjigjen e pyetjeve tona? Le ta vëmë pak mendjen tonë në funksion. Cili është Ai që e sundon tokën dhe qiejt? Cili është Ai që i zbrat të mirat e të këqijat? Kush e krijoi vdekjen dhe jetën, thatësinë dhe shiun, fatkeqësitë dhe begatitë?!

Mëkati është i vjetër sa edhe njeriu. Po të shohim çdo fatkeqësi që ndodh në planetin tonë, do të gjenim që shkaku kryesor janë gjynahet e njerëzve. Pikërisht gjynahu ishte shkak që i nxori dy prindërit e njerëzimit nga xheneti. Çfarë e nxori Iblisin nga Mëshira e Allahut (xh. sh.)? Ishte, pra, mosdëgjimi i fjalës së Krijuesit Fuqiplotë! Shkaku që e përmbysi popullin e Nuhut (a. s.) ishin gjynahet që bënë! Popullin e Adit nuk e shkatërroi gjë tjetër, përveçse gjynahet që bënë! Edhe popullin e Lutit (a. s.) ishin gjynahet ato që i shkatërruan! Gjynahet kanë ekzistuar dhe do të vazhdojnë të ekzistojnë deri në Kiamet. Edhe në kohë tonë që ne jetojmë për çdo ditë bëhen gjynahet ndaj vetvetes, të tjerëve dhe ndaj Allahut (xh. sh.).

"Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu që



të tërhiqen (nga të këqijat)".<sup>1</sup> (Rrum, 41)

"Çfarëdo e mirë që ju mbërrin, ajo është nga Allahu; çfarëdo e keqe që ju godet, ajo është nga vetë ju".<sup>1</sup> (El Nisa, 79)

Enes bin Maliku e pyeti njëherë Aishen (r. a.): "Oj nëna e besimtarëve, kur ndodhin tërmete në tokë?" Ajo iu përgjigj: "Ndodhin tërmete në tokë kur pihet alkooli me shumicë, kur shfaqet imoraliteti dhe kur përhapen gjynahet. Atëherë e urdhëron Zoti tokën që të dridhet." Enesi e pyeti përsëri: "A si ndëshkim për ta, o Aishe?" "Jo - i përgjigjet - por si mëshirë dhe këshillë për besimtarët dhe si ndëshkim dhe zemërim ndaj jobesimtarëve."<sup>iii</sup> (Hadith)

Çdo abstënim nga jeta e harmonishme e njerëzisë, çon në konfrontim me rendin kozmik në natyrë. Mbi këtë jep shenjë edhe Kurani në shumë raste, si-

kurse:

"E qiellin e ka ngritur dhe ka vënë masë (drejtësinë), për të mos kaluar (kufirin) në matje." (Er-Rrahmān, 7-8)<sup>i</sup>

Pra, tërmetet, vërshimet, katastrofat e ndryshme natyrore, viruset etj. i dërgon Allahu (xh. sh.) me qëllim që të vetëdijësohemi, të pendohemi, të kthehemi tek Ai, t'i shtojmë veprat tona të mira e të largohemi nga veprat e këqija.

Gjynahet e dobësojnë zemrën dhe trupin, sepse fuqia e besimtarit qëndron në fuqinë e zemrës së tij dhe, sa më shumë të forcohet zemra, aq më shumë forcohet trupi i tij.

Gjynahet e nxjerrin nga zemra dritën e shikimit të realitetit, duke e parë të shëmtuarën si të bukur dhe duke u mësuar me të shëmtuarën.

Gjynahet e pengojnë kryerjen e ve-

# MOS TË HARROJMË: KOHA NUK PRET ASNJERI

**K**oha është thesar i çmuar që shumë kush nuk ia di vlerën, shpërblimin, përgjegjësinë, kështu që është problemi më madhor që duhet të preokupojë çdo mysliman.

Një ndër begatitë më të mëdha që Allahu u dha njerëzve është koha. Atë Allahu (xh. sh.) e ndau në mënyrë të barabartë për të gjithë njerëzit pa dallim - a është i pasur apo i varfër, burrë apo grua, fëmijë apo i rritur, i bardhë apo i zi.

Vlerat e kohës theksohen në shumë ajete kuranore dhe në shumë thënie profetike. Në mënyrë të veçantë, Allahu betohet në kohën: **“Pasha kohën (e ndërmjetme)! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin që t’i përmbahen të vërtetës dhe që e këshilluan njëri-tjetrin që të jenë të durueshëm.”** (Asr: 1-3)

Pejgamberi ka thënë: *“Ka dy mirësi që shumica e njerëzve nuk ua dinë vlerën: shëndeti dhe koha e lirë.”* *“Mos e shani kohën, se me të vërtetë Allahu është koha.”*

Thuhet: *“Ata kërkojnë prej teje që t’ua shpejtosh dënimin, por Zoti nuk e thyen premtimin e Vet, sepse një ditë te Zoti yt është sa një mijë vjet që llogaritni ju.”* (El Haxh: 47) *“Ai e rregullon çështjen (e të gjitha krijesave) prej qiellit në tokë, pastaj ajo (çështje) ngrihet tek Ai në një ditë që sipas llogarisë suaj është sa një mijë vjet.”* (Es-Sexhde: 5)

Hasan Basriu ka thënë: *“Kam takuar njerëz të cilët kanë qenë më kureshtarë për të ruajtur kohën seç jeni ju për të ruajtur paratë tuaja.”*

Meqë vlera e kohës është kaq e rëndësishme, atëherë le ta kthejmë çdo sekondë në thesar që nuk ka të mbaruar. Le ta harxhojmë kohën për gjëra të veçanta.

Mos të harrojmë: Koha nuk pret asnjeri.

E djeshmja mbeti me të shkuarën,

bëni.”<sup>xv</sup> (El-Bekare, 271)

I Dërguari - lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin për të - ka thënë: *“A dëshiron t’i tregoj dyert e mirësisë? – Agjërimi është mbrojtje, ndërsa lëmosha e shuan mëkatit, si uji që e shuan zjarrin.”*

Sadakaja e fut dhënësin e saj nën hije nga nxehtësia e diellit Ditën e Kiametit. Muhamedi (a. s.) ka thënë: *“Çdo njeri do të jetë nën hijen e sadakasë së tij, derisa të gjykohet mes njerëzve.”* (Këtë hadith e shënon Ahmed, kurse Albani e klasifikon si autentik) Ndërkaq, në hadithin e Të Shtatëve thuhet: *“dhe njeriu që jep sadaka fshehurazi, saqë dora e majtë nuk e di ç’jep e djathta.”*<sup>xvi</sup> (Hadith)

## 5. Duaja (lutja):

Duaja është prej adhurimeve më madhështore, sepse nëpërmjet saj manifestohet sinqeriteti, përlulesia, besimi i vërtetë.

*“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, u përgjigjem lutjeve të lutësit kur ai më lutet Mua.”*<sup>xvii</sup> (El-Bekare, 186)

I dërguari i Allahut - lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi të - ka thënë: *“Njihe Zotin tënd në rehati, që të të njohë Ai në vështirësi.”*

Transmetohet se i dërguari i Allahut - sallallahu’alejhi selem - ka thënë: *“Kërkoni nga Allahu besim të fortë (jekin) dhe shëndet, dhe pas besimit askujt nuk do t’i jepet asgjë më e mirë se shëndeti.”*<sup>xviii</sup> (Hadith)

Allahun e lusim të na mundësojë pendim të sinqertë, largim nga mëkatet, dije të dobishme, besim të fuqishëm, të mira në këtë jetë dhe në ahiret; të na mbrojë nga sprova që i dimë dhe që nuk i dimë, të na mundësojë xhenetin dhe të na mbrojë nga xhehenemi. Amin.

**(Autori është imam dhe profesor nga Prizreni)**

1. Rrum, 41
2. En-Nisa, 79
3. Hadith
4. Rrahman, 7-8
5. Buhariu, 5833
6. En-Nisa, 31
7. Hadith, Tirmidhiu me numër (2499) dhe ibn Maxheh me numër (4251).
8. El-Ankebut, 7
9. Muslim, 2565
10. En-Nisa, 31
11. Taha, 82
12. Muslim 233
13. El-Furkan, 68-70
14. Sahiul Xhami, 3008
15. El-Bekare, 271
16. Buhari & Muslim
17. El-Bekare, 186
18. Buhariu

prave të mira dhe obligimeve ndaj Allahut (xh. sh.).

Muhamedi (a. s.) ka thënë: *“Besimtari i sheh gjynahet e tij sikur të ishte në rrëzën e një mali dhe ka frikë se i bie mbi krye, ndërsa i prishuri i sheh gjynahet e tij si të ishin një mizë që i qëndron mbi hundë, ndërsa ai i bën me dorë dhe ajo fluturon.”*<sup>xv</sup> (Hadith)

Muhamedi (a. s.) kur kishte ndonjë problem, ndonjë vështirësi, nuk klithte e nuk bërtiste, por e shtonte ibadetin, pendohet më shpesh dhe e luste Allahun për falje. Në këtë mënyrë pak a shumë sillëshin edhe as’habët; kjo vlen edhe për ne dhe do të vazhdojë derisa të ketë jetë në këtë planet.

*“Në qoftë se ju u shmangeni gabimeve të mëdha, atyre që u janë ndaluar juve, Ne do t’i mbulojmë gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpijmë në (një) vend të mrekullueshëm (në xhenet).”*<sup>vi</sup> (En-Nisa, 31)

Muhamedi (a. s.) në një hadith të tij ka thënë: *“Çdo bir i Ademit është gabimtar; e më i miri nga gabimtarët është ai që pendohet.”*<sup>vii</sup> (Hadith)

## DISA NGA VEPRA TË PASTROJNË MËKATET

### 1. Besimi në Allah (xh. sh.):

Njëri u ka nevojë për Zotin e tij në çdo moment. Besimi është shpirti i besimtarit. Nuk ka vlerë një trup i cili nuk posedon shpirtin, që është dhurata më e madhe nga ana e Allahut (xh. sh.). Besimi në Allah e ndriçon rrugën e kësaj jete dhe shpërblimet e botës së përjetshme. Besimi në Allah bën një ndryshim esencial në jetën e njeriut, sepse përfshin tërë jetën e tij, përfshin mendjen e tij, gjuhën e tij, veprat e tij, dëshirat e tij, synimet e tij.

Allahu (xh. sh.) thotë: *“Atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me siguri që do t’ua shlyejmë të këqijat dhe do t’u japim shpërblim më të mirë se puna që kanë bërë.”*<sup>viii</sup> (El-Ankebut, 7)

Pejgamberi - lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin për të - ka thënë: *“Hapen dyert e Xhenetit ditën e hënë dhe ditën e enjte, dhe në këto ditë i falet çdo rob që s’i bën Allahut shirk.”*<sup>ix</sup> (Hadith)

### 2. Largimi prej mëkateve të mëdha:

Prej mëshirës së Allahut për robërit e Tij është përgatitja e disa shkaqeve, ku me veprimin

dhe praktikimin e tyre myslimanit i falen dhe i shlyhen mëkatet e bëra.

Allahu (xh. sh.) thotë: *“Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju*

janë ndaluar, Ne do t’jua falim gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpiem në një vend të nderuar.”<sup>x</sup> (En-Nisa, 31)

*“Nuk ka dyshim se Unë e fal atë që është penduar, që ka besuar, që ka bërë vepra të mira dhe që përqendrohet për në rrugën e drejtë.”*<sup>xi</sup> (Taha, 82)

Pejgamberi - lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin për të - ka thënë: *“Pesë kohët e namazit, Xhumaja deri në Xhumanë tjetër, Ramazani deri në Ramazin tjetër, i fshijnë mëkatet që janë ndërmjet tyre, për aq sa iu largohet mëkateve të mëdha.”*<sup>xii</sup> (Hadith)

### 3. Pendimi i sinqertë nga e kaluara:

Pendimi është gjëja më e shtrenjtë që e posedon besimtari dhe asnjëherë nuk duhet humbur shpresën në mëshirën e Allahut fuqplotë.

Allahu i madhërishtëm thotë: *“Dhe ata që, pos Allahut, nuk adhurojnë zot tjetër, nuk vrasin njeri, gjë që Allahu e ka ndaluar, përveçse me të drejtë dhe që nuk bëjnë kurvëri. E kush i bën këto, do të marrë gjynahe. Ndëshkimi do t’i dyfishohet në Ditën e Kiametit dhe ai do të qëndrojë përherë në këtë fatkeqësi i posthëruar. Përjashtim bën ai që pendohet, që beson dhe që punon vepra të mira. Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqija në të mira. Allahu është Falës e Mëshirëplotë.”*<sup>xiii</sup> (El-Furkan, 68-70)

Pendimi shlyen gjithë atë që njeriu ka vepruar më herët. Që pendimi të jetë i pranuar tek Allahu, dhe që i penduari të arrijë shpërblimin e premtuar nga Allahu, duhet t’i plotësojë kushtet e pendimit: të largohet menjëherë nga mëkati; të jetë pishman për mëkatit e bërë; dhe të vendos që mos të kthehet më në atë mëkat.

Pejgamberi - lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin për të - ka thënë: *“Ai që pendohet prej mëkatit, është i njëjtë me atë që nuk ka mëkat.”*<sup>xiv</sup> (Hadith)

Nëse mëkati ka të bëjë me padrejtësitë mes njerëzve, përveç që duhet të plotësohen kushtet e mëparshme, duhet të plotësohet edhe një kusht, e që është kërkimi i faljes nga ai që i është bërë padrejtësi. Të kërkojë hallallin prej tij.

### 4. Lëmosha (sadakaja):

Është një ndër veprat të cilat më së shumti i vlerëson Allahu (xh. sh.). Lëmosha ka një vlerë shumë të madhe si për njerëzit e gjallë, ashtu edhe për ata që kanë vdekur.

Allahu thotë: *“T’i jepni lëmoshat haptazi - është gjë e mirë; por, t’ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë dhe ju shlyhen disa nga gjynahet tuaja. Allahu e njuh mirë çdo vepër që ju*

# MËSHIRA DHE DASHURIA E ALLAHUT PËR BESIMTARËT

**Thotë një prej dijetarëve: Mos u lodh që të qëndrosh te dera e Zotit edhe nëse të largojnë prej aty dhe mos e ndërpre kërkim-faljen edhe nëse e përsërit. E nëse hapet dera për të pranuar, hyr me hyrje fëmijërore, shtrije dorën tënde aty dhe thuaj: Një i ndjerë kërkon lëmoshë. Pra, mëshiroje Atë me lëmoshë.**

**Shkruan: Mr. Ragmi Destani (Enkas për Her)**

Thotë Allahu në Kuran: **”E ju kur kërkonit shpëtim nga Zoti juaj, e Ai ju është përgjigjur juve.”** Allahu i lartmadhëruar thotë se ‘nuk hidhërohem në dikend më tepër sesa hidhërimi im ndaj një robi i cili bën mëkat dhe mëkati i tij bëhet aq i madh, duke ekzistuar falja ime’.

Allahu i shpall peygamberit Davud (a. s.): O Davud, po ta dinin ata që janë larguar prej meje se sa për malllohem për kthimin e tyre tek unë dhe dëshirën time për pendimin e tyre, ata do të digjen mall për mua. O Davud, kjo është dëshira ime për ata që janë larguar nga unë, e çfarë do të jetë dëshira ime për ata që duan të afrohen tek Unë.

Allahu i lartmadhëruar thotë: Unë e gjej veten Time të turpëruar nga robi im, i cili i ngre duart dhe thotë: o Zot, o Zot! dhe Unë të mos i përgjigjem. Melaqet më thonë se ky nuk është që duhet ta falësh atë, Unë them: Por, unë jam pronar i devotshmërisë dhe i faljes, ju dëshmoj se Unë e fala robin tim.

Transmetohet në Hadith se nëse i ngre robi mëkatat duart e tij drejt qiellit dhe thotë: **o Zot!,** e fshehin melaqet zërin e tij; kurse ai e përsërit: **o Zot!** dhe melaqet e fshehin zërin e tij përsëri; ai e përsërit: **o Zot!,** kurse melaqet e fshehin zërin e tij përsëri; e përsërit ai, në të katërtën. Atëherë Allahu i lartmadhëruar thotë: **Deri kur do ta fshihni zërin e robit tim prej Meje.** Allahu thotë: **Të përgjigjem robi im, të përgjigjem robi im, të përgjigjem robi im...**

”O robi im, të kam krijuar me duart e mia dhe të kam edukuar me begatinë

time, kurse ti më kundërshton mua dhe bën mëkat ndaj meje. Nëse kthehesh tek unë, e pranoj pendimin tënd. Ku do të gjesh Zot si unë, kur unë jam falës i mëshirshëm?!”

”O robi im, të nxora nga mosekzistenca në ekzistencë dhe të kam dhënë ty dëgjimin, shikimin dhe mendjen. Robi im: Unë t’i mbuloj të metat tua, kurse ti nuk frikësohesh prej meje. Unë të kujtoj ty, kurse ti më harron mua. Unë turpërohem prej teje, e ti nuk turpërohesh prej meje. Kush është më bujar se Unë dhe cili ka trokitur derën time, e nuk ia kam hapur; dhe cili kërkon diçka prej meje e nuk ia jap; a jam Unë koprrac, që të jetë koprrac robi im ndaj meje?!”

Erdhi një malësor te peygamberi Muhamedi (a. s.) dhe i tha: *O i dërguar i Allahut, kush u bën llogarinë krijesave Ditën e Gjykimit?* I tha Peygamberi (a. s.): *Allahu.* Malësori tha: *Vetë Ai?* I tha Peygamberi (a. s.): *Po, vetë Ai.* Qeshi malësori dhe tha: *O Allah, falënderimet qofshin për Ty.* Peygamberi (a. s.) i tha: *Pse po qesh, o malësor?* I tha: *O i dërguar i Zotit, Ai që është fisnik, kur i vjen mundësia për dënim, fal; kur bënë llogarinë, tejkalon.* Tha Peygamberi (a. s.): *E kuptoi malësori.*

Thotë një prej dijetarëve: Mos u lodh që të qëndrosh te dera e Zotit edhe nëse të largojnë prej aty dhe mos e ndërpre kërkim-faljen edhe nëse e përsërit. E nëse hapet dera për të pranuar, hyr me hyrje fëmijërore, shtrije dorën tënde aty dhe thuaj: *Një i ndjerë kërkon lëmoshë.* Pra, mëshiroje Atë me lëmoshë.

Thotë Allahu i lartmadhëruar në hadithin kudsij:

”O njeri, të kërkova ujë e nuk më dhe. Njeriu do të thotë: *E, si të të jap Ty ujë,*

kur Ti je Zot i botëve?! Zoti thotë: *A të ka kërkuar ujë robi im, filani? A nuk e ke ditur?! Se, po ti kishe dhënë ujë atij, do ta kishe gjetur atë tek Unë.*

O njeri: *Jam sëmure e nuk më vizitove.* Njeriu thotë: *E, si të të vizitoj Ty, kur Ti je Zot i botëve?* Zoti thotë: *Ishte sëmure robi im, filani... A nuk e ke ditur, se po ta kishe vizituar atë, do të më kishe gjetur aty.”*

Allahu i lartmadhëruar thotë përsëri: ”O robërit e mi, Unë ia kam ndaluar zullumin vetes time dhe e kam bërë atë haram mes jush; pra, mos bëni zullum mes jush.

O robërit e mi, të gjithë jeni të uritur, përveç atij që e kam ushqyer. Më ushqeni mua ju, që t’ju ushqej Unë juve. O robërit e mi, të gjithë jeni të zhveshur, përveç atij që kam veshur. Më vishni ju mua, që t’ju veshi unë juve.

O robërit e mi, të gjithë jeni të humbur, përveç atij që e kam udhëzuar. Më udhëzoni ju mua, që t’ju udhëzoj Unë juve. *(Kuptimi është: ushqeni të varfrit, ju ushqej juve; vishni të varfrit, t’ju jap pasuri juve etj.)*

O robërit e mi, ju bëni gabime natën dhe ditën, e unë ua fali të gjitha gabimet; kërkon falje tek Unë, e unë ju fali juve.

O robërit e mi, ju nuk mund të arrini të më dëmtoni, e as të arrini që të kem dobi prej jush.

O robërit e mi, nëse i pari prej jush dhe i fundit prej jush, njerëzit dhe xhindet, nëse të gjithë këta do të jenë në zemrën e më të mirit prej jush, nuk do të shtohet në pasurinë time asgjë.

O robërit e mi, nëse i pari prej jush dhe i fundit prej jush, njerëzit dhe xhindet, nëse të gjithë këta do të jenë në zem-



rën e më të keqit prej jush, nuk do të pakësohet gjë në pasurinë time.

O robërit e mi, nëse i pari prej jush dhe i fundit prej jush, njerëzit dhe xhindet, nëse të gjithë këta do të jenë në një vend së bashku dhe do të kërkojnë prej meje, dhe do t’i përgjigjem secilit në kërkesën e tij, nuk do të pakësohet tek Unë (dhe ajo do të vijë) sikurse një kovë uji prej deti.”

Transmetohet në hadith se, kur Ademi (a. s.) e bëri gabimin në Xhenet, Allahu i bëri thirrje, duke i thënë:

”O Adem, mos u frikëso nga thënia ime drejtuar ty ‘dil prej saj’, sepse për ty e kam krijuar; mirëpo, zbrit në tokë dhe ule veten për mua dhe dorëzohu në dashurinë time, derisa të të hiqe malli për mua dhe për Xhenetin. E, atëherë, eja që të të fus ty aty përsëri.

O Adem kishe dëshirë që të të mbrojt ty (që të mos kishe dalë nga Xheneti)? Ademi tha: *Po.* Zoti tha: O Adem, nëse do të kisha mbrojtur ty dhe pasardhësit

tu, cilin do ta kisha mëshiruar dhe cilin do ta kisha nderuar?! Cilin do ta kisha dashur dhe cilin do ta kisha falur?!”

O Adem, nëse bën mëkat dhe përkulesh tek Unë, (kjo) është më e dashur tek unë sesa adhurimi që bën me mendjemadhësi.

O Adem, gjëmimi i mëkatarëve (kur duan të pendohen) është tek Unë më i dashur se përmendja e mendjemëdhënjeve mua.“

O besimtar! Shihe mëshirën e Allahut në ty, që të mësosh të turpërohesh dhe shihe ledhatimin dhe përkujdesjen e Zotit për ty.

Thotë Allahu i lartmadhëruar në hadithin kudsij:

”Unë, njerëzit dhe xhindet jemi në hall të madh: Unë krijoj, ndërsa adhurohet tjetërkush, Unë furnizoj, kurse falënderohet jashtë meje. Të mirat e mia zbresin te robërit e mi, kurse të këqijat e tyre ngrihen tek Unë. I dua ata duke sjellë begati dhe (atëherë) jam i pavarur prej

tyre. Ndërkaq, kur krijojnë urrejtjen tek Unë me mëkate, ata janë shumë të varur prej Meje.

Ata që më përmendin mua, me ta do të jem në shoqërimin e tyre. Ai që don të më shoqërojë mua, le të më përmend. Ata që më adhurojnë, ata janë të dashurit e mi; ndërsa ata që bëjnë mëkate ndaj meje, nuk i përjashtoj prej rahmetit Tim. Nëse pendohen tek Unë, atëherë ata i dua, e nëse refuzojnë të pendohen, atëherë Unë jam shërues i tyre, i sprovov me telashe që t’i pastroj nga të metat. Kush vjen prej tyre pendues, e pranoj nga larg; ndërsa atë që largohet prej meje do ta thërras nga afër dhe t’i them: *Ku po shkon? A ke Zot tjetër përveç Meje?*

Vepra e mirë tek unë shpërblehet me dhjetë dhe e shtoj, kurse e keqja tek unë është me një; bile edhe e fal. Pasha madhërinë dhe krenarinë Time: Nëse kërkojnë falje tek Unë për mëkatet e tyre, do t’ua fali atyre.”

**(Autori është Kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Bujanocit)**

# HALLKA NË JETËN E STUDENTIT

**Një rini e kompletuar është begatia më e çmueshme e një shoqërie të shëndoshë në momentin kur ajo jetën e përcjell me parime fetare dhe kombëtare.**

**Nga Bajram Ferati**

Në të gjithë e dimë se një ndër hallkat apo zinxhirët më të rëndësishëm që e lidh studentin me rrugën e jetës dhe të dijes së tij janë: prindërit, mësuesit, profesorët apo udhërrëfyesit e tij. Ata, me rolin pozitiv dhe misionin fisnik e përgatitës dhe, njëkohësisht, i ndihmojnë studentit për hapat e drejtë dhe të sigurt në një të ardhme të shtrenjtë. Një profesor që është i aftë profesionalisht dhe me formim të plotë pedagogjik, arrin të jetë edhe një mësues i mirë, një edukator i mirë dhe njëkohësisht bëhet edhe idol apo model për studentin e tij.

"Suksesi nuk është çelësi i lumturisë. Lumturia është çelësi i suksesit. Nëse e do atë profesion që ti je duke e bërë, nuk ka dyshim se do të arrish patjetër majat e suksesit."

## ÇDO DIJE TË VIHET NË PRAKTIKË

Duhet ditur vërtet që çdo dije të vihët në praktikë dhe me urtësi dhe të ketë qasje në pozitën e duhur, me personin adekuat, se përndryshe është dështim i së ardhmes, sepse: dija është arma, ndërsa urtësia është përdorimi i saj.

Është pyetur hazreti Aliu (r. a.): "O udhëheqës i myslimanëve, çka e prish gjendjen e një populli?" Aliu (r. a.) ka thënë: "1. Kur e vendos të voglin në vend të atij të madhit; 2. Kur e vendos të paditurin në vend të atij të diturit; 3. Kur e vendos udhëheqës jomeritorin."

Të nderuar, të gjithë ju që merreni me arsimimin dhe edukimin e shoqërisë, jeni të privilegjuar e të veçuar dhe, njëkohësisht, të ngarkuar me një përgjegjësi të madhe.

I dashur udhërrëfyes, edukimi dhe arsimimi i brezit të ri është një ndër amanetet më të mëdha që i është besuar njeriut në shoqëri. Andaj, ky amanet duhet ruajtur si sytë e ballit. Dituria më e madhe që mund t'u përcillet nxënësve, studentëve, është morali i lartë dhe vlerat e tij.

Kujdes, para se të jesh një mësues apo profesor, bëhu njeri i moralshëm. Mësuesi i njerëzimit, Muhamedi (a. s.): "Zoti më ka dërguar mësues, që t'ju përmirësoj njerëzve moralin." E, morali i besimtarit,



është vetë fetaria e tij: bëhuni fetarë të denjë, që të jeni të moralshëm!

Kjo porosi vlen për të gjithë individët që qeverisin me institucione të caktuara, duke filluar nga institucioni më i shenjtë, që është familja, pastaj: shkolla, xhamia dhe qeverisja shtetërore.

## TË MËSOJMË PESHKIMIN

Ka një thënie të urtë për udhërrëfyesin, ku thuhet me sa vijon: "Në qoftë se e gostit një njeri me peshk, dije se e ke ushqyer vetëm për një ditë; ndërkaq, në qoftë se e mëson që të peshkojë, dije se ti e ke ushqyer për tërë jetën." Andaj, të nesërmen dije se terapia më e mirë për ta relaxuar (qetësuar) shpirtin tënd, dije se është kur e takon nxënësin apo studentin në ditë pune duke praktikuar mësimin tënd.

Edukimi e mund natyrën, për arsye se e paston zemrën e njeriut nga veset dhe e mbush me veti të mira. "Mësimdhënia e mirë duhet të jetë mjaftueshëm e ngadaltë, që të mos jetë konfuze dhe mjaftueshëm e shpejtë, sa të mos jetë e mërzitshme." (Sidney J. Harris)

Obligimi ynë është ta ndërtojmë një ardhmëri të shëndetshme dhe ta duam atë, sepse ardhmëria është pjesë e jetës së shëndetshme dhe të një jete të suksesshme. Në rast se ndërtohet brezi i ri i tillë, nuk ka dyshim se frytet do t'i jetësojmë edhe ne së bashku me ta. Allahu i dhashtë mundësi dhe shëndet e të ardhme të suksesshme rinisë.

Për të qenë një trup i kompletuar, nuk

ka dyshim se ai përbëhet prej një shpirti të shëndetshëm.

E, një rini e kompletuar, është begatia më e çmueshme e një shoqërie të shëndoshë në momentin kur ajo jetën e përcjell me parime fetare dhe kombëtare.

Feja dhe kombi pa një rini të shëndoshë, nuk mund të ketë një perspektivë të ngritur. Pra, rinia lirisht mund të themi, simbolizon agimin e një epoke të vlefshme, apo agimin e diellit, që çdo mëngjes ngjall shpresat dhe nxit buzëqeshjet për një ditë më të mirë se ajo e djeshmja.

Kështu që, nga çdo gjeneratë e re lind një shpresë e re për ndryshime të reja. E, për t'i shijuar të mirat tona ne si rini, kemi vetëm një kusht: që mos t'i harrojmë mësuesit, prindërit, profesorët tanë, sepse - të lutesh për tjetrin dhe t'u gëzohesh të arriturave të të tjerëve, dije se melaqet luten për ty, që Zoti të na pajis me të mira nga mirësitë e Tij.

Amr ibni Shuejbi (r. a.) e ka dëgjuar gjyshin e tij duke thënë: "Hazreti Xhibrili (a. s.) ishte shumë i gëzuar kur zbriti dhe i solli këtë lutje nga qielli Pejgamberit (s.a.v.s.). Ai lutej kështu dhe ne i bashkëngjitemi kësaj lutje: 'O Ti që shfaq të bukurën dhe mbulon të shëmtuarën! O Ti që nuk e kap gjynahqarin dhe nuk e zbulon atë. O Toleruesi më i mirë! O Falës i madh! O Mëshiruesi krahëhapur! O Shoqëruesi i çdo pëshpëritjeje! O Pikëdorëzimi i çdo ankese! O Bujar në falje! O i Madhërishtëm në mirësi! O Nismëtari i bekimeve, përpara se ato të përcaktohen. O Zoti ynë! O Udhëheqësi ynë! O Miku ynë! O Kulmi i dëshirave tona. Të kërkoj, o Allah, të mos ma djegësh trupin me zjarr!'"

Andaj, o Krijuesi ynë, lutemi për prindërit, për mësuesit, për hoxhallarët, për profesorët - udhërrëfyesit tanë, prej kudo qofshin, gjallë qofshin ose që kanë kaluar nga kjo botë, që të lëshosh rahmetin tënd në këto ditë të bekuara me të reshura shiu për personalitetet e lartpërmendura!

**Ja Rrabi, pranoji lutjet tona.**

**Ja Rrabi, Amin.**

**(Autori është hoxhë në Grupçin, komuna e Zhelinës, Tetovë. Në bashkëpunim)**

# PËRSE NUK NA FLASIN PËR LUMTURINË NË VARR?

Përse nuk na flasim për lumturinë në varr? Përse askush nuk na flet për atë se dita më e bukur do të jetë dita e takimit me Zotin tonë? Përse nuk na thonë se kur do të vdesim, do të jemi në duart e më të Mëshirshimit të mëshiruesve? Në duart e Atij që është më i mëshirshëm ndaj njeriut se nëna e tij...

Përse mendojmë se Zoti ynë vetëm se do të dënojë? Përse nuk mendojmë se Zoti do të mëshirojë? Përse nuk na flasim për gjendjen e besimtarëve të devotshëm në varret e tyre? Që të nxitojmë të bëhemi prej tyre... Përse nuk na thonë për njeriun besimtar me moral të mirë se do t'u përgjigjet pyetjeve të Munkerit dhe të Nekirit në varr?

Ka ndonjë mysliman që është mëkatar, por ai nuk është mohues i Zotit e as i larguar nga mëshira e Allahut. I dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: "Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im: Allahu do të falë aq shumë në Ditën e Gjykimit, saqë edhe Iblisi do të zgjatet për ta përfshirë edhe atë falja..." Që do të thotë se Zoti ynë do të falë aq shumë, saqë edhe Iblisi do të shpresojë që ta falë edhe atë.

Dhe, e pyesin atë për gjendjen e të gjallëve... Dhe, vjen njëri prej tyre dhe thotë: "Lëreni atë, sepse ai ka qenë në vështirësitë e dynjasë." Vdekja është rehati nga vështirësitë dhe lodhjet e dynjasë. Vdekja për besimtarët e mirë është rehati.



Prandaj, ne jemi të obliguar që të lutemi: 'O Allah, na e bëj vdekjen tonë rehati për ne nga çdo e keqe.'

Dhe, fillon që t'i lutet Zotit me përgjërime: 'O Zot, bëje Kiametin; o Zot, bëje Kiametin!' Që të sigurohet dhe të shkojë në Xhenetin e tij. Përse nuk na thonë se vepra jonë e mirë nuk do të ndahet prej nesh - që të na shoqërojë neve, për të mos na lënë në vetmi.

Zoti ynë do të thotë: "E ka thënë të vërtetën rob i mi! Prandaj, shtrojeni varrin e tij prej Xheneti, ushqejeni nga Xheneti dhe hapni një derë për të për në Xhenet, që t'i vijë nga aroma dhe bukuria e tij, që ta shikojë vendin e tij në Xhenet..."

Edhe pse ne kemi mangësitë tona, Zoti ynë është i Mëshirshëm ndaj nesh. Por, kjo nuk do të thotë që ne mos t'i

kryejmë obligimet tona ndaj Zotit tonë: O Allah, bëje më të mirën e veprave tona që të jenë veprat tona të fundit; dhe më të mirën e jetëve tona, fundin e tyre; dhe ditën tonë më të mirë, ditën që do të takohemi me Ty.

Çdonjëri do të hyjë në Xhenet nga dera e veprës me të cilën ka qenë i dalluar. Do të ketë prej tyre që do të thirret nga një derë dhe do të ketë që do të thirret nga dy dera. Dhe, do të ketë prej atyre që do të thirren nga tetë dera të Xhenetit. Ebu Bekri do të thirret nga të gjitha dyert e Xhenetit.

Dyert janë të mbyllura... Do të dalë mes njerëzve zotëriu ynë, Muhamedi (a. s.) dhe do të trokasë në derë dhe do t'ia kthejë Roja e Xhenetit, Ridvani: 'Kush jeni ju?' Pejgamberi do të përgjigjet me gjithë modestinë dhe do të thotë: 'Unë jam Muhamedi.' Ndërsa engjëlli thotë: 'Jam urdhëruar që mos t'ia hap askujt para teje dhe pastaj dyert do të hapen!'

Papritur, njerëzit do të tubohen para Zotit të tyre të Lartmadhëruar. Jobesimtarët janë dërguar në zjarr; gjithashtu edhe hipokritët dhe tani më nuk ka ngelur pos besimtarëve të sinqertë. Llogaria ka mbaruar dhe ka ngelur vetëm që engjëjt t'i dërgojnë në Xhenet, gjerësia e të cilit është sa toka e qiejt...

**(Autor: Mahmijid el-Mahmijid; përkthyer nga gjuha arabe: Muhamed Sadiku/në bashkëpunim)**

## ÇFARË NDËRTOI ARKITEKT SINANI

Sinani, arkitekti i madh shqiptar (1489-1588) në Perandorinë Osmane, i njohur si Mimar Sinan a si Koca Mi'mâr Sinân Âgâ, gjatë jetës së tij ndërtoi 374 ndërtesa, 92 xhami të mëdha, 50 mesxhide, 62 medrese, 19 mauzole, 17 kuzhina publike, 3 spitale, 10 ura, 20 karvansaraje, 36 pallate, 48 hammame dhe 7 ujësjellës. Kryevepra e tij është Xhamia Selimiye, Edrene (turq. Edirne), e ndërtuar në vitin 1522. (Ahmet Dermalal/në bashkëpunim: F.1.01.2023)



# NJË SPITAL PËR SUDANIN

**Qe disa vjet ka vdekur dr. Zekijudin Ahmed Husejn. Të Allahut (xh. sh.) jemi dhe tek Ai do të kthehemi. O Allah, bëje këtë mjek prej atyre për të cilët ke thënë: "E, sa i bukur është shpërblimi i punëbërësve."**

**Nga Adil Shuvejeh**

Në vitet 70-të një grua e moshuar, në Kartum, e kishte kapur barkun e vet dhe rënkonte. Këto rënkime ishin pretekst për ndërtimin e spitalit "Ibn Sina", spitali më i madh në Kartum (Khartum).

Kjo e moshuar japoneze ishte bashkëshortja e Ambasadorit të Japonisë dhe e bija e Perandorit Japonez.

Duke qenë se ishte grua e Ambasadorit, ata kërkuar ndihmë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe kjo ministri i kishte orientuar për shërim te Spitali Detar.

Ambasadori kishte vendosur që ndihmën e parë t'i jepte spitalit më të afërt, por aty gjetën një papastërti të madhe, saqë muret ishin mbuluar me mbeturina, toka ishte e pistë dhe e mbytur nga një erë kundërmuese.

Njeriu ishte shqetësuar dhe kërkonte nga mjekët që ta qetësonin bashkëshorten e tij dhe t'ia ndalnin dhimbjet asaj, në mënyrë që të mund ta dërgonte për shërim jashtë Sudanit.

Doktori Zekijuddin Ahmed Husejn e shikoi burrin dhe me qetësi i tha: Kësaj gruaje i kanë mbetur vetëm edhe dy orë për ta operuar, ose për të vdekur...

Ndoshta paniku dhe dëshpërimi ishin shkaktarët që e çuan Ambasadorin të konsultohet me bashkëshorten e tij rreth asaj se çka të bënin.

Ndërkaq, bashkëshortja i tha: Po, dua që t'i nënshtrohem operacionit në këtë spital!

Pas vendimit të përbashkët, dr. Zekijudini e kreu operimin me mjete mjekësore shumë të thjeshta, ndërsa Ambasadori priste që të dëgjonte lajmet dhe t'i kumtohej rezultati i operimit!

Realisht, ai priste që të merrte lajmin e vdekjes së bashkëshortes së tij.

Kaluan disa orë, kaloi një ditë, kaluan dy ditë dhe...

Përkundrazi, bashkëshortja u lirua nga spitali dhe doli duke ecur në këmbët



e veta!

Ambasadori, ndërkaq, me të marrë bashkëshorten e vet nga spitali, pa u hamendur fare, bashkë, udhëtuan për në Japoni.

Prej aeroportit, në Japoni, shkuan drejt e në spitalin më të njohur japonez, ngase ajo ishte e bija e Perandorit të Japonisë.

Me t'u shtruar në spital, ajo iu nënshtroi shumë testeve dhe analizave mjekësore, për të parë gjendjen shëndetësore dhe për të parë gjendjen e operimit të saj.

Pas disa orë analizash, testesh dhe kontrollësh nga ekspertët me të mëdhenj të mjekësisë japoneze, një grup mjekësh iu drejtuan Ambasadorit, duke i thënë: Ku është kryer ky operim dhe kush e ka kryer atë?

Ambasadori tha: Në një vend të quajtur Sudan dhe nga një mjek i quajtur Zekijudini. Pse, çfarë ka ngjarë?

Ata, ndërkaq, i thanë: Ky mjek është një mrekulli! Andaj, nuk do të lëmë asnjë mundësi, përveç se do ta ftojme për ta parë këtë mjek!

Ftesa për dr. Zekijudinin, që të udhëtonte për në Japoni, erdhi nga vetë Perandori Japonez.

Kur ai udhëtoi atje, e pyetën: Çka dëshiron? Kërko çfarëdo që të duash!

Dhe, ndodhi çudia: mjeku nuk kërkoi asgjë për veten e vet! Përkundrazi, ai tha:

Kërkoj një spital për Sudanin!

Ai kishte kërkuar ndërtimin e një spitali modern për vendlindjen e tij, për Sudanin.

Nga mesi i viteve 70-të dhe fillimi i viteve 80-të japonezët e ndërtuan në Sudan spitalin e kërkuar nga dr. Zekijudini-i.

Është ky spitali i njohur "Ibn Sina", një spital me pajisjet më moderne dhe me mundësi renovimi për çdo vit.

Qe disa vjet ka vdekur dr. Zekijudin Ahmed Husejn. Të Allahut (xh. sh.) jemi dhe tek Ai do të kthehemi.

O Allah, bëje këtë vepër të tij prej vepërave të sinqerta, pranoje atë prej tij dhe ruaji pasardhësit e tij. O Allah, bëje këtë mjek prej atyre për të cilët ke thënë: "E, sa i bukur është shpërblimi i punëbërësve."

Shpërndajeni këtë në shenjë respekti për këtë mjek, që ishte aq i njerëzishëm dhe aq atdhedashës dhe i cili nuk kishte menduar për veten e tij e as që kishte menduar për interesat e tij personale, por u tregua shumë më i madh se egoja e tij, duke u treguar po aq i madh sa edhe vetë hapësira e vendlindjes së tij, e betimit të tij mjekësor dhe e përgjegjësisë së tij prej doktori.

Burimi: <http://www.alnilin.com/12733129.htm>

**Përktheu: Mr. Artan Musliu**

# HOXHA, MËSUESI, POETI REXHEP UKALLI

Rexhep Ukalli u lind me 25 maj 1949 në fshatin Sërbicë të Kërçovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Në vitet 1964-69 kryen Medresenë Alaiddin në Prishtinë. Më 1970-71 kryen Shkollën Normale në Gjakovë.

Në vitin 1972 punësohet arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqipe në fshatrat Dragash dhe Brod të Kosovës. Prej vitit 1976 vazhdon punën si arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollën fillore "Faik Konica" të fshatit Radushë (Shkup).

Në vitin 2013, pas 37 vjet përvojë pune si arsimtar, pensionohet. Në vitin 2015 ndërrohet jetë.

Prej kohës kur ishte medresant dhe deri në ditët e fundit të jetës merrej me shkrime, kështu që ka shkruar shumë poezi dhe proza.

Gjatë kohës kur kryente Normalen e Gjakovës ishte pjesë e redaksisë së revistave letrare "Jeta e Re" (Prishtinë) dhe "Jehona" (Shkup). Gjithashtu, botoi poezi, proza dhe shkrime të tjera në gazetatat për fëmijë "Fatosi" dhe "Gëzimi" (Shkup) dhe në gazetatat e përditshme "Rilindja", "Flaka e vëllazërimit", "Koha", "Lajm", në revistën "Tribuna-SH" etj.

Poezitë e tij u botuan edhe në përmledhjen me poezi "Flaka e Janarit".

Ka lënë në dorëshkrim Ditarin e jetës, të shkruar çdo ditë, mbi 40 vjet. Aty, gjithashtu, ka të shënuara shumë poezi me tema patriotike, fetare dhe shoqërore, të cilat shpresojmë se një ditë do të botohen dhe do të jenë në duart e lexuesve.

Vlen të theksohet se edhe pse punoi si arsimtar i gjuhës shqipe, ai asnjëherë nuk

## "RADUSHASOT": KUJTOJMË ZOTNI REXHEPIN...

Zoti e pastë mëshiruar zotni Rexhepin (Ukalli), arsimtar në shkollën fillore "Faik Konica" në Radushë. Orët e tij ishin të mbushura me këshilla jete, me shaka të ndryshme, me edukim të mirëfilltë. Te nxënësit ai mbolli dashurinë për fe e atdhe.

Nxënësit mezi e prisnin ditën e xhuma, që mësues Rexhepi t'u mbajë ca minuta ders, me këshilla jete e pune, të cilat i dilnin nga thellësia e zemrës. Fjalët e tij niseshin nga dashuria për nxënësit. Zoti t'ia shpërblejë mundin. Amin.

u largua nga profesioni i hoxhës, kështu që si hoxhë u priu besimtarëve në mbi 50 xhami.

Gjatë zhillimit të mësimin, sidomos ditëve të premte, mbante ligjëratat të shkurttra për nxënësit rreth fese islame, motiv ky që nxiti shumë të rinj që t'i përkushtohen fesë, duke falur namaz rregullisht dhe me shkollim në medrese.

## Vdesim pak nga pak

Sa shpejt kalon nata,  
Dita ik me vrap.  
Na shkurttohet jeta,  
Vdesim pak nga pak...

Syri na verbohet,  
Dora shumë dobësohet.  
Këmbët ngatërrohen,  
E ne, në rrafsh pengohemi.

Me kalimin e një dite,  
Netët plot me ëndrra.

Vështirësitë na rëndojnë,  
Bëhemi të tjerë, kur vitet kalojnë.

Ka pak kënaqësi,  
Festojmë ditëlindjet,  
Vitet na shkurtohen  
Ndërsa dikush, shumë gëzohet.

Fare nuk kujtohet,  
Njeriu i ngratë.  
Se çdo ditë e çdo natë  
Vdesim pak nga pak.



Nga Ditari i jetës shihet shumë përkushtimi ndaj fesë, me falënderime të shumta drejtuar Allahut të madhërishtëm për atë që na e ka falur këtë fe të pastër dhe të vërtetë. Gjithashtu, vlen të theksohet edhe ky fakt: kur e përshkruan udhëheqjen e besimtarëve në namaz, si imam, shpreh kënaqësi të papërshkrueshme me fjalë.

Rexhep Ukalli jetoi dhe veproi krenar me misionin e caktuar si mësues dhe hoxhë në të njëjtën kohë.

**(Blerim Ukalli/HeR)**

# SAHATI I ELBASANIT...

Sahati i Elbasanit është ndërtuar në vitin 1899. U qëndroi pa probleme dy luftërave botërore, ndërsa katër vendet ku tregohet ora u shkatërruan nga plumbat në vitin 1997.

Një skenë dëmtimi, që besoj ka qenë e para, kam parë edhe vetë teksa një i lajthitur zbriti nga makina dhe qëllonte me pasion të madh me kallashnikov. Shkëlqente nga gëzimi për krimin që po bënte.

Fushat e orës mund të jenë goditur edhe në ditë të ndryshme nga drejtime të tjera.

Disa muaj pas ngjarjes, Kryetari i Bashkisë, i ndjeri Engjëll Dakli, porositi jashtë shtetit fushat e orës që shohim sot.

Dëmet që i janë sjellë trashëgimisë sonë kulturore nga injoranca, kalojnë edhe ato të luftërave.

(Kastriot Dervishi/në bashkëpunim: F.6.01.2023)



# RËNDËSIA DHE DISPOZITAT E BESMELES

**Allahu (xh. sh.) është shumë i mëshirshëm jo vetëm mbi ata të cilët e besojnë, por edhe mbi ata që nuk e besojnë dhe nuk e adhurojnë. Allahu (xh. sh.) emërohet me Er-Rrahman sepse ai është i mëshirshëm në këtë botë edhe për besimtarin, edhe për jobesimtarin.**

**Në këtë botë Ai i furnizon edhe besimtarët edhe mosbesimtarët, kurse në Ditën e Gjykimit më Allahu (xh. sh.) nuk është, por atë ditë Ai është mëshirues vetëm për besimtarët dhe falës i gabimeve të tyre.**



**Shkruan: mr. Muzemil Osmani**

Se sa është e rëndësishme *Besmelja* në jetën e përditshme, flasin vetë hadithet e Muhamedit (a. s.). Nga ana tjetër, *Besmelja* është edhe ajet kuranor, që jep të kuptojmë vlerën e këtij ajeti.

Në vazhdim do t'i paraqesim disa hadithe të Muhamedit (a. s.) në lidhje me rëndësinë e *Besmeles*. Transmeton ibn Abasi prej Omerit (r. a.), se ai e ka pyetur Pejgamberin (a. s.) për *Besmelën* e ai ka thënë: "Ai është emër prej emrave të Allahut (xh. sh.) dhe se nuk ekziston në mes këtij emri dhe emrit të

*madh të Allahut (xh. sh.) largësi sikur e bardha e syrit me të zezën.*"<sup>1</sup>

Në një hadith tjetër Muhamedi (a. s.) në lidhje me *Besmelën* ka thënë: "Mos thuaj 'ju mjerofte shejtani', sepse kur ti thua: 'ju mjerofte shejtani', ai fryhet dhe thotë: 'Me fuqinë time e mposhta.' E nëse ti thua: 'Bismilahi', ai zvogëlohet, aq sa bëhet sa një mizë."<sup>2</sup>

Vekkii, me zinxhirin e tij të transmetuesve, transmeton nga ibn Mesudi, i cili ka thënë: "Kush dëshiron që Allahu (xh. sh.) ta ruajë nga nëntëmbëdhjetë zebanijtë (ruajtësit e

*xhehenemit), le të lexojë Besmelën, kurse Allahu (xh. sh.) çdo shkronjë do ta bëjë mbrojtëse prej tyre. Këtë e thonë edhe Ibn Attije dhe El-Kurtubi.*"<sup>3</sup>

Pra, çdo send kur e fillon me *Besmele*, ndihma e Allahut (xh. sh.) nuk të mungon asnjëherë. Kjo është edhe një mëshirë e Tij, të cilën na e mësoi që kur të fillojmë ndonjë punë ose aktivitet, të fillojmë me emrin e Tij, pra me *Bismilahi*. P. sh., kur të hamë ushqim - siç është hadithi i Muhamedit (a. s.), i cili i tha Omer ibn Ebi Selemes "Thuaj *Bismilahi*. Ha me dorën e djathtë dhe ha

*para vetes*".<sup>4</sup> Edhe kur bashkëshortët të kenë marrëdhënie intime, duhet përmendur emrin e Allahut (xh. sh.). Transmetohet hadithi i Muhamedit (a. s.), i cili ka thënë: "Kur dikush dëshiron t'i afrohet gruas së tij, le të lexojë *Besmelën* dhe le të thotë: 'O Zot im, largoje prej nesh shejtanin e mallkuar, edhe nga ai që do të na e japësh; e nëse lind fëmijë, shejtani atë asnjëherë nuk do të mund ta dëmtojë.'"<sup>5</sup>

Pra, duke i analizuar thëniet e Muhamedit (a. s.), që kanë të bëjnë kryesisht me rëndësinë e *Besmeles* në jetën tonë të përditshme, lirisht mund të themi se "*Bismilahi*" është arma më e fuqishme e besimtarit.

## BESMELJA, AJET KURANOR OSE JO

Në fillim të shumë tefsireve, e sidomos në ata klasikë, bëhet fjalë mbi *Besmelën*, e cila zë vend të rëndësishëm në ndarjen formale të Kuranit. Këtu në rend të parë do të flitet mbi atë se a është kjo pjesë integrale e tekstit kuranor, apo kemi të bëjmë me tekst të themeluar me hadithe të Muhamedit (a. s.), ose me praktikën e jetës së hershme të bashkësisë islame në Mekë dhe në Medinë.

Të gjithë dijetarët islamë janë të mendimit se *Besmelja* është ajet kuranor në suren En-Neml:

﴿هُوَ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِإِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ  
"Kjo është prej Sulejmanit, në emër të Allahut, Mëshiruesit të përgjithshëm, Mëshirbërësit të veçantë".<sup>6</sup>

Por, ata nuk janë të një mendimi se a është ky ajet i pavarur në fillim të çdo sureje, apo është shkruar në fillim të çdo sure si ajet i parë, ose është vetëm pjesë e sures *Fatiha*, apo është e shkruar vetëm për ndarjen e sureve.<sup>7</sup>

Dijetarët islamë rreth kësaj çështjeje janë ndarë në disa mendime:

1.1. Është ajet i 'Fatihasë' dhe i çdo sureje tjetër. Të këtij mendimi janë: A'ta bin Tavus, Seid ibn Xhubejri, Imam Shafiu, Is'haku etj.

1.2. Nuk është ajet i 'Fatihasë' e as i ndonjë sureje tjetër. Të këtij mendimi janë: Imam Maliku dhe shokët e tij.

1.3. Është ajet i plotë kuranor, ka zbritur për ndarjen e sureve dhe nuk është ajet i 'Fatihasë' e as i çdo sureje tjetër. Ky është mendimi i Ebu Hanifes.

### Argumentet e shafive:

a) Hadithi i Ibn Abbasit (r. a.), se Muhamedi (a. s.) e ka filluar namazin me *Bismillahi*.

b) Është pyetur Enes ibn Maliku

për leximin e *Besmeles* nga Muhamedi (a. s.), e ai ka thënë: Leximi i saj ka qenë i zgjatur. E lexoi *Besmelën*, duke e zgjatur fjalën "bismilahi"; e zgjati emrin "Er-Rrahman" dhe e zgjati emrin "Er-Rahim".<sup>9</sup>

c) Ndërsa njëri ndër dijetarët më të njohur të tefsirit, imam Es-Sujuti, mendon se çdo *Besmele* në Kuran është Kuran, përkatësisht është pjesë e Shpalljes. Rregulli i tij është: "Nuk ka kontest se krejt çka është nga Kurani, patjetër duhet të transmetohet me besnikëri si për nga tërësia e vet, ashtu edhe për nga pjesët. Ajo që *Besmelja* shpesh përsëritet, nuk është argument se karakteri i saj është jokuranor. Përkundrazi, ekzistojnë mjaft ajete në Kuran që përsëriten, si p sh. ( *فَبِأَيِّ آيَاتٍ رَبِّكُمَا تُكذِّبَانِ* ) e askush nuk e parashtron pyetjen e autenticitetit të saj. Sujuti gjithashtu i hedh poshtë edhe mendimet se *Besmelja* është për ndarjen e sureve, sepse atëherë është dashtë që të shkruhet edhe në fillim të sures *El-Bera*. Argumenti më i fortë i tij është hadithi, të cilin e transmeton Ummi Selemja, se pejgamberi i Zotit e ka kënduar *Besmelën* dhe 'Fatihanë'.<sup>10</sup>

### Argumentet e malikive:

a) Hadithi i Aishes (r. a.) që ka thënë: "Muhamedi (a. s.) e fillonte namazin me tekbir dhe leximin me *الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ*"<sup>11</sup>

b) Gjithashtu, për argument marrin edhe transmetimin që e shënojnë Buhariu dhe Muslimi në Sahihët e tyre, të përcjellë prej Enes ibn Malik-ut, i cili thotë: 'Jam falur pas Muhamedit (a. s.), Ebu Bekrit, Omerit dhe Othmanit (r. a.) dhe ata e fillonin namazin me

*الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ*

### Argumentet e hanefive:

a) Hanefitë janë të mendimit se shkrimi i *Besmeles* në Mus'haf, vërteton se është Kuran, mirëpo nuk do të thotë se është ajet i çdo sureje, por sipas hanefive *Besmelja* është ajet që ka zbritur për ndarjen e sureve.

b) Prej argumenteve të tyre është hadithi të cilin e transmeton Ibn Abbasi, se Muhamedi (a. s.) nuk dinte ndarjen e sureve deri sa zbriste *Bismillahi*.

c) Po ashtu, prej argumenteve që e përforcojnë mendimin e tyre është thënia e sahabëve: "Nuk dinim mbarimin e sures derisa zbriste *Bismillahi*".<sup>14</sup>

### Konkluzion:

Por, mendimi më i vërtetë sipas Ibn Kethirit, në bazë të argumenteve të tyre, është mendimi i imam Ebu-Hanifes dhe pasuesve të tij, se

*Besmelja* është ajet i veçantë që ka zbritur për ndarjen e sureve që tregojnë fillimin dhe përfundimin e tyre.

## KOMENTI I BESMELES

Gjatë kohës sa ishte gjallë i dërguari i Allahut, për çdo problem që paraqitej tek as'habët lidhur me kuptimin e drejtë të ndonjë ajeti mbi baza juridike, ata menjëherë i drejtoheshin atij dhe i dërguari i Allahut i udhëzonte dhe ua sqaronte, gjithnjë duke u bazuar në atë që i shpallej nga Kurani, kështu që keqinterpretimet e mundshme eventuale të ndonjë çështjeje të fikhut zhdukeshin që në nismë. Por, kjo gjë ndryshoi pas vdekjes së Resulullahut (s.a.v.s.), kështu që kur myslimanët ballafaqoheshin me ndonjë problem paksa më të ndërlikuar, u ktheheshin ajeteve kuranore dhe Synetit të Resulullahut dhe bënë analogji racionale nga ana e tyre. Kështu, u paraqit nevoja që të komentojnë Kuranin për disa arsye:

a) Tregimi i vlerës dhe rëndësisë së Zbritësit të Kuranit, sepse ai ka mundësi që në një vend të mbledhë shumë shprehje dhe fjali me kuptime të shumta, dhe ndoshta kjo e ndërlikon kuptimin e qëllimit të asaj për çka flet, dhe me komentim zbulohet qëllimi i atyre shprehjeve me kuptim të lartë dhe zbulohet qëllimi real, dhe të nxirret në shesh qëllimi i fshehtë.

b) Mund të ndodhë që ajeti të jetë i përgjithshëm dhe aty të mos cekën shumë kushte për një gjë dhe në këtë formë të mos jetë i qartë dhe për këtë shkak kemi nevojë për komentim që të vendosen kushtet dhe sqarimet e nevojshme për t'u kuptuar lehtë.

c) Shprehjet mund të kenë kuptime të shumta, mund të ngërthejnë në vete shumë kuptime dhe se me cilin kuptim është përdorur në ajet, mund ta kuptojmë përmes komentimit, gjëra të cilat do të bënin që njerëzit të bien në gabime të mëdha.

d) Kurani famëlartë, me porositet e tij universale, do të hapë shtigje të reja që njeriu të përsoset me njohuri moderne dhe të gjithë ato t'i vëndoje në shërbim të Islamit. Është më se e vërtetë se çdo kush që i qaset studimit të Kuranit, do të zbulojë thesarë të madhë dhe do të arrijë të kuptojë të vërtetën.

## DOMETHËNIA E "بِسْمِ"

Çdo send kur e fillon me emrin e Zotit, ndihma e Zotit është pranë teje. Prej mëshirës së Allahut (xh. sh.) që fali mbi njerëzimin, është se Ai na mësoi neve se çdo gjë duhet të fillojmë me emrin e Tij. Muhamedi (a. s.) në një

hadith të tij thotë: “Çdo punë e njeriut që nuk fillon me emrin e Allahut, ajo punë është e kotë.”<sup>15</sup> Nëse nuk e fillojmë punën tonë me emrin e Zotit, ajo çon në tirani, që jep të kuptojmë se “ti e ke nënshtruar gjithçka që ekziston në gjithësi”.

Lexuesi kur të thotë: باسم الله, do të thotë: Lexoj duke kërkuar ndihmë në emër të Allahut; ngrënësi kur thotë: باسم الله, do të thotë ‘ushqehem duke kërkuar ndihmë në emër të Allahut (xh. sh.)’ e kështu me radhë.

Èshtë emër i nxjerrë nga (بسمو), që nënkupton: ngritje, lartësim. Kurse disa dijetarë janë të mendimit se është nxjerrë prej fjalës (السمعة), por më i vërtetë është mendimi i parë.<sup>16</sup>

#### Emri “Allah”

(الله) Fjala e madhërueshme Allah është njëri nga emrat e bukur të Tij. Me këtë emër thirret vetëm i adhuruari me të drejtë, që është Zoti, ekzistenca e të Cilit është e domosdoshme. Allah nuk quhet tjetërkush, veç Zotit të vërtetë. Kur themi Allah, na vjen ndërmend vetja e Zotit, e pajisur me të gjitha vetitë e plota që janë të meritueshme për madhërinë e Tij dhe pa asnjë të metë.<sup>17</sup>

(الله) Emër i Dhatit të shenjtë, e që është vaxhibul vuxhud. Ibn Kethiri thotë (الله): “Është emër i përveçëm për Zotin e Madhërishtëm. Thuhet se ky është emri më i madh i Tij, sepse cilësohet me të gjitha cilësitë.” Mandej ka thënë: “Ky është emër me të cilin nuk është emërtuar askush tjetër përpos Tij.”<sup>18</sup>

Emri Allah është emër që i përmbledh të gjitha cilësitë e Zotit, ngase punët në përgjithësi kërkojnë cilësi të shumta. Kur fillojmë me ndonjë punë, ne kemi nevojë për ndihmë, për fuqi, për mëshirë etj. Emri Allah në Kuran përmendet 2.697 herë. Komentuesi i Kuranit, Ibn Kethiri, në Tefsirin e tij në lidhje me këtë thotë: “Emri Allah është emër i veçantë i Allahut (xh. sh.) dhe thuhet se është emri më i madh i Tij.”<sup>19</sup>

Allahu (xh. sh.) në Kuranin famëlartë thotë: “Ai është Allahu që nuk ka Zot tjetër përveç Tij, vetëm ai që e di të fshehtën dhe të dukshmen. Ai është Mëshiruesi, Mëshirbërësi. Ai është Allahu që nuk ka Zot tjetër përveç Tij, Sundues i Përgjithshëm, i Pastër (prej të metave që i vishen), Shpëtimtar (që i shpëton njerëzit prej ndëshkimit të padrejtë), Sigurues (që siguroi njerëzit me premtimin e Tij dhe peygamberët me mrekullitë mbikëqyrëse, që mbikëqyr dhe përcjell çdo send), i Plotfuqishëm, Mbizotëruer, i Madhërishtëm; i

lartësuar është Allahu nga çka i shoqërojnë. Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Të Tij janë emrat më të bukur, Atë (Allahun) e madhërojnë çka ka në qiej e në tokë dhe Ai është ngadhënyesi, i urti.”<sup>20</sup>

Emir Allah është emër që i përmbledh të gjitha Cilësitë e Allahut (xh. sh.) dhe kur përmendim emrin Allah, përveç se besimit që kemi në një Zot, shprehim besimin se vetëm Atë e adhurojmë dhe vetëm Atë e respektojmë.

Për emrin më të lavdëruar të Allahut flasin edhe hadithet e Muhamedit (a. s.), i cili ka thënë: “Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra, pra një më pak se njëqind. E kush i kupton dhe punon sipas tyre, do të hyjë në xhenet.”<sup>21</sup>

Se a është ky emër i nxjerrë apo jo, dijetarët islamë janë në mospajtime dhe janë ndarë në dy grupe:

**Grupi i parë:** janë të mendimit se emri është nxjerrë nga الإلهة që do të thotë: Adhurim.

**Grupi i dytë:** janë të mendimit se ky emër nuk është i nxjerrë; të këtij mendimi janë shumica e gramatikanëve dhe thonë se është emër i përveçëm, që përdoret vetëm për Allahun.

#### DOMETHËNIA E EMRAVE (الرحمان الرحيم)

Emrat (الرحمان الرحيم) Mëshiruesi, Mëshirbërësi, nxirren nga folja (الرحمة)-që do të thotë mëshirë. Emri Er-Rrahman është më stërmadh se emri Er-Rahim.<sup>22</sup>

Fahri Razi thotë se fjala Rahmetu do të thotë t’u japësh nevojatarëve të gjitha llojet e të mirave dhe t’i shpëtosh ata nga çdo lloj pësimi. Pra, ai që ka një fije mendje, nuk dyshon aspak se Allahu me madhërinë e vet i dhuron të mira njeriut qysh në barkun e nënës e deri sa të vdesë dhe e ruan atë prej sëmundjeve e vuajtjeve. Prandaj, ai e falënderon vetëm Allahun (xh. sh.).<sup>23</sup>

Pra, emri (الرحمان) është në formën Mubalegatun që d.m.th. se është më gjithëpërfshirës dhe i përfshin të gjitha llojet e mëshirës. Këtë e argumenton edhe transmetimi i Tirmidhiut, për të cilin thotë se është sahih, nga Abdullah b. Avfi (r. a.), i cili e ka dëgjuar të dërguarin e Allahut (s.a.v.s.), i cili ka thënë: Allahu i Lartmadhërishtëm thotë: “Unë jam i gjithëmëshirshëm. Kam krijuar lidhjet fisnore dhe u kam dhënë emrin sipas emrit tim. Kush i përmban, Unë do ta ruaj, ndërsa kush i ndërpret, do ta lëshoj nga mëshira ime” dhe pastaj (transmetuesi) thotë: Ky është tekst i cili argumenton se Er-Rrahman është më gjithëpërfshirës.<sup>24</sup>

Emri الرحمان që do të thotë se vetëm Allahu (xh. sh.) është mëshirues, i cili me mëshirën e tij i përfshin të gjitha krijesat, qoftë në furnizim, mëshirë, apo diçka tjetër, duke mos bërë dallim mes njerëzve, mes besimtarëve dhe jobesimtarëve. Emri Rahman është emër me të cilin emërtohet vetëm Zoti dhe me këtë emër nuk emërtohet ndonjë krijesë tjetër.<sup>25</sup> Në lidhje me këtë Allahu (xh. sh.) thotë në Kuranin famëlartë: “Thuaj: Thërrisni: Allah, ose thërrisni Er-Rrahman; me cilindo që të thërrisni (me këto dy emra), emrat e Tij janë të bukurit.”<sup>26</sup>

Ibn Xheriri thotë: Er-Rrahman (I Gjithëmëshirshmi) u referohet të gjitha krijesave, kurse Er-Rahim (Mëshiruesi) u referohet në veçanti besimtarëve.<sup>27</sup>

Lidhur me këtë disa kanë thënë: Për këtë shkak Allahu (xh. sh.) thotë:

ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ الرَّحْمَٰنُ

“.... e pastaj mbizotëroi Arshin. Ai është Mëshiruesi....”<sup>28</sup>

Gjithashtu në një ajet tjetër thotë:

لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُم بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ

“Juve ju erdhi i Dërguari nga lloji juaj; atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.”<sup>29</sup>

Po ashtu në një ajet tjetër thotë: نَبِيُّ عِبَادِي أَنِّي أَنَا الْغَفُورُ الرَّحِيمُ

“Njoftoji robërit e Mi se vërtet Unë jam Ai që fal shumë dhe mëshirues i madh.”<sup>30</sup>

Ibn Abbasi thotë: Këta janë dy emra të butë - njëri është më i butë se tjetri, përkatësisht është më i mëshirshëm.<sup>31</sup>

Ebu Sejjid el-Khudrij (r. a.) ka thënë: “I dërguari i Allahut ka thënë: Isa Ibn Merjem ka thënë: Rrahman është i Mëshirshmi vetëm në të ardhmen (ahiret), ashtu siç është në dynja, ndërsa Rahim është i Mëshirshmi në të ardhmen (vetëm në ahiret).”<sup>32</sup>

Ebu Ali el-Farisiju thotë: Er-Rrahman është emër i përgjithshëm, që i përfshin të gjitha llojet e mëshirës që janë veçori vetëm të Allahut (xh. sh.), ndërkaq Er-Rahim u referohet vetëm besimtarëve.<sup>33</sup>

Nga kjo nënkuptojmë se Zoti është Er-Rahim vetëm për myslimanët, ku Allahu thotë në Kuranin famëlartë: وَكَانَ بِالْمُؤْمِنِينَ رَحِيمًا

“....dhe Ai ndaj besimtarëve është shumë i mëshirues”<sup>34</sup> dhe është emër me të cilin mund të emërtohen edhe krijesat tjera.

Nisur nga kjo, disa dijetarë kanë pohuar se emri Er-Rrahman ka kuptimin e mëshirës së shtuar më tepër,



sepse i përfshin të gjitha krijesat në të dyja botët, ndërkaq emri Er-Rahim u dedikohet në veçanti besimtarëve.<sup>35</sup>

Pra, Allahu (xh. sh.) është shumë i mëshirshëm jo vetëm mbi ata të cilët e besojnë, por edhe mbi ata që nuk e besojnë dhe nuk e adhurojnë. Allahu (xh. sh.) emërohet me Er-Rrahman sepse ai është i mëshirshëm në këtë botë edhe për besimtarin, edhe për jobesimtarin.

Në këtë botë Ai i furnizon edhe besimtarët edhe mosbesimtarët, kurse në Ditën e Gjykimit më Allahu (xh. sh.) nuk është (الرحمان), por atë ditë Ai është (الرحيم) mëshirues vetëm për besimtarët dhe falës i gabimeve të tyre.<sup>36</sup>

Komentuesi ynë i njohur hafëz Ibrahim Dalliu, ndërkaq, në lidhje me emrat (الرحمان الرحيم) në tefsirin e tij “Ajka e kuptimeve të Kurani kerimit” jep një rregull: “Prej emrit Er-Rrahman dalin tre kuptime:

- 1) të shikosh nevojtarin,
- 2) të të zbutet zemra dhe
- 3) t’i japësh diçka e t’i kryesh atij nevojën që ka.

Pra, kur themi për Allahun se Ai është Er-Rrahman, duam të themi se Ai është që e sheh nevojtarin dhe që ia mbaron nevojën. Kuptimi i dytë i fjalës është zbutja e zemrës, por nuk na vjen

ndër mend aspak zemra, sepse e dimë që Zoti nuk është trup (xhism) që të ketë organe që u lipsen njerëzve. Zoti ynë nuk përngjet me askënd e me asgjë në përgjithësi, Ai nuk ka zemër që t’i zbutet, Ai nuk ka gjak që t’i ndizet e t’i vlojë, por dhembshuria e Tij është që t’i japë nevojtarit sa të dëshirojë e kur të dëshirojë dhe zemërimi i tij është të ndëshkohen fajtorët me aq sa e meritojnë. Pra, fjalët Er-Rrahman dhe Er-Rahim, që janë në shkallën sipërore, kanë kuptim: Allahu është shumë dhënës.<sup>37</sup>

<sup>1</sup> Nesimi Abdulxhemil, Dispensë për vitin II, fq. 11.

<sup>2</sup> Transmeton Ahmed ibn Hambeli në Musnedin e tij.

<sup>3</sup> Tefsiri i Ibn Kethirit –version i shkurtër nga Nesib er-Rifai, Sarajevë, fq. 30

<sup>4</sup> Transmeton Muslimi, vëll. III, fq. 1600.

<sup>5</sup> Tefsiri i Ibn Kethirit - version i shkurtër, Bashkim Aliu, fq. 53.

<sup>6</sup> Sure en Nemel, ajeti 31.

<sup>7</sup> Dalliu Ibrahim, Ajka e kuptimeve të Kurani kerim, fq. 18.

<sup>8</sup> Hadithin e transmeton Tirmidhiu.

<sup>9</sup> Transmeton Buhariu nga Enesi.

<sup>10</sup> Kariq Enes, Hyrje në shkencën e Tefsirit, fq. 103.

<sup>11</sup> Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

<sup>12</sup> Transmeton Tirmidhiu, 244.

<sup>13</sup> Transmeton Hakimi në Mustedrekin e tij.

<sup>14</sup> Transmeton Muslimi.

<sup>15</sup> Transmetojnë: Buhariu, Muslimi dhe Tirmidhiu.

<sup>16</sup> Ramadani Naser, Dispensë për vitin IV në Medrese, fq. 3

<sup>17</sup> Nesimi Abdulxhemil, Dispensë për vitin II, fq.8/9..

<sup>18</sup> Ramadani Naser, Dispensë për vitin IV në Medrese, fq. 3.

<sup>19</sup> Dalliu Ibrahim, Ajkat e kuptimeve kuranore, fq.17-18.

<sup>20</sup> Sure el Bekare, përkthim i Kuranit nga Sherif Ahmeti.

<sup>21</sup> Transmeton Muslimi, vëll. IV, fq. 2062.

<sup>22</sup> Nesimi Abdulxhemil, Dispensë për vitin II, fq.10.

<sup>23</sup> Dalliu Ibrahim, Ajka e kuptimeve të Kurani Kerim, fq. 21.

<sup>24</sup> Faqe interneti: <http://islamska-zaednica.com/forum/index.php?topic/2575-rendesia-e-besmeles-me-nje-koment-te-shkurter/>

<sup>25</sup> Aliu Bashkim, Tefsiri i Ibn Kethirit, fq. 57.

<sup>26</sup> Sure Isra, ajeti 110.

<sup>27</sup> Taberiu, vëll. I, fq.127.

<sup>28</sup> Sure Furkan, ajeti 59.

<sup>29</sup> Sure Tevbe, ajeti 128.

<sup>30</sup> Sure Hixhër, ajeti 49.

<sup>31</sup> Kurtubiu, vëll. I, fq. 105.

<sup>32</sup> Shih: [http://davetiislam.com/di/index.php?option=com\\_content&view=article&id=194:tefsir-i-sures-fatiha-&catid=44:kuran&Itemid=166](http://davetiislam.com/di/index.php?option=com_content&view=article&id=194:tefsir-i-sures-fatiha-&catid=44:kuran&Itemid=166)

<sup>33</sup> Po aty, fq. 56.

<sup>34</sup> Sure Ahzabë, ajeti 43.

<sup>35</sup> Aliu Bashkim, Tefsiri i Ibn Kethirit, fq. 57.

<sup>36</sup> Tefsiri i Ibn Kethirit –version i shkurtër nga Nesib er-Rifai, Sarajevë, fq. 31

<sup>37</sup> Sure Ahzab, 43.

# SI TË VEPROHET ME NJË TË VDEKUR

Nga *Nehat ef. Ismaili*

“Kam një rast vdekjeje, si të veproj”, i autorit Rehan Neziri, Imam në Xhaminë Hëna e Re në Kreuzlingen (Zvicër), është një doracak i shkruar në mënyrë artistike dhe me një metodologji të rreptë shkencore. Libri karakterizohet nga prezantimi i tematikave më thelbësore përkitazi me të vdekurin, përgatitjen e tij dhe të gjitha dispozitat që lindin si rrjedhojë e zbatimit të kodit etiko-moral dhe normativ përkitazi me të vdekurin: në një mënyrë të thjeshtë, të qartë dhe të kapshme për të gjitha shtresat e shoqërisë sonë.

Ajo që i sjell lumturi shpirtit njerëzor dhe që përhap kënaqësi e pranim në krahet e tij, është ajo që ofron komuniteti ku jeton, kombi, madje edhe njerëzimi në tërësi, të të gjitha llojeve të shërbimeve dhe aspekteve të dhënies së kontributit.

Format më të larta të shërbimit janë të natyrës shkencore dhe përpjekjeve intelektuale në çdo fushë dhe në çdo nivel, sepse kombet zhvillohen dhe ngrihen në stadi të larta për shkak të përparimit shkencor, të arritur nga bijtë dhe bijat e vet, prej përpjekjeve intelektuale dhe përparimit kulturor në atë vend, me ç’rast konsiderohen në radhët e kombeve të organizuara dhe të përparuara.

Autori Rehan Neziri ka kaluar nëpër stacione të ndritura të rilindjes, që adoptoi mendimin si bazë, kulturën si ligj dhe shkencën si metodë. Me këtë qasje, ai ka arritur shumë suksese në veprimtarinë e tij shkencore derisa është bërë, në sytë e teologëve dhe të studiuesve të islamologjisë, si referencë udhëheqëse në shkencat e sociologjisë së religjionit, të islamistikës dhe të fushave të tjera, si shembulli i lartë i rilindjes dhe ngritjes së vetëdijes njerëzore. Është autor i dhjetëra veprave shkencore dhe shumë përkthimeve të literaturës nga fusha e teologjisë, sociologjisë, psikologjisë etj. nga gjuhë të ndryshme botërore.

Autori Rehan Neziri gjatë përpunimit të materies dhe shtjellitimit të tematikave shërbehet me burime klasike të trashëgji-



misë islame, që janë si një llambë që ndriçojnë të tashmen dhe të ardhmen; paralelisht me këtë shërbehet edhe me referenca të studiuesve bashkëkohorë islamë që i njohin realitetet e komunitetit mysliman në Perëndim, në mënyrë që të përfitojmë nga të arriturat më të reja dhe jo vetëm të përtypim qëndrimet dhe mendimet nga e kaluara e lavdishme e trashëgimisë islame. Autori ato i bluan, i përpunon dhe, në të shumtën e rasteve, me shumë dinjitet dhe guxim intelektual shfaq qëndrimin e tij, duke e arsyetur dhe mbështetur atë me argumente tradicionale dhe racionale.

Koha në të cilën jetojmë karakterizohet nga shumë sfida dhe zhvillime që i imponohen rrjedhës së jetës sonë dhe janë çështje të pashmangshme që duhen trajtuar me seriozitet, me guxim dhe dinjitet, dhe mbi to të ndërtojmë sistemin e vlerave të besimit, në mënyrë që të jemi të lumtur, të meritojmë shpërblimin e Zotit të lavdishëm dhe të kontribuojmë në zhvillimin dhe në ngritjen e vetëdijes së komunitetit tonë.

Ky doracak nuk është një predikim me përmbajtje të trishtuar, të përvajshme dhe plot dhembje shpirtërore që mbjell pesimizëm, por një grup udhëzimesh dhe rekomandimesh që ju mundësojnë (juve) të zhvilloni të menduar të shëndetshëm përkitazi me përgatitjen e të vdekurit dhe përcjelljen e tij për në botën e amshue-

shme dhe me këto udhëzime do të jeni në gjendje të shikoni drejt së ardhmes me besim dhe optimizëm, sepse shtjellon shumë gjëra të rëndësishme për gjithë komunitetin tonë.

Citate nga libri: “Kam një rast vdekjeje, si të veproj?”, që e zë vendin kryesor në kopertinën e këtij libri, në fakt, përbën pyetjen e shpeshtë të cilën myslimanët kudo qoftë, e sidomos këtu në Perëndim, e parashtrojnë thujse çdoherë që e përjetojnë këtë situatë.


Duke qenë se njeriu i sëmurë ka dhimbje, siklet e vështirësi, ai ka nevojë që të shërohet. Ai ka nevojë - kjo është edhe e drejtë e tij elementare - për trajtim adekuat mjekësor, për kujdes si nga personeli mjekësor, ashtu edhe nga anëtarët e familjes dhe të afërmit e tij.

Momenti i vdekjes paraqet fundin e jetës në këtë botë dhe fillimin e jetës së ahiretit. Prandaj, të afërmit e shëndoshë duhet t’i ndihmojnë personit të shtrirë në shtratin e vdekjes, në drejtim të përgatitjes shpirtërore të tij për udhëtimin e përjetshëm.

Është detyrë e të gjallëve që të kujdesen për ruajtjen, pastërtinë dhe gjelbërimin e varreve e të varrezave të tyre. Sidomos për vizitorët këto duhet të mbahen të pastra, të gjelbëruara me kullosë, të stolisura me lule e me drurë të bukur përreth, që i japin pamjen e një kopshti të bukur “të xhenetit”.

# HASAN KALESHI, NJË EMËR I NJOHUR I ARABISHTES

Vëllim i tetë i veprave të përmbledhura përfshin një fushë në të cilën u dallua ky studiues yni i njohur në nivel të orientalistikës evropiane: punime nga gjuha dhe letërsia arabe. Përkthime të poezisë dhe të prozës arabe në gjuhën shqipe në “Flaka e vëllazërimit”, “Rilindja” etj.



Nga *prof. Muhamed Mufaku*

Në vazhdim të vëllimeve të veprave të akademik Hasan Kaleshit, të cilat botohen me rastin e 100 vjetorit të lindjes së tij (1922-2022), vjen vëllim 8, paksa më specifik. Në krahasim me vëllimet tjera, që përmbledhin tematika të ndryshme gjuhësore, letrare, historike e të tjera, ky vëllim përfshin një fushë në të cilën u dallua Kaleshi në nivel të orientalistikës evropiane: punime nga gjuha dhe letërsia arabe.

Lidhja e Kaleshit me gjuhën arabe është e hershme. Ajo nis që nga fëmijëria e tij, në sajë të kujdesit të të atit, imam Ahmet Kaleshi, për t’ia mësuar Kuranin, i cili tek arabët merret jo vetëm si vepër

fetare, por edhe si vepër më e lartë në stilistikën e gjuhës arabe.

Interesimi i Kaleshit të ri për mësim bëri që ai ta mësojë përmendsh Kuranin që në moshën 10-vjeçare. Më vonë, Kaleshi i thelloi njohuritë me arabishten gjatë shkollimit në “Medresenë e Madhe” të Shkupit, deri më 1941, kur u mbyll Medreseja për shkak të luftës, për të vazhduar pastaj shkollimin në gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë.

Pas luftës, në sajë të njohjes së mirë të arabishtes, ai u regjistrua në Degën e Orientalistikës në Beograd më 1946, ku i kreu studimet me sukses më 1951. Për shkak të zotërimit të kësaj gjuhe, ai punoi aty lektor i gjuhës arabe, si dhe zgjodhi për disertacion një temë që ka lidhje të

ngushtë me arabishten: “Dokumentet më të vjetra të vakëfit në gjuhën arabe në Jugosllavi”, të cilën e mbrojti me sukses më 1960.

Ndërkohë, pas përfundimit të studimeve për letërsinë arabe në kuadër të orientalistikës, Kaleshi zuri të merret me shkrime për letërsinë arabe, si dhe me përkthimet e para nga kjo letërsi, qoftë në gjuhën shqipe apo në gjuhën serbokroate. Kështu, mund të thuhet se Kaleshi në vitet 50-60 të shek. XX u bë emër i njohur në këtë fushë.

Pas themellitimit të Degës së Orientalistikës në Universitetin e Prishtinës, më 1973, ku ai u bë profesor i gjuhës dhe letërsisë arabe, u kujdes që të hartojë një tekst universitar për letërsinë arabe, që

t'u shërbente studentëve të Orientalistikës. Këtë tekst, me titull "Hrestomatia e letërsisë arabe", e paraqiti në Rektorat në vitin 1975 dhe priste me padurim botimin e tij, ngase studentët nuk kishin asgjë të botuar për letërsinë arabe.

Për fat të keq, ai vdiq papritmas më 19.07.1976 dhe teksti u zhduk në Rektorat. Përkundër përpjekjeve që të gjurmohet fatin e atij teksti, kolegu akad. Feti Mehdiu, atëherë profesor i gjuhës arabe, arriti vetëm të mësojë se teksti iu dha komisionit për vlerësim, por që më vonë u zhduk. Mu për këtë, ky libër u përgatit si rikonstruktiv i atij kontributi origjinal të Kaleshit, që e prezantoi autorin si pionier të arabistikës moderne në gjuhën shqipe e shumë më gjerë.

Kontributi i Kaleshit në fushën e studimit dhe përkthimit të letërsisë arabe mund të përmbledhet në disa aspekte. Kaleshi nuk ishte i vetmi njohës i arabishtes në viset shqiptare në gjysmën e parë të shek. XX. Kuptohet, në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni (sot: të Veriut) kishte mjaft që dinin arabishten, por ata kishin kryer studimet në qendrat tradicionale në Stamboll e në Kajro, me metoda të vjetra, në kohën kur arabistika zhvillohej në qendrat e orientalistikës në Evropë me metodat e reja shkencore.

Ishte me rëndësi fakti që Kaleshi e mbaroi Degën e Orientalistikës më 1951 dhe mbeti një kohë të mirë në këtë degë, duke praktikuar arabishten e re me studentët. Në këtë mënyrë ai njehëreshë përcollti zhvillimin e arabistikës në qendrat evropiane dhe në Egjipt, ku studimet linguistike dhe letrare arabe morën hov me hapjen e Universiteteve të Kajros dhe të Aleksandrisë në gjysmën e parë të shek. XX.

Lidhja e Hasan Kaleshit me Kajron, përkatësisht me Akademinë Shkencore, të themeluar më 1932, kishte efektin e vet në të dy drejtimet. Për Kaleshin, vizitat në Kajro, gjatë viteve 1965-1967, kontribuan dukshëm që ai të njihë më mirë gjuhën dhe letërsinë arabe, në kohën kur Egjipti ishte qendër e letërsisë bashkëkohore arabe, me emrat më eminentë të shek. XX si: Taha Husein, Teufik al-Hakim, Mahmud Tejmur, Naxhib Mahfuz e të tjerë. Disa nga këto personalitete Kaleshi i kishte njohur edhe më herët nga larg, duke ua përkthyer disa krijime në shqip dhe serbokroatisht, mirëpo tani lidhjet e tij personale me disa shkrimtarë më të njohur, e sidomos me M. Tejmurin, e nxitën të merret më shumë me përkthimin e veprave të tyre.

Kaleshi u paraqit në Kajro si orientalist evropian në kohën kur gati në tërë

botën arabe orientalizmi evropian kishte një imazh negativ, gjë që e trajtoi Eduard Saidi në veprën e tij "Orientalizmi". Mirëpo Kaleshi, në paraqitjen e tij më 1965 në Kajro me një ligjëratë rreth konceptit të orientalistikës ashtu siç e kuptonte ai dhe ashtu siç punonte për të, solli një risi për qarqet shkencore atje. Kështu, Kaleshi në ligjëratën e tij paraqiti një koncept tjetërfare për orientalistikën në mjediset me trashëgimi orientale në Evropë, si në Kosovë, Maqedoni (të Veriut) e në Bosnjë, si disiplinë shkencore që ka për qëllim kultivimin e mësimin të gjuhës arabe, prezantimin e letërsisë arabe, si dhe kujdesin për dorëshkrimet orientale, pa ndonjë ngarkesë idelogjike.

Këto koncepte të reja për qarqet shkencore arabe, të ngarkuara me ndjeshmëri ndaj orientalizmit kolonial e postkolonial, u pritën me interesim dhe mirëkuptim. Me këtë nuk na çudit vendimi, më 1967, për pranimin e Kaleshit si anëtar korrespondent në Akademinë e Shkencave të Kajros, pranim ky që pati një peshë të veçantë në tërë botën arabe, si i pari dhe vetmi orientalist nga ish-Jugosllavia.

Në bazë të materialit të prezantuar në këtë vëllim, mund të konstatojmë disa veçori të kontributit të Kaleshit jo vetëm në rrethin shqiptar, por edhe në atë ballkanik e më gjerë.

Për kohën e tij, nuk kemi ndonjë arabist që kishte aq njohje për gjuhën e letërsinë bashkëkohore arabe, e sidomos egjiptiane, e cila kishte marrë hov zhvillimi atëbotë. Kështu, ai arriti që nga fillimi i viteve 50-të të shek. XX të paraqitet me disa përkthime të poezisë dhe të prozës arabe në gjuhën shqipe dhe serbokroate në gazetata dhe revistat e njohura të kohës (Flaka e vëllazërimit, Rilindja, Književna reč, NIN e të tjera). Këto përkthime dalloheshin për një shije të hollë, por edhe për faktin se ishin përkthyer nga origjinali nga një njohës i mirë i letërsisë arabe, e jo nga gjuhët tjerë (frëngjisht, anglisht, rusisht e serbokroatisht).

Përveç studimeve serioze për letërsinë arabe dhe përkthimeve profesionale nga kjo letërsi, nga ky vëllim shihet se ç'kujdes kishte Kaleshi për përcjelljen e orientalistikës evropiane dhe për prodhimin shkencor të kritikëve arabë. Kjo del në pah para së gjithash nga recensionet që i kishte botuar në revistat profesionale. Në këto recensione vërehet kritika e tij për trendin e përkthimeve të letërsisë arabe nga gjuhët evropiane, e jo nga origjinali, edhe përkundër faktit që atëherë kishte njohës të gjuhës arabe. Në këtë frymë, nga puna në Degën e Orientalisti-

kës në Prishtinë bashkëpunorët dhe studentët e Kaleshit morën porosi të vlefshme dhe botuan shumë vepra të letërsisë arabe në gjuhën shqipe.

Në punën për përgatitjen e këtij vëllimi të veçantë na priu para së gjithash dëshira të rikonstruktivitetit të libër që tregon kontributin origjinal të Kaleshit në këtë fushë, kontribut i cili nuk ishte praktikuar deri atëherë jo vetëm në nivel të studimeve shqiptare, por edhe më gjerë, si dhe të përkujtojmë një tekst universitar për letërsinë arabe që u zhduk me qëllim në Rektorat, pas vdekjes së autorit më 1976. Për të arritur këtë qëllim, u detyruam të ribotojmë dy studime më të vlefshme të autorit (Kurani – kryevepër e letërsisë arabe dhe Tregimi modern arab dhe Mahmud Tejmur) në seksionin e parë Studime, kurse në këtë seksion kemi një ndër shkrimet e para në gjuhën shqipe dhe një tjetër, që botohet për herë të parë në shqip. Në seksionin Vlerësime kemi gjetur shkrime/recensione që botohen shqip për herë të parë dhe që tregojnë kulturën e gjerë profesionale të Kaleshit në përcjelljen e botimeve të ndryshme në këtë fushë dhe në qasjen e tij kritike.

Edhe pse Kaleshi kishte përkthyer shumë vjersha të poetëve arabë, e pamë të udhës të botojmë këtu vetëm ato vjersha që i botoi shqip, kurse i lamë jashtë vjershat e botuara në serbokroatisht, maqedonisht dhe turqisht, sepse, sipas Kaleshit, nuk vlen përkthimi nga përkthimi.

Në disa vëllime u pa e udhës që shkrimet e Kaleshit në shqip të kthehen në gjuhën e sotme standarde, mirëpo në këtë vëllim e pamë të udhës të ruhet shqipja të cilën e dinte mirë Kaleshi. Përkundër paragjykimëve, Kaleshi jo vetëm që ka filluar shumë herët të botojë shkrime të ndryshme në gjuhën shqipe, por ai tërhoqi vërejtje për kujdes ndaj gjuhës shqipe qysh në shkrimin e parë: "Disa vërejtje mbi gjuhën në shtypin tonë", botuar në revistën "Jeta e Re" më 1949. Për këtë, na duket se botimi i shkrimeve të Kaleshit në gjuhën origjinale paraqet edhe një aspekt tjetër – nivelin e kulturës gjuhësore të autorit në një kohë tranzicioni në Kosovë, ashtu edhe në Maqedoni (të Veriut).

Në fund, do të theksoja se ky vëllim është një produkt i punës kolektive të cilën e filluam bashkë me akad. Feti Mehdiun në Prishtinë dhe akad. Esad Durakoviçin në Sarajevë, pa të cilët nuk do të mund të mendohej sajimi i këtij vëllimi.

Burimi, i lejuar, 28.12.2022: <https://gazetadielli.com/hasan-kaleshi-ne-100-vjet-te-lindjes-1922-2022/>

# KONCEPTI MESHJET

***Përkthimet e gabuara në lidhje me këtë temë lëndojnë thellësisht kuptimin e saktë të Kuranit fisnik, e vënë Allahun e Plotfuqishëm në pozitën e të padrejtë/shtypës dhe e zhvendosin krejtësisht realitetin e relacioneve të Zotit dhe të njeriut me të keqen. A mund të ketë botëkuptim më të gabuar se sa t'ia atribuosh çoroditjen dhe devijimin e një personi Allahut të Plotfuqishëm? Shkencëtarët e teologjisë islame dhe pedagogët fetarë duhet ta korrigjojnë këtë çështje, përndryshe do të jenë nën një barrë të rëndë.***

***Nga prof. dr. Bayraktar Bayrakli***

**N**jëra nga temat e keqkuptuara të fesë islame, përkatësisht të Kuranit fisnik, është edhe koncepti "meshjet", që do të thotë "të dëshirosh/të duash". Lidhshmëria ndërmjet dëshirës/vullnetit hyjnor dhe vullnetit të robit, pra njeriut, nuk është përcaktuar dot si duhet dhe ajeteve kuranore që flasin mbi këtë temë u është dhënë një kuptim i gabuar; ruana Zot (hasha), ndonjëherë ato e kanë shpallur Allahun si mizor.


Ne synojmë t'i korrigjojmë dhe rregullojmë këto keqkuptime, duke analizuar dhe shpjeguar lidhshmërinë e dëshirës/vullnetit të lirë me udhëzimin, besimin, mohimin, kërkimin e rrugës për tek Allahu dhe vullnetin/dëshirën e Allahut të Madhërishtëm.

## **LIDHSHMËRIA NDËRMJET DËSHIRËS/VULLNETIT DHE UDHËZIMIT**

Vullneti i Allahut të Madhërishtëm dhe vullneti i njeriut zënë vend në ndryshimin rrënjësor të quajtur "udhëzim" (hidajet).

Hidajet, do të thotë të udhëzosh, të tregosh rrugën e drejtë, të bësh të besojë dikush me një kthesë të plotë nga mohimi (kufr) dhe politeizmi (shirk), domethënë të ofrosh një ndryshim rrënjësor në emër të teuhidit/besimit në njëshmërinë e Zotit në zemër. Për ndryshimin rrënjësor në zemër, Allahu i Plotfuqishëm merr për bazë vullnetin e robit/njeriut, përkatësisht njeriut e realizon vetë udhëzimin e quajtur ndryshim rrënjësor.

Ajeti është si vijon: "Nuk është obligimi yt (o pejgamber) të udhëzosh njerëzit (në rrugë të drejtë); por Allahu e udhëzon atë që do." (Bekara, 272)



Pikërisht shprehjen "men jeshau", që përmendet në këtë ajet, e kanë interpretuar në kuptimin: "Allahu e udhëzon kë të dojë Ai." Ndërkaq, ne me këtë shprehje nënkuptojmë "Allahu i udhëzon ata që dëshirojnë". Në fakt, këtu pëlçet kiameti. Nëse Allahu udhëzon kë të dojë dhe e shpie në lajthitje (dalalet) kë të dojë, atëherë, a nuk do të kishte bërë padrejtësi? Por, nëse Allahu i Plotfuqishëm e udhëzon atë që dëshiron të udhëzohet/përudhet dhe e shpie në lajthitje këdo që dëshiron, nuk do të ketë kurrfarë padrejtësie (zullum). Sepse, në të dy rastet njerëzit shprehin vullnetin, dëshirën e tyre, pra kanë një zgjedhje. Nuk mund të fajësohet Allahu i Plotfuqishëm, sepse kjo është zgjedhja e vetë njeriut, është vullneti/dëshira e tij.

Nga ana tjetër, në ajetin 35 të sures Enam thuhet kështu:

*"Të kishte dashur Allahu, do t'i kishte mbledhur të gjithë njerëzit tek udhëzimi." Koncepti i udhëzimit/hidajetit këtu do të thotë "rruga e drejtë".*

Shprehjen "të kishte dashur, do t'i kishte mbledhur" nuk duhet ta marrim në kuptimin "nuk i ka mbledhur". Ai e lë të lirë njeriun, nuk e detyron atë dhe e pret dëshirën dhe zgjedhjen e njeriut. Edhe pse Ai e ka fuqinë që t'i mbledhë tek udhëzimi (hidajet), mosmbledhja është një argument/provë se sa liri u ka lënë njerëzve. Prandaj, shprehjen "men jeshau", që theksuam më lart të ajetit 272 të sures Bekare, e përkthejmë si "dëshirë, vullnet i njeriut".

Përveç kësaj, në ajetin 13 të sures Sexhde Allahu i Madhërishtëm urdhëron:

*"Sikur të kishim dëshiruar Ne, secilit do t'i jepnim udhëzimin." Me fjalë të tjera: "Sikur të dëshironim, do t'i kishim shpënë të gjithë në rrugën e drejtë/në udhëzim." Siç shihet, edhe në këtë ajet theksohet se Ai nuk ua dha udhëzimin, ngase ka dashur që njerëzit hidajetin ta gjejnë me vullnetin e lirë, me preferencën e tyre dhe ta bëjnë këtë në mënyrë të lirë. Ndërkaq, në një ajet tjetër Ai thotë: "Vërtet Allahu e shpie në humbje atë që dëshiron dhe e udhëzon atë që i drejtohet Atij me qenien e tij." (Rad, 27)*

Nga shprehja "Ai e udhëzon atë që i drejtohet Atij me qenien e tij", që përmendet në këtë ajet, kuptojmë se njeriu fillimisht do t'i drejtohet Zotit, pastaj Zoti do ta udhëzojë, pra do ta shpie në rrugën e drejtë. Atë që dëshiron, që do lajthitjen, atë e ndërmond se devijimi do ta shpie në të, ndërsa atij që i drejtohet Ai do t'i japë udhëzimin.

a) Në lidhje me pjesën e ajetit që thotë "Allahu e shpie në humbje atë që

dëshiron" ka komentues të Kuranit që thonë se në shprehjen *men jeshau* "ku-shdo që dëshiron", kryesi i veprimit të folja *jeshau* është "Allahu". Ndërkaq, disa komentues tjerë thonë se autor i veprimit është "njeriu". Sipas mendimit tonë, vepruesi (autori) i veprimit nuk është Zoti, por njeriu. Ne preferojmë mendimin e grupit të dytë dhe vazhdojmë interpretimin tonë duke pëlqyer këtë përkthim. Kjo do të thotë që Zoti nuk e bën adhureshmërinë/robërinë ndaj Tij vetë, nuk i detyron krijesat; atëherë kjo do të ishte e padrejtë. Allahu i Plotfuqishëm i lë të bëjnë atë çka duan të bëjnë ata që dëshirojnë të devijojnë. Sepse, rregull bazë është ky: "Robi e do të keqen, Zoti e krijon atë; ndërsa mirësinë e duan edhe rob i edhe Zoti, dhe Zoti e krijon atë."

A nuk mund t'i pengojë Allahu i Plotfuqishëm ata që duan lajthitjen, por i plotëson dëshirat e tyre? Pa dyshim që përgjigjja për këtë pyetje duket mjaft e vështirë. E shohim të udhës ta shpjegojmë temën, pra të përgjigjemi me një shembull. P.sh. nxënësit që ka punuar, por që nuk e ka mësuar mësimin, mësuesi i tij i jep notë të dobët. Në fakt, mësuesi i tij mund t'i jepte edhe një notë të mirë, por atëherë nuk do t'i ngelte kurrfarë rëndësie dhe vlere studimit dhe provimit. Një mësues nuk mund të sigurojë që nxënësi i tij të marrë nota të mira duke iu përgjigjur vetë pyetjeve të provimit të nxënësve të tij. Kjo është në kundërshtim me natyrën e arsyes dhe të testimit/provimit. Nga ana tjetër, mësuesi t'u përgjigjet pyetjeve dhe t'u japë nota të mira atyre që nuk punojnë, do të ishte e padrejtë ndaj nxënësve që punojnë dhe bëjnë përpjekje, me fjalë të tjera do të nëpërkëmbet drejtësia. Andaj, nëse Allahu i Plotfuqishëm do ta kishte penguar këtë dëshirë të atyre që dëshirojnë të keqen, do të ishte e padrejtë ndaj atyre që dëshirojnë të mirën, dhe gjithashtu do të ishte në kundërshtim me të qenët e jetës së kësaj bote sprovë.

Allahu i Plotfuqishëm nuk ndërhy në vullnetin e lirë, në dëshirën dhe në lirinë e robit të Tij. Nuk ndërhy, në mënyrë që në të ardhmen të mund ta mbajë atë përgjegjësi për zgjedhjen e lirë të veprimit të vet. Përgjegjësia qëndron në zgjedhjen e lirë, pra mbi veprimet që bëhen me vullnet të lirë.

b) "E udhëzon atë që i drejtohet Atij me qenien e tij."

Në këtë pjesë të ajetit të shprehja *men enabe* kryerësi i veprimit të folja *enabe* i referohet njeriut. Pra, është njeriu ai që realizon veprimin e kthimit të Zotit. Ndërsa drejtimi/kthimi kah Allahu i Ma-

dhërishtëm ka bëjë me zemrën. Kthimi drejt Allahut, në fakt, është emri i ndryshimit rrënjësor që ndodh në zemrën e njeriut, dhe është fillimi i rrjedhave të zemrës në drejtimin e kundërt nga rrugët që shpiejnë në politeizëm (shirk) apo mohim (inkar). Pikërisht akti i kthimit tek Allahu me gjithë qenien e tij, që ndodh në zemrën e robit, e fton/e thirr udhëzimin (hidajetin) e Allahut të Madhërishtëm. Ndërsa Allahu i Plotfuqishëm e regjistron, e vërteton drejtimin në zemrën e robit.

"Të kthehesh te Zoti", gjithashtu do të thotë të "pendohesh" dhe të kthehesh te Zoti duke u penduar, ashtu siç nënkupton braktisjen e gabimeve dhe pendimin, njëkohësisht do të thotë edhe braktisjen e perëndive të rremë dhe kthimin tek Allahu i Madhërishtëm.

*"Vallë, a është ai që qe i vdekur, kurse Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë, me të cilën ecën mes njerëzve, si ai që ka mbetur në errësirë (i humbur) dhe nuk mund të dalë prej saj? Kështu mohuesve u zbukurohen veprat që i bëjnë." (Enam, 122)*

Analiza e ajetit do të na çojë në disa përgjithësime. Andaj, ne duke e ndarë atë në pjesë, mund shpjegojmë si më poshtë.

### TË VDEKURIT E GJALLË

Në disa ajete të Kuranit jobesimtarët dhe politeistët paraqiten/cilësohen si të "vdekur". Prandaj, fjala "i vdekur" që përmendet në këtë ajet nuk nënkupton të vdekurin siç e njohim ne. Shprehja "ai që qe i vdekur" i referohet personit/njeriut që e kupton të vërtetën, por që nuk e beson. Si e argumentojmë dhe e vërtetojmë këtë? Ajeti i 21-të i sures Nahl i përshkruan njerëzit që bëjnë shirk/politeizëm si vijon:

*"Ata janë të vdekur, e jo të gjallë. Dhe ata nuk e dinë se kur do të ringjallen." Edhe ajeti i 80-të i sures Neml bën të njëjtin krahasim: "Dije se nuk mund t'i bësh të vdekurit të dëgjojnë. Të gjallët dhe të vdekurit nuk janë njësoj." (Fatir, 22)*

Fjala *kefera*, nga e cila rrjedh fjala *kafir*, do të thotë "të hedhësh farën në tokë dhe ta mbulosh atë". Personi që mohon (kafir) e merr këtë emër sepse mbulon/fsheh të vërtetën. Jobesimtari/mohuesi nga Allahu i Madhërishtëm paraqitet si i "vdekur", sepse ai varrosi veten, përkatësisht u zhyt në errësirën e injorancës/xhahilijetit. Personi i këtu është sikur ta kishte varrosur shpirtin në tokë; ai para se të vdes është shndërruar në një gjendje sikur të ishte i vdekur.

Prandaj, shprehja e plotë për këtë kategori është "të vdekurit e gjallë".

Kështu, shihet qartë se Kurani përfshin konceptet e të vdekurit fizikisht dhe të vdekurit shpirtërisht. Domethënë, politeizmi dhe mohimi janë armët më të mëdha që futen në zemrën e njeriut. Me këto armë vdes shpirtërorja e njeriut. Zoti e quan atë person "të vdekur". Mund të thuhet se në botë ka më shumë "të vdekur" se të gjallë. Argument për këtë është ajeti i 103-të i sures Jusuf: "Megjithatë, sado e madhe të jetë dëshira jote, shumica e njerëzve nuk do të besojnë." Nuk ka asnjë dallim midis të vdekurve nën tokë dhe 'të vdekurve të gjallë' mbi të. Përpos me një dallim: ai që është nën tokë, nuk i bën dëm askujt; ndërkaq, ata që janë mbi tokë, bëjnë; sepse ata përhapin mohimin e tyre. Ajeti 122 i sures Enam e tërheq vëmendjen për këtë situatë.

### ATA QË BARTIN DY SHPIRTRA

Me shprehjen "Ne e ngjallëm", Allahu i Madhërishtëm ka për qëllim "atë që beson". Kjo do të thotë: njeriu që beson bart dy shpirta - njëri është shpirti që e lëviz trupin dhe tjetri është shpirti të cilin njeriu e fiton përmes besimit. Besimi është argumenti/prova më e madhe se mendja funksionon. Një njeri, mendja e të cilit funksionon/punon, do të thotë se ai e gjallëron jetën e tij shpirtërore.

*Ai që ecën në dritë dhe ai që ka mbetur në errësirë*

Allahu i Plotfuqishëm e trajton ndryshe personin të cilit i dha jetë duke besuar. "Vallë, a është i njëjtë ai që i dhamë dritë, me të cilën ecën mes njerëzve, si ai që ka mbetur në errësirë (i humbur) dhe nuk mund të dalë prej saj"? Besimtari që bart dy shpirta, pra njeriu që vepron duke përdorur mendjen, ka një dritë në tru dhe në zemër. Allahu i Plotfuqishëm është Ai që këtij personi ia jep këtë dritë. Ai njeri, a do të ecë/endet mes njerëzve në këtë botë apo në botën tjetër/ahiret? Pyetjes mund t'i përgjigjemi me dy ajete kuranore. Sipas këtij ajeti që jemi duke e komentuar, ai qarkullon/ecë mes njerëzve në këtë botë, por e njëjta dritë do të jetë edhe në botën tjetër/ahiret. Në lidhje me këtë fakt aludon edhe ajeti i 12-të i sures Hadid: "Ditën kur i sheh besimtarët dhe besimtarët teksa drita e tyre ndriçon para tyre dhe në të djathtë të tyre..."

Domethënë, besimi do të jetë një dritë që ndriçon rrugën e njeriut - si në këtë botë, ashtu edhe në ahiret. Ja, pra, ai shpirt i dytë do të bëhet dritë dhe njeriu me të do të ecë në mesin e njerëzve. Kup-



timi i ecjes/qarkullimit mes njerëzve nënkupton lëvizjen dhe veprimtarinë në mesin e njerëzve pa goditur askënd, pa fërkime e acarime, pa shkaktuar telashe, pa shkaktuar probleme dhe pa e prishur fare rendin mes tyre. Allahu i Madhërishtëm parashtron pyetje nëse një person që ecën mes njerëzve me dritë mund të jetë i njëjtë me një person që ka ngelur në errësirë, nga e cila nuk mund të dalë kurrë. Njeriu politeist (mushriku) dhe jobesimtari (qafiri) janë të varrosur në një errësirë që nuk ka rrugëdalje. Prandaj, një person të këtuillë Zoti e quan "të vdekur"; domethënë, 'një i vdekur i varrosur në errësirë'. Kjo errësirë është errësira e zemrës dhe e trurit mbuluar nga epshi.

### ATA QË JANË MASHTRUAR NGA STOLITË

Njerëzit që kanë humbur mundësinë për të përdorur mendjen për të zgjidhur problemet që kanë përballë me dritën e saj, fillojnë t'i shohin sjelljet e tyre të gabuara të stolisura/zbukuruara. Sepse, ata nuk mund t'i shohin anët dhe tiparet e tyre të këqija. Allahu i Madhërishtëm e përdor këtë shprehje, pasi ata do të mashtrohen njësoj si një person që mashtrohet nga stolitë false dhe blen bakër në vend të arit. Pra, në një vend ku nuk ka dritë, është e pamundur të shohësh arin dhe të kuptosh vlerën se sa karat është ai. Një person i cili është i privuar nga drita e ar-

syet dhe e besimit do të privohet edhe nga të kuptuarit e cilësisë, të kualitetit të veprave të tij.

Nëse do të vendoset një lidhshmëri ndërmjet pjesës së fundit të ajetit dhe pjesëve të mëparshme, mund të parashtrohet kjo pyetje: Pse ky person që është në errësirë nuk mund të dalë prej andej? Në pjesën e fundit të ajetit: "Kështu mohuesve u zbukurohen veprat që i bëjnë" nga fjala "veprat që i bëjnë", që përmendet aty, kuptojmë se me kalimin e kohës veprimet e njerëzve shndërrohen në karakter të tyre. Domethënë, ka një karakter të lindur dhe ka një karakter të fituar më vonë. Besimet dhe veprimet e njerëzve bëhen karaktere të pandashme të tyre. Ajo që reziston nuk është vullneti i vet i njeriut, por ky karakter fals i formuar më vonë. Për shkak se ky karakter e mbulon trurin dhe zemrën e njeriut, e lë atë në errësirë. Në këtë mënyrë Allahu i Madhërishtëm tërheq vëmendjen në lidhje me raportet shkak-pasojë që funksionojnë nga psikologjia në veprim, nga veprimi në psikologji.

### 1. Lidhshmëria e vullnetit të lirë me besimin/imanin

Në fakt, arritja në udhëzim (hidajet) do të thotë të pranosh besimin e njëshmërisë së Zotit. Por, ne kemi paraparë t'i shpjegojmë këto çështje duke i ndarë nga njëra-tjetra. Ajetet që e shpjegojnë këtë temë janë si më poshtë. "Sikur të ki-

shte dashur Zoti yt, me siguri që do të kishin besuar të gjithë ata që janë në tokë. Pra, a do t'i detyroni njerëzit që të besojnë?" (Junus, 99)

"E ti thuaj: E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë." (Kehf, 29)

"Ne ia treguam njeriut rrugën e drejtë. E ai nëse do beson, nëse do mohon (i takon atij të tregojë veten, mirënjohës apo mosmirënjohës)." (Insan, 3)

Ekzistojnë parime të rëndësishme që mund të nxjerrim nga këto ajete:

a) Nuk duhet të ketë detyrim në çështjen e besimit. Nëse një njeri do të besojë, ai duhet të besojë lirshëm, pa imponim. Sikur të kishte dashur Allahu, do t'i bënte të gjithë të besonin. Ai e njofton/informon Pejgamberin (a. s.), pra, nëpërmjet atij edhe neve, se nuk është e drejtë t'i detyrojmë njerëzit të besojnë.

b) Në lidhje me besimin, e rëndësishme është vullneti/dëshira e lirë e njeriut. Kjo dëshirë duhet të realizohet pas mesimit dhe informimit të Allahut të Madhërishtëm. Pas dëshirës/kërkesës së njeriut, Allahu i Madhërishtëm e vë në praktikë dëshirën e Tij.

### 2. Lidhshmëria e vullnetit të lirë me shirkun/politeizmin

Mushrikët, bërjen e shirkut, përkatësisht shoqërimin e ortakëve Zotit, ia atribuojnë vullnetit/dëshirës së Allahut të Madhërishtëm apo mosdëshirës së Tij. Kjo do të thotë se ata e fajësuan Allahun për idhujtarinë e tyre. Ata thoshin "Allahu nuk deshi që ne të mos bëjmë shirk/politeizëm, kështu që ne u bëmë politeistë. Mungesa e vullnetit të Allahut na ka vënë në këto situata." Ajeti që flet në lidhje me këtë temë është si vijon. "Politeistët do të thonë: "Sikur të kishte dashur Allahu, as ne e as baballarët tanë nuk do të ishim bërë politeistë; e as nuk do të ndalonim (bënim haram) asnjë send (që Ai e ka lejuar)." Kështu thanë edhe ata që para tyre përgëneshtruan të vërtetën, derisa më në fund e shijuan dënimin Tonë. Thuaj: A keni ndonjë njohuri të cilën mund të na e parashtrojnë? Ju i mbështeteni vetëm hamendjes dhe ju në të vërtetë, vetëm gënjeni." (Enam, 148)

### 3. Roli i vullnetit të lirë në gjetjen/ndjekjen e rrugës së drejtë

Dëshira e Allahut të Madhërishtëm është që rob i Tij të ndjekë rrugën që e çon tek Ai, të orientohet tek Ai dhe të njëjtën dëshirë ta ketë edhe rob i Tij. Ajetet kuranore që flasin për këtë temë janë si më poshtë. "Thuaj: unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim, vetëm se ju të jeni

nga ata që dëshironi të merrni një rrugë të drejtë për te Zoti juaj." (Furkan, 57)

"Pa dyshim, kjo është një këshillë. Kush dëshiron, ai e zgjedh rrugën që e shpie te Zoti i vet." (Muzzemmil, 19)

"Jo! Në të vërtetë Kurani është një këshillë e lartë. E, kush do, këshillohet me të. Në këtë mënyrë, zaten, këshillohen vetëm ata që do Allahu..." (Muddeththir, 54-56)

"Vërtet kjo është një këshillë. E, kush do, e merr rrugën që e çon te Zoti i tij. Në fakt, ju dëshironi vetëm atë që dëshiron Allahu..." (Insan, 29-30)

"Pra, ku po shkoni (me këto mendime). Ky Kuran është vetëm një këshillë për të gjithë njerëzimin, për çdonjërin prej jush që dëshiron të ecë në rrugë të drejtë." (Tekvir, 27-28)

### RRUGËTIM I ZGJEDHUR ME VULLNETIN E LIRË

Nëse njeriu dëshiron të marrë rrugën që e çon tek Allahu, ai në fakt e ka dëshiruar atë që dëshiron Allahu i Madhërishtëm. Dëshira/vullneti i Allahut të Plotfuqishëm është që ne të marrim rrugën që shpie drejt Tij. Kur dëshirojmë ta ndjekim atë rrugë, në atë moment ne dëshirojmë atë që dëshiron Allahu i Madhërishtëm. Njeriu mund të mos ndjekë rrugën që e çon tek Allahu i Plotfuqishëm. Prandaj, Ai parashtrohet pyetjen "Ku po shkoni?". Kjo shkuarje (ky rrugëtim) është rrugëtimi i njeriut që e zgjedh me vullnetin e lirë të tij. Allahu i Plotfuqishëm nuk e shpie në rrugë të gabuar. Nëse do ta kishte shpënë, nuk do ta parashtrohte këtë pyetje. Njeriu nëse dëshiron, merr këshilla nga mesazhi i Zotit të tij dhe hyn në rrugën e tij. Rruga e tij është rruga e drejtë. Mbajtja e njeriut në rrugën e drejtë, që e shpie drejt Allahut të Plotfuqishëm, është qëllimi i edukimit të Pejgamberit (a. s.). Në fakt, Pejgamberi (a. s.) ka zhvilluar mësimet edukative për t'ua mësuar njerëzve rrugën e vërtetë që shpie tek Allahu i Plotfuqishëm, ka ofruar njohuri në lidhje me këtë çështje dhe ka nxitur ngjizjen/rrënjoshjen e vetëdijes për ta ndjekur këtë rrugë. Edhe ne duhet të nisemi me të njëjtin qëllim dhe ta zbatojmë Sunnetin e Allahut (Sunetullah) dhe Sunnetin e të Dërguarit (a. s.). Ne do t'i lëmë njerëzit të lirë të shprehin vullnetin e tyre. Ne, fillimisht atyre duhet t'ua bëjmë të qartë dhe t'i informojmë për rrugën e drejtë. Ndërsa ata që shkojnë në rrugë të gabuar do t'i pyesim: "Ku po shkoni?"

Si përfundim, mund të themi se koncepti "meshiet", domethënë "të dëshir-

rosh", është njëra ndër temat kryesore të Kuranit fisnik. Çfarëdo që ka të bëjë me mëkatet, me krimet, me çrregullimet dhe me negativitetet, gjithmonë shfaqet dhe realizohet si pasojë e vullnetit të lirë të njerëzve. Këto gjëra reflektojnë në strukturën shoqërore dhe ndikojnë negativisht në organizimin e jetës së njeriut. Në esencën e veprimeve të njeriut siç është mohimi, përgëneshtrimi dhe mendjemadhësia, gjithmonë qëndron "dëshira" e tij.

Për ata njerëz që kërkojnë të gjejnë një shkaktar dhe burim tjetër për sjelljet devijante dhe mëkatet e tyre (e jo veten), duke u përpjekur ta vendosin Allahun e Madhërishtëm si shkaktar, përgjigjja e dhënë nga Allahu i Madhërishtëm në ajetin 59 të sures Zumer e mbyll çështjen dhe e zgjidh problemin. "Atëherë Allahu do të përgjigjet në këtë mënyrë: Vërtet që ty të erdhën (ajetet) argumentet e Mia, por ti i përgëneshtrrove, u tregove kryelartë/mendjemadh dhe u bërë prej jobesimtarëve." Njeriu nuk mund ta vendosë Allahun e Plotfuqishëm si burim i përgëneshtrimit, kryelartësisë/arrogancës dhe mohimit të tij; burimi i këtyre cilësive është dëshira/vullneti i lirë i njerëzve, zgjedhjet e tyre dhe veprimet që ata vetë i bëjnë. Për këtë arsye, një pjesë e ajetit 31 të sures Muddeththir, e përkthyer si vijon: "Allahu e lë në humbje atë që do (Ai) dhe e udhëzon në rrugën e drejtë atë që do", është një përkthim i gabuar. E vërteta është se kjo pjesë duhet të përkthehet në këtë mënyrë: "Allahu e lë të humbë atë që dëshiron (ta humbë udhën) dhe e udhëzon në rrugën e drejtë atë që dëshiron (të udhëzohet)." Ky dhe ajete të ngjashme duhet të përkthehen në këtë mënyrë.

Përkthimet e gabuara në lidhje me këtë temë lëndojnë thellësisht kuptimin e saktë të Kuranit fisnik, e vënë Allahun e Plotfuqishëm në pozitën e të padrejtës/shtypësit dhe e zhvendosin krejtësisht realitetin e relacioneve të Zotit dhe të njeriut me të keqen. A mund të ketë botëkuptim më të gabuar se sa t'ia atribuosh çoroditjen dhe devijimin e një personi Allahut të Plotfuqishëm? Shkençtarët e teologjisë islame dhe pedagogët fetarë duhet ta korrigojnë këtë çështje, përndryshe do të jenë nën një barrë të rëndë.

/Marrë nga libri "Kuransız Müslimanlık", shtëpia botuese "Düşün Yayıncılık", Stamboll, 2019, botimi i 6-të/

Përktheu nga turqishtja:  
dr. Selver Xhemaili

# TYRBJA E ASHIK ÇELEBISË NË GAZI-BABË TË SHKUPIT

Shkruan: prof. Mumin Omerov

Pasardhësit e Pejgamberit (a. s.) nga Hasani dhe Husejni quhen *sejjid* dhe *sherif*. Këtyre njerëzve u është dhënë gjithmonë rëndësi në shoqëritë islame dhe në Perandorinë Osmane.

Për të plotësuar nevojat e pasardhësve të Muhamedit (a. s.) në Perandorinë Osmane, u krijua institucioni "Nakubu'l-Esraflık" dhe në krye të këtij institucioni u emërua gjyshi i Ashik Çelebisë (Âşık Çelebi), Sejjid Natta. Disa nga gjyshërit e Ashik Çelebisë ishin kryetarë në këtë institucion, disa prej tyre nuk ishin të interesuar për këtë profesion dhe preferonin kadillëkun dhe detyra të tjera.

Njëri prej tyre është babai i Ashik Çelebisë, Sejjid Ali. Ai preferoi detyrën e kadiut dhe e ushtroi këtë profesion për shumë vite në Anadoll dhe në Ballkan. Ndërsa babai i tij ishte gjykatës i Shkupit; ai shkoi në Kosovë për inspektim dhe, ndër kohë, në qytetin e Vushtrrisë lindi djali i tij, Pir Mehmed Ashik Çelebi.

Ashik Çelebi, i cili një pjesë të jetës së tij e kaloi në Shkup, për shkak të detyrës së babait, më vonë u kthye në Bursa me familjen e tij, ku banonin gjyshi dhe të afërmit e tij.

Ashik Çelebi humbi nënën dhe babanë në moshë të vogël dhe mbeti jetim me vëllezërit dhe motrat. Ashik Çelebi dhe vëllezërit e tij, të cilët kaluan kohë të vështira, e përfunduan shkollimin në kushte të rënda me ndihmën e të afërmeve. Pasi Ashik Çelebia mori ixhazetin (diplomën) nga medreseja, filloi të punonte si gjykatës, punë të cilën e kishte bërë i ati.

Ai shërbeu si gjykatës në qytete të ndryshme të Anadollit dhe të Ballkanit dhe më në fund u emërua gjykatës në Shkup, ku kishte kaluar vitet e fëmijërisë. Ai shërbeu si gjykatës për tre vjet në Shkup dhe nuk mundi të shpëtojë nga sëmundja e pleuritit në vitin 1572 dhe vdiq në qytetin ku i kaloi vitet e fëmijërisë.



Ashik Çelebia krahas detyrës së tij si gjykatës, është marrë me shkrime të poezive dhe me përkthim të librave të ndryshëm. Ai së bashku me komentimin e veprave të ndryshme që bëri, ka shkruar gjithsej 12 vepra.

Gjatë viteve që u shkollua në Stamboll takoi shumë poetë dhe studiues dhe pas asaj nuk e ndërpreu kurrë lidhjen me poetët. Pas marrjes së ixhazetit (diplomës), ai ka qenë gjithmonë i ndërthurur me veprimtari shkencore - qoftë të shkrimit apo të përkthimit të librave. Ashik Çelebi fitoi një reputacion të merituar sidomos me veprën e tij të quajtur *Meşairü's-Suarâ*.

Ashik Çelebi, i cili ishte gjykatës gjatë gjithë jetës së tij, doli në plan të parë me identitetin e tij poetik dhe jo të gjykatësit. Ka pasur shumë studime akademike për poezinë e tij dhe veprat që ka përkthyer. Megjithatë, Ashik Çelebia në Rumeli njihet si kadi dhe mik i Zotit, e jo si poet.

Ashik Çelebia, i cili vdiq në vitin 1572, nuk është harruar nga njerëzit në

Shkup, edhe pse kanë kaluar shekuj nga vdekja e tij. Emri i tij mbahet ende gjallë në lagjen e njohur si Gazi-Baba të këtij qyteti, ku edhe ka ndërruar jetë. Në të njëjtën kohë, në parkun e Gazi-Babës ndodhet edhe varri i Ashik Çelebisë dhe parku mban emrin e tij.

### JETA E ASHIK ÇELEBISË

Siç u tha në një rast më parë, vitin e lindjes së Ashik Çelebisë e mësojmë nga data (feyz-ı ilah) që shënoi babai i tij: 926/1520. Ashik Çelebi u lind në qytetin e Vushtrrisë (Kosovë), sipas të dhënave që ai dha vetë në veprën e tij *Meşairü's-Şu'ara*. Edhe pse në disa burime thuhet se ka lindur në vitin 924/1518, kjo nuk është e vërtetë. Si rezultat i keqinterpretimit të shprehjeve si "Bursalı", "nga Bursa", "Bursevî", të përdorura për Ashik Çelebinë në disa burime, si nga biografët Latif, Beyan, Ahdi dhe Hasan Çelebi, vendlindja e tij jepet si Bursa në disa punime. Po ashtu theksohet se në lindje familja e tij i dha emrin Pir Mehmed. Mirëpo, në vitet kur filloi të shkruante poezi i vuri vetes pseudonimin Ashik. Në fakt, ai është një poet që u bë i famshëm me pseudonimin e tij dhe jo me emrin e tij në shoqërinë osmane.

Ashik Çelebi, i cili është ngushtë i lidhur me shkencën që në fëmijëri për shkak të mjedisit familjar, e fillon shkollimin që në moshë të vogël. Atai ka deklaruar se Ashik Çelebi e filloi shkollimin në moshë të re pranë Surûri Çelebisë, mësuesit t Kasım Pashës, Taşköprizade efendiut - mësuesit të Kalenderhanes, Arab-zâde Abduldaki efendiut - mësuesit të Mahmud Pashës, pastaj mësuesit të medresesë Sahn-ı Seman Saçlı Emir efendiut, Karesili Hasan Çelebi dhe Muhjidin Fenarit, prej të cilëve edhe i mori mësimet.

Ndërkohë, ai takohet me poetë të rinj e të vjetër dhe me studiues të mëdhenj të Stambollit. Në këtë drejtim e ndihmuan shumë lidhjet farefisnore me njerëzit me

ndikim të periudhës si: Müeyyed-zâde dhe Muhyiddin Fenari dhe marrëdhëniet që vendosi me miqtë e vjetër të babait të tij.

Ashik Çelebi e filloi detyrën e tij të parë si gjykatës në vitin 1550 në Silivri. Ai u martua kur ishte kadi këtu, por martesë e tij ishte e shkurtër dhe u divorcua. Përveç kësaj martese të shkurtër, nuk u gjet asnjë informacion nëse ai u martua sërish apo se kishte fëmijë.

Sa ishte gjykatës i Silivrit, erdhi në Stamboll me rastin e vdekjes së një të afërmi të tij, ra nga kali sa ishte këtu dhe theu një gisht.

Me ndihmën e miqve dhe me dëshirën e tij, ai u emërua gjykatës në Prishtinë. Kështu, ai u kthye në vendlindjen e tij si kadi. Pasi punoi për një kohë si gjykatës këtu, ai u transferua në Serficë. Pas kthimit në Stamboll nga Ekspedita Zigetvar, II. Selim, Ashik Çelebi ia dhuroi Sulltanit veprën e tij më të rëndësishme *Meşâ'irü's-Şu'arâ*. Si rezultat i pëlqimit të Sulltanit për punën e tij, ai e emëroi Ashik Çelebinë gjykatës të Kiratovës me një pagë ditore prej njëqind e pesëdhjetë akçe. Sidoqoftë, kjo detyrë nuk zgjati shumë dhe ai u largua nga puna në 1569. Ai deklaroi se nuk dëshironte të shërbente si gjykatës si rezultat i shkarkimit të tij nga *Kiratova kadi*. Ai deklaroi se donte të merrte pjesë në detyrën e *'nakibû'l-eşraf'* - i në Perandorinë Osmane, të cilën gjë e kishin bërë gjyshërit e tij.

#### DETYRA E FUNDIT SI GJYKATËS DHE VDEKJA NË SHKUP

Ashik Çelebi shkroi një *Shakâ'ik Zeyl* në arabisht në emër të Sokollu Mehmed Pashës, Vezirit të Madh të asaj periudhe, dhe ia paraqiti atij. Ai u emërua gjykatës i Shkupit, me kusht që të qëndrojë në detyrë deri në vdekjen e tij, jo për një periudhë të caktuar kohore (kayd-ı hayat).

Para se të nisej për në Shkup, ai i përshëndeti të gjithë miqtë e tij në Stamboll. Ai vizitoi edhe hoxhën e tij Ebussuud efendiun, i cili ishte *Shejhul Islami* i asaj kohe. Në vitin 1569 fillon detyrën e tij si gjykatës në Shkup.

Derisa Ashik Çelebia ishte gjykatës i Shkupit, u sëmur nga pleuritit dhe vdiq në vitin 1572 nga kjo sëmundje.

Në dokumentet e arkivit osman emri i Ashik Çelebisë përmendet si “Kadı Baba”, “Gazi Baba” dhe “Kara Kadı”. Por, sot ai është i njohur si Gazi Baba në Shkup. Pas një kohe, në vendin e varrit të tij, në Shkup, u ndërta një tyrbe. Tyrbja e ndërtaur në emër të Gazi Babës (Ashik Çelebisë), ndërkaq, u dëmtua në tërmetin e vitit 1963 dhe u shkatërrua plotësisht, sepse

nuk u riparua për shkak të kohës së komunizmit.

#### TYRBJA E ASHIK ÇELEBISË

Nga kjo tyrbe kanë mbetur disa gurë varri. Në vitin 2013 Komuna e Bursës erdhi në ndihmë, që ajo të rindërtohej, e cila ishte rënuar për shumë vite. Tyrbja quhet: Tyrbja Ashik Pir Mehmed Çelebi (Turbe Âşık Çelebi) dhe është në lagjen Gazi-Baba.

Gërmimet arkeologjike dhe iniciativat restauruese të nisura nga Komuna e Bursës, si rezultat i gërmimeve, janë shumë të rëndësishme për ruajtjen dhe mbajtjen gjallë të kësaj trashëgimie kulturore. Është një shpresë e madhe që Ashik Çelebi, i cili përfaqëson një nga emrat simbolikë të Shkupit, dhe trashëgiminë që la pas, të bëhet sërish në qendër të vëmendjes së shkupjanëve dhe atyre që e vizitojnë Shkupin.

Tyrbja u restaurua nga Komuna e Bursës në vitin 2013 dhe u hap për publikun. Me kontributet e Komunës, tyrbja u shpëtu nga shkatërrimi dhe humbja në histori. Gazi Baba si një njeri me prejardhje nga familja e Pejgamberit (a. s.), në sytë e popullit shihet si një evlija. Disa të dashuruar që donin të bashkoheshin me të dashurit e tyre, i luteshin Zotit në prani të Gazi Babës. Kjo situatë ka qenë objekt edhe i këngës popullore.

Në një këngë popullore të Shkupit, shprehja e një të dashuruar që dëshiron të ribashkohet me të dashurën e tij, duke iu referuar Gazi Babës (Ashik Çelebisë), e tregon edhe pozicionin e tij në sytë e njerëzve:

*“Para se të arrish në Shkup, vjen Kumanova;*

*Eja e dashur, që së bashku të ndërtojme një çerdhe.*

*Në mes të Shkupit pushon një Gazi Babë.*

*Kush ma mundësoi bashkimin me ty, fitoftë sevap.”*

Të dashuruarit që iu pranua lutja, u bashkua me të dashurën e tij dhe bashkë bënë shumë lutje te varri i Gazi Babës. Gjithashtu, sot herë pas here turistët që vizjnë në Shkup e vizitojnë tyrben e Gazi Babës. Ata lexojnë *Fatihane* me sineritet dhe e përkujtojnë me mirësi shpirtin e këtij të bekuari nga prejardhja e Pejgamberit (a. s.). Ata gjithashtu kënaqen duke parë qytetin nga tyrbja që gjendet në majë të Shkupit.

#### PARKU I ASHIK ÇELEBISË (PARKU I GAZI-BABËS)

Parku i Gazi-Babës është vënë në shërbim në vitin 2015, pas bashkëpunimit të

Qytetit të Shkupit me Komunën e Çairit. Në park ka zona pikniku, zona për shëtitje një mijë e dyqind metra, kënde lojërash për fëmijë, pesëmbëdhjetë stola prej druri dhe një shatërvan në park. Përveç kësaj, Parku i Gazi-Babës është i ndriçuar, në mënyrë që njerëzit të mund të ecin të qetë dhe të sigurt gjatë natës. Për ndriçimin e parkut janë dhënë 2,6 milionë denarë. Qyteti i Shkupit dhe Komuna e Çairit për këtë projekt shpenzuan gjithsej 6,6 milionë denarë. Qindra fëmijë luajnë në këtë park çdo ditë. Dhjetëra njerëz ushtrojnë sportet e tyre në shtegun e ecjes në mëngjes.

Gazi Baba, emri i të cilit është Ashik Çelebi, vazhdon të mbahet gjallë me emrat për parkun dhe tyrben në rrethin e tij.

#### Biblioteka Ashik Çelebi

Shoqata *Ura e Artit dhe e Arsimit* është themeluar në vitin 2002 në Shkup. Tre vjet pas themelimit të saj, më 4 shkurt 2005, në kuadër të Shoqatës Köprü u hap një bibliotekë me emrin Ashik Çelebi. Kjo është gjithashtu biblioteka e parë private që shërben në Shkup dhe përmban më shumë se 8.000 vepra. 80% e librave janë vepra në gjuhën turke. Pjesa tjetër nga librat e mbetur janë në maqedonisht, disa në shqip dhe disa në anglisht. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre librave janë siguruar nga studentët e Maqedonisë së Veriut që studiojnë në Turqi. Një pjesë tjetër është siguruar nga disa shtëpi botuese në Turqi. Biblioteka është e hapur për shërbimin e studentëve dhe publikut në ditët e tjera të javës, përveç të dielës.

**(Autori është punonjësi i Arkivit të BFI të RMV dhe profesor në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup. Përktheu nga turqishtja: Musanif Rufati, Drejtor i Sektorit për Shkencë dhe Kulturë në BFI)**

#### Burimet:

**ÖZÇELİK**, Kenan, *Âşık Çelebi Terceme-i Ravzatü's-Şüheda* (Ënceleme Metin) Uludağ Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, (Yayımlanmamış Doktora Tezi)(YYDT), Bursa 2015.

**KILIÇ**, Filiz, *Âşık Çelebi Meşâ'irü's-Şu'arâ İnceleme Metni*, (I-III), İstanbul Araştırmaları Enstitüsü, İstanbul 2010.

**AYNUR** Hatice, “Kurgusu ve Vurgusuyla Kendi Kaleminden Âşık Çelebi'nin Yaşam Öyküsü”, *Âşık Çelebi ve Şairler Tezkiresi Üzerine Yazılar* (der. Hatice Aynur, Aslı Niyazioğlu), Koç Üniversitesi Yay., İstanbul 2011.

**GÜLER**, Metin, *Âşık Çelebin Ravza Tercümesi* (Ënceleme-Metin-Sözlük) Erciyes Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, (Doktora Tezi) Kayseri 2015.

# HAFËZ ALI KORÇA, POETI I ANATEMUAR I RILINDJES KOMBËTARE

*I tërë opusi - qoftë sipas veprimtarisë patriotike kombëtare, qoftë asaj fetare - është i lidhur ngushtë me dramën e madhe të popullit të vet. Këtë e vërteton dhe e argumenton me veprat kombëtare, fetare, publicistike, politike e poetike, që janë të shumta. “Vajtimet e Atdheut”, një elegji kombëtare-kolektive.*

#### Nga prof. Sulejman Mehazi

Pas zbehjes së romantizmit në fillim të shek. XX e deri para Luftës së Dytë Botërore, në Evropë, sidomos në Francë, e më vonë edhe në shtetet e Ballkanit, u përhapën disa drejtime, disa rryma letrare të kundërta njëra me tjetrën. Njëra tendencë artistike ishte që realiteti jetësor në veprat letrare të paraqitej ashtu siç është, me sa më shumë vërtetësi, që do të quhej natyralizëm, kurse tendenca tjetër ishte se arti duhej të largohej nga jeta e rëndomtë, për t’u bërë qëllim më vete, apo arti të krijonte pavarësinë e vet krijuese, që do të quhej lartpurlatizëm. Më pas tendenca e natyralizmit u zëvendësua me realizmin, kurse lartpurlatizmi u bë pararendës i parnasistëve dhe simbolistëve.

Në këto gërshetime shkollash e drejtimesh letrare garonte dhe hafëz Ali Korça me veprat e tij poetike e publicistike. Vlen të përmendim se veprimtaria e Ali Korçës ka qenë e heshtur dhe e përmendur gjatë dy periudhave kohore të sundimit zogollian dhe të sistemit enverist-komunist, duke qenë se gjatë periudhës para Luftës së Parë, mes dy luftërave botërore dhe pas Luftës së Dytë Botërore qarqet politike e kulturore mundoheshin të shuajnë zërin politik, kulturor e poetik të hafëz Ali Korçës.

Por, përkundrazi ai mbeti njëri ndër veprimtarët më të shquar e më të dalluar të Rilindjes sonë Kombëtare, i cili jo vetëm që kontribuoi e luftoi pa frikë për hapjen e shkollës shqipe në Korçë dhe të shkollave të tjera në përgjithësi, por edhe luftoi edhe për alfabetin e gjuhës shqipe me shkronja latine; për lirinë dhe pavarësinë e atdheut.

Siç dihet, kontribut të veçantë ka dhënë edhe për islamologjinë shqiptare:



#### Biografi

Hafëz Ali Korça (Korçë, 5 prill 1873 - Kavajë, 7 janar 1957) ka qenë hoxhë, hafëz, hatib, publicist dhe përkthyes i kryeveprave të letërsisë fetare e artistike orientale. Me veprën e tij “Bolshevizma a çkatrim i njerëzimit”, u shënuar si denoncuesi i parë shqiptar i komunizmit.

ishte njohës i mirë i gjuhëve të Islamit, gjatë viteve njëzetë të shek. të kaluar ka qenë luftëtar i demokracisë dhe kundërshar i absolutizmit. Hafëz Ali Korça me veprimtarinë e tij të guximshme jo vetëm që ishte i ndjekur nga Zogu, por edhe i persekutuar nga komunistët deri në fund të jetës së tij.

Po të bëjmë një pyetje letrare e artistike për këtë personalitet të shquar rreth veprimit të tij intelektual, se si është e mundur që veprimtaria e tij të jetë aq e heshtur, e fshehtë dhe e anatemuar nga qarqet letrare të asaj kohe, nga studiuesit dhe kritika letrare në mes dy luftërave botërore e pas çlirimit të Shqipërisë, si është

e mundur që veprimtaria patriotike e poetike e hafëz Ali Korçës të mos përmendet nga historianët dhe teoricienët e letërsisë shqipe, do të konstatojmë se sa shumë e zbehur ka mbetur historia e letërsisë pa këtë intelektual, poet e fetar të mrekullueshëm.

Sikur mos të ishte dr. Ismail Ahmeti me monografinë e tij “Hafëz Ali Korça, jeta dhe vepra”, të cilën sot e kemi në dorë të botuar nga shtëpia botuese “Logos-A” (Shkup, 1999), vallë a do përmendej ky vigan i guximshëm dhe vizionar i shumë drejtimeve: si patriotike kombëtare, shkencore, pastaj si islamolog, arabolog, persianolog, publicist, përkthyes, politikan, pedagog, përpilues tekstesh dhe si predikues i fesë islame.

#### VEPRIMTARIA

Veprimtaria patriotike, kulturore, kombëtare e hafëz Ali Korçës veçohet në tri pika kryesore për kulturën e Lëvizjes Kombëtare:

- angazhimin në çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe;

- angazhimet në çështjen e çlirimit kombëtar (për këto ideale është dënuar tri herë me vdekje nga pushteti i atëherëshëm);

- angazhimet në rrjedhat e ngjarjeve bashkëkohore historike e kulturore.

Me të gjitha këto angazhime, hafëz Ali Korça, së bashku me rilindësit tjerë, me meritë i ka siguruar vetes një vend të veçantë në historinë kombëtare dhe letrare.

I tërë opusi krijues i hafëz Ali Korçës - qoftë sipas veprimtarisë patriotike kombëtare, qoftë asaj fetare - është i lidhur ngushtë me dramën e madhe të popullit të vet. Këtë e vërteton dhe e argumenton me veprat kombëtare, fetare, publicistike, politike e poetike, që janë të shumta.

Këtu do t'i përmendim tekstet shkollorë: "Abetare shqip" (1910), "Alfabeti arabisht" (1914) dhe "Gramatika sintaksë shqip-arabisht dhe fjalime" (1916).

Studiuesi i monografisë së hafëz Ali Korçës, Ismail Ahmeti, tekstin "Gramatika sintaksë shqip-arabisht dhe fjalime" e konsideron si gramatikën e parë të gjuhës arabe shkruar në gjuhën shqipe dhe autorin e saj si të parin e një gramatike të tillë.

Hafëz Ali Korça bën përkthimin e disa proverbove dhe fjalëve të urta arabe në shqip nga fusha e islamistikës: "Treqind e tri fjalët e imam Aliut". Aty flite për edukatën islame, për besën, për diturinë, për vlerat e punës, për virtytet njerëzore si: trimërinë, guximin dhe karakterin etj.

Vepra tjetër shume e vlefshme e hafëz Ali Korçës për besimtarët shqiptarë islam është "Kurani i madhnueshëm dhe thelbi i tij", ku shqiptarëve u ofron Kuranin - veprën madhore të Islamit, të përkthyer në gjuhën shqipe.

#### VEPRAT POETIKE

Citojmë fragmentin poetik nga përmbledhja "Shtatë ëndrrat e Shqipërisë" (fq. 17):

"Krisi lufta e Ballkanit, tymi, flaka mbuloi dhenë,

Therën, grinë, vranë, prenë, doqën, poqën, mbytën ç'gjenë,

Rumelija u bë copë, tre vilajetet shkuan,

Nga an' e Adriatikut këto pak vise të mbenë."

Motivi patriotik, i flaktë, i zjarrtë dhe dashuror, qartë shprehet dhe shihet përmes përmbledhjes poetike "Shtatë ëndrrat e Shqipërisë" (Hafëz Ali Korça, Vepra 2, Logos-A, Shkup, 2006) dhe poemës elegjiake "Vajtimet e atdheut" (po, aty).

Siç shihet, i tërë opusi poetik i hafëz Ali Korçës është i lidhur ngushtë me dramën e madhe të popullit të vet shqiptar dhe të shtetit të Shqipërisë.

Ja çfarë thotë në Parathënien e përmbledhjes poetike "Shtatë ëndrrat e Shqipërisë" për frymëzimin në krijimin e këtyre vargjeve: "Pra, si një atdhetar idealist për t'ia sjellë ndër mënt asamblistëve se rruga që kanë kapur nuk po i shpije në Kabe (Qabe), por në shkretëtirë, shkrova këto 'Shtatë ëndrrat' dhe, si shtypa vetëm njëqind copë, iu dhashë nga një dyke iu thënë: Sot fati i Shqipërisë është në duart tuaja. Në qoftë se shtetit do t'i hithni një themel të mirë dyke zgjedhur burra të mirë e të drejtë, do të çelni një bankë kombëtare me të hollat e kapi-



talistëve shqiptarë, edhe fëmijët do t'i rritni me ndjenja kombëtare e fetare do të jini të lumtur e të lavdëruar. Përndryshe, pas 15 a njëzet vjetësh, kur të realizohen këto shtatë ëndrrat e tmerçme, do të bëhi pishman, por do të mos ju bëjë dobi." (9 qershor 1944, H. Ali. Shtatë ëndrrat e Shqipërisë, Parathënia, fq. 11-16).

Për popullin tonë dhe Shqipërinë kanë kënduar e shkruar edhe Rilindësit tjerë si: Naim Frashëri, Pashko Vasa, Çajupi, Gjergj Fishta e të tjerë.

Edhe pse i anatemuar padrejtësisht, hafëz Ali Korça, bashkë me Mitrush Kulin, Olimpin shqiptar të zanave dhe të shtojzavallevë e kanë ngritur në një përmendore të gjallë poetike.

Në përmbledhjen poetike "Shtatë ëndrrat e Shqipërisë" dhe në poemën elegjiake "Vajtimet e Atdheut" do të vërejmë dhe do të konstatojmë, me të drejtë, se atdheu i Ali Korçës, Shqipëria, nuk ka asnjë gjurmë të huaj, se çdo e keqe e Shqipërisë mëmë ka ardhur nga "bijtë dhe bijat e saj". Këtë e thotë në hyrjen poetike, apo ndryshe do ta quajmë në poezinë çelëse të përmbledhjes "Shtatë ëndrrat e Shqipërisë" (aty, Vepra 2, fq. 17).

#### THUHET NË STROFËN E TRETË:

"O Peri Mëmëz e dashur, ku i ke çunat me besë?"

Sisë-pirësit tërdhelët, përse u çkrinë si vesë?"

Sa rrezik i math të gjeti, bir i sakt'a nuk të mbeti?"

Bijit' e bijatë ku janë, s'të ngeli as nip as mbesë?"

Që të kuptojmë se më parë, Shqipëria dhe shqiptarët armiqësisht kanë qenë të disponuar kundër të huajve. Me anë të simboleve apo figurave poetike: mëmëza, perisë, Ballkani, tymi, flaka, therën, grinë, vranë, poqën, mbytën ç'gjenë, tre vilajetet shkuan, nga an' e Adriatikut këto pak vise të mbenë, krijohet ai kontrasti i

ngjyrave, ku sa më shumë që gërshetohen ato mes vete, po aq edhe i rezistojnë njëra-tjetrës.

Përmbledhja poetike "Shtatë ëndrrat e Shqipërisë" përbëhet nga shtatë njësi, apo pjesë të veçanta, nga shtatë ëndrra, përmes të cilave e sheh pozitën e Shqipërisë aktuale me një të kaluar të ndritshme dhe me një të tashme shumë të pasigurt dhe prej shtatë njësive të tjera gjegjëse, të cilat Ali Korça i quan "Çprovim i ëndrave", duke bërë komentimin e secilës ëndërr, përmes të cilave shpreh qëndrimin e vet, që shkon në antitezë me realitetin e kohës dhe me rrugën e tatëpjetës që i kërcënohej Shqipërisë së viteve '23-24. Kështu, në këtë përmbledhje shprehen preokupimet politike-patriotike të hafëz Ali Korçës rreth ngjarjeve politike të viteve 1923-24.

Poezinë e hafëz Ali Korçës e përshkruajnë dy linja qendrore: ajo e cila synon vlerat morale, njerëzore, drejt përsosurisë kombëtare e fetare, dhe tjetra - ajo e cila u bën rezistencë vlerave më vitale të njeriut. Hafëz Ali Korça, i vetëdijsëm se në të kaluarën tonë historike thithin ujë rrënjët e pakënaqësisë sonë, nga ky vilajet i errët i nxjerr fosilet e shtresuara shekuj me radhë.

Për veprimin fetar e patriotik ai shprehet në këtë mënyrë:

"Zjarr i atdheut kujt i hyri ia përvëloj mushkëritë  
Nga lotët nuk iu ter syri  
më s'pa shprehje asnjë ditë."

(Gazeta Sabah, 30 maj, 1311/1894)  
Ja dhe disa vargje të tij, që i takojnë dhe kohës sonë:

"Për atdhenë kush përpiquej  
nga shteti kësisoj ndiqej.  
Internohej e burgosej  
rraskapitej, handakosej."  
(Po aty, fq. 47)

Po ashtu, mbi tavolinën e tij poetike shtrihet edhe harta e Ballkanit shqiptar, e përgjakur nga Mbretëria Serbe, plot me

kratere vullkanesh. Ai këtë material e seleksionon, e hulumton dhe me të ngre kullën poetike kundër Serbisë me poemën elegjiake, vajtuese, me titull "Vajtimet e Atdheut", e cila, lirisht mund të themi, si poemë nuk është individuale, siç shkroi Fan Noli elegjinë për Luigj Gurakuqin dhe Çajupi për vdekjen e Naimit, por, lirisht dhe pa frikë letrare mund të themi se është elegji kombëtare-kolektive.

Hafëz Ali Korça këtë poemë të dhimbshme e traumatike e pati botuar në revistën "Zani i Naltë" në vitin 1924, vëllimi I, nr. 11, fq. 349.

#### BOMBARDIMET SERBE SI INSPIRIM

Në poemën "Vajtimet e Atdheut" flitet për bombardimet e Serbisë në Drenicë në ditën e Kurban-Bajramit, kur ndodheshin burrat në xhami në qershor të vitit 1924:

"Më s't'u nda zjarri, më s't'u nda flaka,

Më s't'u nda vrasja, ndjekja, shu-plaka,

Më s't'u nda therja, mbytja, grabitja,

Më s't'u nda shtypja, mbytja, grabitja.

Gra, burra, foshnja përditë të vriten,

nga vendi i vet çveshur po qiten,

Digjen katundet e përvëltonen,

Ah, shpirt-makutët prej kujt s'ndalohen.

U gërmadhove, u copëtove,

Krejt u trondite, krejt u shkretove.

Qani, vëllezër, Kosovën, qani

Për gjëmë-zezën ca ditë zi mbani.

Qytetërimi ku është vallë?

Përse Europa nuk ju sheh hallë."

(Shtatë ëndrrat e Shqipërisë, vëllimi 2, Logos-A, Shkup, 2006, fq. 121)

Në poezinë e hafëz Ali Korçës secila kohë i ka kështjellat dhe varret e veta. Nga këto kështjella dhe kulla shumë të rinj janë nisur rrugës së luftës dhe të varrit. Ndër këto kulme janë bërë edhe shumë dasma, janë përkundur shumë djepa. Aty ka filluar jeta qoftë me vajin e foshnjave, apo me ninullat e nënave. Shpeshherë në këto kulla kosovare ka mbaruar jeta me krismën e pushkëve. Andaj, në atdheun e hafëz Ali Korçës çdo gjë bën dritë: guri, druri, toka dhe qielli, gjaku i të gjallëve dhe nuri i të vdekurve.

Në atdheun vajtues të hafëz Ali Korçës as vdekja nuk është aq e trishtueshme, sepse ajo është punë e Zotit, pjesë e natyrës njerëzore. Aty, edhe pas aktit të vdekjes, fillon të bëhet pushtimi i dritës.

Hafëz Ali Korça i ka ndenjtur besnik fesë, kombit, kohës dhe vetvetes.

## DY FJALË PËR POEZINË E HAFËZ ALI KORÇËS

### Nga Fahrush Rexhepi

Rreth unitetit politik shqiptar dhe bashkimit kombëtar shkroi edhe personaliteti i shquar islam dhe intelektual hafëz Ali Korça. Ai këtë ndjenjë e shprehu përmes vargjeve dhe poezive të tij, duke i kënduar pavarësisë së Shqipërisë - ëndërrkjo e kahershme e shqiptarëve:

"An e mb'an bota sot e kuptoj  
mëma, Shqipëria, nga zgjedha shpëtoj."

Hafëz Ali Korça këto të arritura i sheh vetëm në sajë të bashkimit dhe të unitetit të shqiptarëve. Ai shprehet: "Të mos qe bashkimi, a bëhej kështu? Të mos qe bashkimi, a vinim këtu?"

Pastaj:  
"Të mos qe bashkimi, derdhej shumë gjak,  
kujtoj edhe fqinjët na hidhnin në lak."

Në poezinë tjetër, që titullohet „Ndryshim i shpejtë kombëtar”, poeti hafëz Ali Korça shpreh brengosjen për shkak të lënies jashtë Shqipërisë etnike të më shumë se gjysmës së trojeve shqiptare.

Por, ai shpreson në bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet.

Këtë dëshmi krijuesi hafëz Ali Korça e shpreh vullshëm në vargjet:

"Gjithë vllazrit t'anë që na m'ben lark;  
duhet t'i mentojmë t'i futim në vark'.  
Kur ne t'mos kemi një bashkim në shtet,  
ahere do jemi për lumë e për det."

Në një poemë tjetër të Hafëz Aliut me titull „Vajtimet e Atdheut”, ku përshkruhet gjendja e mjerë e shqiptarëve në Kosovë dhe bombardimet e Serbisë në Drenicë në ditën e Kurban-Bajramit, ai vajton gra e burra, vajton foshnja që vriten pamëshirshëm dhe katunde që digjen:

"Më s't'u nda zjarri, më s't'u nda flaka,

Më s't'u nda vrasja, ndjekja, shu-plaka."

Si përfundim do të citojmë thëniet e hafëz Ali Korçës se si mund të përparojmë:

"Pra, edhe neve shqiptarëvet, ca më tepër rinisë, lules të bukur e të çmueshme t'atdheut, një or' e ma parë i duhet ta plotësojë këtë detyrën e shenjtë, se koha më s'na pret. Vullneti i përbashkët e i vazhdueshëm, bashkimi vëllazënor, ideali i

Prijësi fetar dhe personaliteti i njohur historik e letrar i Rilindjes Kombëtare, hafëz Ali Korça, e ngriti zërin e ankesës ndaj Evropës, ndaj shteteve evropiane si: Angli, Francë, Itali, të cilat në Konferencën e Londrës (1913) i ndanë shqiptarët e që tani për vuajtjet e shqiptarëve në Kosovë qanin hallin. Ai këtë brengë e shpreh kundër Evropës së qytetëruar:

"Qytetërimi ku është vallë?  
Përse Evropa nuk ju sheh hallë?"

Autori, duke konsideruar Kosovën dhe Çamërinë si dy pjesë të pandashme të Shqipërisë, spikat:

"M'i madhi krah i Shqipërisë!  
M'e madhja çerdhe e trimërisë,  
Iu dha serbit e Greqisë."

Poeti si Kosovën, ashtu dhe Çamërinë, i sheh të pandashme nga Shqipëria, duke ngritur ndjenjat patriotike në mbrojtje të dy krahëve të fortë të Shqipërisë etnike:

"T'i pritret hovi pak Serbisë,  
M'e dhe për Çamërinë, fqinjës Greqisë."

Pastaj ofshan:

"Qani Kosovën dhe Çamërinë,  
për gjëmë zezët zgjateni zinë."

Mirëpo, është e qartë se bashkimi dhe uniteti i një kombi nuk mund të sigurohen pa liri të mendimit, pa qetësi shpirtërore dhe pa të drejta të barabarta. Të gjitha këto nuk mund të ekzistojnë pa pasur lirinë politike dhe pavarësisë kombëtare. Atdheu e shteti mbrohen vetëm me bashkim kombëtar, pavarësisht që shqiptarët kanë tri fe të ndryshme, sepse fenë gjithsecili e ka për vete.

Edhe shtypi shqiptar islam i periudhës ndërmjet dy luftërave botërore flet për nevojën e unitetit politik shqiptar pa dallim feje e krahine etnografike shqiptare, duke ftuar për tolerancë dhe solidaritet ndërmjet shqiptarëve dhe duke pasur të vetmin ideal - atë të Shqipërisë etnike:

"Në shpirtin dhe gjakun e çdo shqiptari duhet të vlojë një ide e vetme - ideja e Shqipërisë etnike, tue fillue qysh prej cakt me të lartë të Kosovës në veri e deri te caku më i përtejtmë i Çamërisë në jug."

vërtetë kombëtar, në pak kohë shretinë e bën lulishtë diturie e trëndafilishtë qytetërimi."

Poezia:  
"Ajet' i parë që zbriti  
këndim e shkrim porositi.  
Prej djepit e gjer te varri  
mësoni na tha Profeti."  
(Po aty, fq. 120)

# KUJTOHET HOXHË JAKUP ASIPI

Shtatëmbëdhjetë vjet pa dijetarin Jakup Asipi (Allahu e mëshiroftë), ka shkruar Armend H. Fazliu në faqen e vet në Facebook më 7 janar, 2023.

Jakup Asipi lindi në fshatin Sllupçan më 2 shkurt 1951. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, atë të mesëm në Damask të Sirisë, ndërsa studimet në Universitetin Al-Az'har (Egjypt). Studimet postdiplomike i vazhdoi në Bejrut të Libanit.

Gjatë viteve 1985-1990 punoi si imam në një xhami në Leverkusen të Gjermanisë, ku ka dhënë kontribut të çmueshëm në kultivimin e vlerave fetare, morale, kulturore e kombëtare.

Në vitin 1990 kthehet në vendlindje, për të kontribuar në përmirësimin e gjendjes së rëndë të popullatës. Në ligjëratat e tij ka qenë shumë i përpiktë dhe i guximshëm, ndërsa ka qenë i ndjekur dhe i kërcënuar nga pushtetet e kohës. Në vitin 2001 ka marrë pjesë në organizimin dhe përkrahjen e luftës në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, në kryengritjen popullore për liri dhe të drejtë.

Ndërroi jetë më 7 janar 2006, në një aksident rrugor në autostradën Shkup – Kumanovë, thuhet në përkujtimin e Ar-

mend H. Fazliu.

Në shkrimin e Behxhet Jasharit nga Shkupi, ndërkaq, thuhet: Kam pasur dy udhëtime të paharruara me hoxhë Jakup ef. Asipin - në vitin 1990 në Sarajevë dhe në vitin 2000 në Haxh.

Ishte nëntori i vitit 1990, kur një grup të rinjsh nga Shkupi, së bashku me Jakup ef. Asipin, morëm pjesë në takimin e rinisë myslimane të Jugosllavisë në Sarajevë (Susret Muslimanske Omladine '90 - Sarajevo). Gjatë qëndrimit tonë katërditësh në Sarajevë, kontaktonim me njerëz të fesë dhe të kulturës. Takim më mbresëlënës ishte ai me rahmetli Alija Izetbegovićin, i cili në prezencën tonë me lot në sy tha: "Dragi moji mladi muslimani, reci ću vama nešto koju nisam mogao nikad reci. To je: 'Ćuvajte ISLAM'." (Të rinj myslimanë, të dashurit e mi, do t'ju them diçka që asnjëherë s'kam mundur ta them. 'Ruajeni ISLAMIN'.) Të gjithë të pranishmit u ngritën në këmbë dhe me lot në sy e përshëndetëm me fjalët "Allahu Ekber".

Në këtë takim tonin me intelektualët myslimanë të Bosnjës, si me Mustafa Spahiçin, Hasan Çengiçin, Omer Nakiçevićin etj., figura kryesore ishte Jakup



efendiu...

Udhëtimi tjetër mbresëlënës me Jakup ef. Asipin ishte ai në Haxhin e vitit 2000. Me hoxhë Jakupin kishim nderin të qëndronim në një dhomë - si në Mekë, ashtu dhe në Medinë.

Allahu ia dhashtë Xhenetet e Larta, thotë Behxhet Jashari, Shkup.

"Ligjëratën e fundit e ka mbajtur në xhaminë "Mulla Sadiku" në Sllupçan. Pasi e përfundoi ligjëratën, e falëm sunitin e xhumasë. Ah, sa modest ka qenë!... U ngrit dhe e thirri ezanin në xhami.

Them shpesh, edhe atë publikisht: i dua ata që e deshën dhe akoma e duan hoxhën tonë.

Zoti na takoftë në Xhenet!" – ka shkruar më 7 janar, 2023, hoxhë Azir Avdiu (postimi është shpërndarë nga Evzal ef. Sinani).

# NDËRRON JETË DREJTORI I ZLM, FARUK ZEQRIRI

Më 16 janar, 2023, në moshën 41-vjeçare ka ndërruar jetë Drejtori i shkollës së mesme "Zef Lush Marku" (ZLM) në Shkup, Faruk Zeqiri. Zeqiri vite me radhë ka qenë pjesë e arsimit të mesëm në Shkup, është raportuar nga media.

Telegram ngushëllimi në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV ka dërguar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Në telegram thuhet:

"Dhimbje, pikëllim dhe humbje e madhe me rastin e ndërrimit jetë të Drejtorit të gjimnazit "Zef Lush Marku" në Shkup, të ndjerit Faruk Zeqiri. Kombi ynë, arsimi dhe familja humbën një intelektual të shtrenjtë, i cili me punën e tij filloi të vendos strategjinë e dashurisë

ndaj dijes dhe arsimit, për të ngritur vetëdijen e të rinjve për t'iu rrekur me dashuri synimeve dhe idealeve madhore, për të qenë kreatorë të fuqishëm në ngritjen e vlerave kombëtare dhe njerëzore në përgjithësi.

Andaj, në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe në emrin tim, Këshillit Arsimor të gjimnazit "Zef Lush Marku", nxënësve, Drejtorisë dhe në veçanti familjes më të ngushtë, u shprehim ngushëllime të thella, me lutje të Madhit Zot që të ndjerin ta shpërblejë me Xhenetin e Amshueshëm, ndërsa familjes t'i japë durimin e pashoq.

Qoftë në mëshirën e të Madhit Zot", thuhet në telegramin e ngushëllimit të



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Varrimi i Faruk Zeqirit është bërë më 17 janar. Pas varrimit, Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, ka shkruar në faqen e vet në Facebook:

"Sot, të mërzitur, e përcollëm për në botën e amshueshme Drejtorin e gjimnazit "Zef Lush Marku", z. Faruk Zeqiri - i dalluar me moralin e lartë dhe i përkushtuar në ngritjen e cilësisë së arsimit në vendin tonë. Allahu e mëshiroftë!"

# NDAHET NGA JETA HOXHA ISA EF. ELEZI

"...Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi."

Me dhimbje dhe pikëllim të thellë morëm lajmin e hidhur të ndarjes nga jeta të hoxhës së nderuar, hfz. Isa ef. Elezi, Imam i mëparshëm i Xhamisë së Poshtme në fshatin Dobrosht, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

Në emër të Myftinisë së BFI - Tetovë, në emrin tim personal dhe në emër të të gjithë besimtarëve, hoxhallarëve, u shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes, shokëve dhe miqve të tij.


E lusim Allahun fuqiplotë që rahmetliu ta shpërblejë me xhenet, ndërsa familjarëve t'u japë sabër. Varrimi i të ndjerit do të bëhet më 11.01.2023, pas namazit të drekës, në fshatin Dobrosht, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës dhe të Myftiut prof. dr. Qani ef. Nesimi.

Shërbimi për Informim i Bashkësisë Fetare Islame të RMV ka publikuar telegramin e ngushëllimit, në të cilin thuhet:

"Me keqardhje, me dhimbje dhe pikëllim të thellë morëm lajmin e hidhur të ndarjes nga jeta të të nderuarit, hfz. Isa ef. Elezi, Imam i mëparshëm i Xhamisë së Poshtme në fshatin Dobrosht.

Në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe në emër të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në emër të të gjithë të punësuarve në Rijasetin e BFI, u shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes, shokëve, miqve dhe xhematit të tij.

I bëjmë lutje Allahut të madhërishtëm



që të ndjerin ta shpërblejë me Xhenetin Firdeus, ndërsa familjes së tij t'i japë sabër", thuhet në telegramin e ngushëllimit që ka publikuar Shërbimi për Informim i BFI.

Hfz. Isa ef. Elezi është lindur më 17.05.1938 në fshatin Dobrosht të Tetovës. Shkollën fillore e ka kryer në fshatin e lindjes, në vitin 1950, thuhet në njoftimin e Myftiut të Tetovës, të publikuar në faqen personale në Facebook.

Mësimet e para fetare do t'i marrë të hfz. Abdulla Asllani. Më pas, në vitin 1954, do të vazhdojë hifzin te hfz. Jashari ef. Jashari, të cilin do ta përfundojë në vitin 1956. Pas mbarimit të hifzit, gjatë viteve 1958-1960, do të shërbejë për Ramazan në fshatin Kovaçevc të Kaçanikut, Republika e Kosovës. Në vitin 1961,

ndërkaq, do të shërbejë në fshatin Dubravë, Republika e Kosovës.

Hfz. Isa ef. Elezi gjatë viteve 1962-1963 do të shërbejë si myezin në fshatin e lindjes, në Dobrosht.

Në vitin 1971 do t'i vazhdojë mësimet për ders-vaz te hoxha i nderuar Rafiz ef. Hoxha në fshatin Raçe. Me shpërnguljen e hoxhës prej Raçes në Tetovë, do t'i vazhdojë mësimet në Tetovë, deri në vitin 1976.

Prej vitit 1973 deri në vitin 1978 do të shërbejë për Ramazan në fshatin Orašë e Poshtme. Gjatë viteve 1979-1980, ndërkaq, do të shërbejë për Ramazan në Düsseldorf të Gjermanisë.

Në vitin 1983 do të punësohet fillimisht si myezin, mualim dhe vaiz i rregullt në fshatin e lindjes, në Dobrosht. Këtë detyrë do ta kryejë deri në vitin 1991. Në vitin 1992 do të punësohet si imam dhe vaiz në fshatin e lindjes, deri në vitin 1998, kur për shkak të gjendjes shëndetësore do të pensionohet po në këtë vit.

Varrimi u bë në prani të një numri të madh të xhematit. Allahu e pastë mëshiruar, ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi.

Më 14 janar, 2023, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me përcjellën e vet nga Rijaseti dhe nga Myftinia e Tetovës, ishte në ngushëllime te familja Elezi në Dobrosht (Tetovë), me rastin e ndërrimit jetë të hoxhës hfz. Isa ef. Elezi nga ky fshat, thuhet në njoftimin e BFI.



Për ngushëllime te familja e hfz. Isa ef. Elezit në Dobrosht, Tetovë. (foto: BFI)



**Agjencia për Hallall Standard**  
**Агенција за Халал Стандард**  
**Helal Standard Ajansı**  
**Agency for Halal Standard**  
مكتب شهادة للمنتجات الحلال



**Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.**

**Add: Cairska 52.1000 Skopje, North Macedonia.**  
**Tel: + +389(0)2 3117410; 3117 412.**  
**Fax: + +389 (0)23117 883**

**websait: [www.bfi.mk](http://www.bfi.mk)**  
**email: [halal.bfi@gmail.com](mailto:halal.bfi@gmail.com)**